

NJOHJE ME DISA NGA RREGULLAT E SELAMIT

ABDUS-SELAM IBN
ABDULKERIM BERXHES

Tiranë 2010

Titulli i librit: Njohje me disa nga rregullat e selamit

Titulli në origjinal: El ʿlamu bi ba`di ahkamis-selam

Autor:

Abdus-Selam ibn Abdul-Kerim Berxhes

Përktheu:

Shuajb Rexha

Kopertina: Rajan Alliu

Fjala e përkthyesit

Lëvdatat i përkasin Allahut, Një të Vetëm, salavatet dhe selamet janë për atë që nuk ka profet tjetër pas tij.

Përhëndetja e muslimanëve mes tyre me shprehjen e selamit është një nga cilësitë më specifike të fesë islame dhe simbolet më madhështore të saj, gjë të cilën e kanë zili ithtarët e librave të mëparshëm. Këtë përhëndetje, Allahu i Lartësuar e ka cilësuar të begatë, plot mirësi: “Kur të hyni në shtëpi, përhëndeteni njëri-tjetrin me përhëndetje të mirë dhe të begatë nga Allahu” (Nur 61). Kjo është përhëndetja nëpërmjet së cilës muslimani i uron muslimanit tjetër paqe, mëshirë, bereqet dhe begati të njëpasnjëshme, si dhe i shpreh atij paqe, garanci dhe siguri që nuk do e gjejë gjë e keqe nga ana e tij gjatë kohës së takimit të tyre por gjithashtu edhe pasi ata të ndahen.

Përhëndetja me selam është shkak për të shtuar dashurinë dhe afrimitetin mes muslimanëve, sic ka thënë Profeti salallahu alejhi ue selem: “Nuk do të hyni në xhenet derisa të besoni dhe nuk do besoni (sic duhet) derisa të duheni mes jush. A t`u tregoj një vepër, të cilën nëse e veproni do duheni? Përhapeni selamin mes jush” (Transmeton Muslimi).

Kjo përhëndetje është shkak për të hyrë në xhenet, sic ka thënë Profeti salallahu alejhi ue selem: “O ju njerëz përhapeni selamin, ushqeni të tjerët, mbani lidhjet farefisnore dhe faluni natën kur njerëzit flenë, ashtuqë të hyni në xhenet të sigurtë” (Tirmidhiu, hasen sahih).

Është nga cilësitë më të mira të islamit tek personi, u pyet Profeti salallahu alejhi ue selem: Cila vepër e islamit është më e mira? Tha: “Të ushqesh të tjerët dhe t`i japësh selam atij që njeh dhe atij që nuk e njeh” (Mutefekun alejh).

Është përshëndetja e lashtë e Ademit dhe e pasardhësve të tij besimtarë, si dhe e engjëjve, sic transmetohet nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Kur Allahu e krijoi Ademin, i tha: “ Shko tek ai grup engjëjsh, jepu selam dhe vëreje se si do të ta kthejnë përshëndetjen, sepse ajo do jetë përshëndetja jote dhe e pasardhësve të tu. Ai u tha:Es-selamu alejkum, ata ia kthyen:Ue alejkumus-selamu ue rahmetullah” (Mutefekun alejh).

Përshëndetja me selam është një nga obligimet e muslimanit ndaj vëllait të tij musliman, sic thotë Berra bin Azibi radijallahu anhu: Profeti salallahu alejhi ue selem na ka urdhëruar me shtatë gjëra:Vizitën e të sëmurit,përcjelljen e xhenazes, lutjen për atë që teshtin, ofrimin e ndihmës ndaj të pafuqishmit dhe përkrahjen e atij që i bëhet padrejtësi, përhapjen e selamit dhe përmbushjen e betimeve” (Mutefekun alejhi).

Ndaj dhe ne duhet t'i kushtojmë rëndësi dhe vëmendje atyre çështjeve që Allahu dhe i dërguari i Tij i kanë dhënë rëndësi dhe konsideratë, duke garuar në vepra të mira kaq të vlefshme dhe kaq të lehta për tu kryer.

Është për të ardhur keq nga një dukuri negative që vihet re në mesin e muslimanëve, ku një pjesë e mirë e tyre neglizhojnë në praktikimin e kësaj dispozite madhore.Kjo neglizhencë nganjëherë ka si shkaktar një lloj ndjenje inferioriteti tek disa muslimanë ndaj pjesës tjetër të shoqërisë duke e bërë që të ndjehet i dobët, i turpëruar, i mangët, ndaj nuk ka dëshirë të identifikohet publikisht si musliman.Në vend që të ndjehet krenar dhe fatlum, ndjehet si i mangët dhe i frikësuar, ndaj megjithëse e sheh qartë vëllanë e tij musliman, hiqet sikur nuk e ka parë, sikur nuk e lidh gjë me të, duke e anashkaluar përshëndetjen me selam apo sic bëjnë disa “studentë intelektualë” të cilët kanë gjetur një zgjidhje “origjinale” të denjë vetëm për ta, duke e shkurtuar në:S.A dhe A.S . Të Allahut jemi dhe tek Ai do kthehemi. Përvec zhveshjes nga

simbolet e dukshme identifikuese, zhvishen dhe nga praktikimi i kësaj përshëndetjeje të mrekullueshme, të pakrahasueshme dhe frytdhënëse.

Nganjëherë tjetër mosdhënia e selamit ka si shkaktar dalldisjen ekstremiste të disave që padrejtësisht kanë marrë përsipër të praktikojnë bojkotimin (hexhrin) vend e pa vend, jashtë kriteve të përmendura nga dijetarët në marrjen në konsideratë të kushteve dhe rrethanave, dëmeve dhe dobive, por vazhdojnë në dalldisjen e tyre duke pasur një kriter të vetëm:hexhrin sipas tekave të tyre (apo më mirë të themi sipas tekave të një personi të vetëm).Gjatë këtij libri,shejhu – Allahu e mëshiroftë- bën disa ndërhyrje plot urtësi duke i treguar nxënësit të dijes edukatën dhe mënyrën e duhur në trajtimin e debateve të diturisë, ashtuqë njeriu të jetë i ndërgjegjshëm se e vërteta nuk është monopol i kuptimit të tij, nuk është një portë të cilën ai e hap dhe e mbyll kur të dojë dhe për kë të dojë.

Nganjëherë neglizhimi në dhënien e selamit ka si shkaktar besimin e dobët të njeriut, duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur .

E lusim Allahun që të na udhëzojë në rrugën e drejtë larg teprimeve dhe neglizhimeve, ashtu sic e lusim që të na mundësojë t`i kuptojmë drejt dispozitat fetare dhe të na mundësojë që t`i zbatojmë ato, duke kërkuar me këtë vetëm arritjen e kënaqësisë së Tij.

Përkthyesi

Biografia e Shejh Abduselam bin Abdulkerim Berxhes

Shkruar nga Hani bin Salim el Husejni

Botuar në gazetën al Xhazirah

Bashkësia e Ehlul Sunetit u trondit nga lajmi i vdekjes së shejhut të nderuar Abduselam bin Abdul Kerim bin Berxhes Ali Abdil Kerim, i cili ndërroi jetë natën e së shtunës datë 13/2/1425 h, si pasojë e një aksidenti tragjik të ndodhur në rrugën lidhëse ndërmjet qytetit el Ahsa dhe Rijadit

Shejhu ishte i mirënjohur në rrethin e diturisë dhe tek dijetarët e këtij vendi të bekuar, gjë të cilën e vërtetoi fakti i pjesëmarrjes së një numri të madh dijetarësh dhe shujhësh në faljen e namazit të xhenazes së tij.

Kam dëgjuar disa nga shujhët dhe njerëzit e nderuar që thonin: Dituria e tij ishte tejet e madhe në krahasim me moshën që kishte. Ndërsa dikush tha: Nëse do të jetonte më gjatë do kishte qenë fenomenal.

Kam parë që shumë nga dijetarët dhe nxënësit e dijes u pikëlluan shumë me vdekjen e tij, sepse ai ishte një nga mbrojtësit e Sunetit me mish, me shpirt dhe me laps.

Allahu më ka nderuar mua, duke më mundësuar që të jem pranë shejhut, pavarësisht se për një kohë relativisht të shkurtër në krahasim me njerëzit e ngushtë rreth tij, por megjithatë gjatë asaj kohe, sa herë që dëgjoja dicka në lidhje me biografinë dhe historitë e tij e shkruaja, derisa mblodha disa gjëra. Sa herë që më jepej mundësia të takohesha me të ia kujtoja ato të dhëna (për t'i pohuar nga vetë shejhu), ai më thoshte: Unë nuk e meritoj që të shkruhet biografi për mua. Por unë sot e shoh si obligimin më minimal kundrejt tij që këtë biografi ta publikoj, duke pranuar që në të ka mangësi.

Them: Ai është shejhu: Abduselam bin Abdulkerim bin Berxhes bin Nasir Ali Abdulkerim

Familja Ali Abdulkerim, është një nga familjet e njohura në zonën e el Mexhmeah, që rrjedh nga fisi Beni Sa`d nga Beni Temim. Ka lindur në Rijad në vitin 1387 h, sic tregohet në dokumentat personale identifikuese. U rrit nën përkujdesin prindëror në një familje të mirë fetare. Që në fëmijërinë e tij tek shejhu u shfaqën shenjat e zgjuarsisë, këmbënguljes dhe zellit. Ai e mësoi Kuranin përmendësh dhe filloi rrugën e diturisë që kur ishte 13 vjec. Mësuesit e tij vunë re tek ai shenjat e pjekurisë dhe mprehtësisë ndaj i kushtuan vëmendje dhe përkujdesje të vecantë.

Shejhu mësoi tek një numër i madh diejtarësh të këtij vendi, prej tyre përmendim:

1) Imami el Alameh Abdulaziz bin Baz (vdiq 1420h), pranë të cilit qëndroi njëfarë kohe në shpjegimin e një sërë librash, por vecanërisht në shpjegimin e librit Bulugul meram të Ibn Haxherit dhe Tefsirit të Ibn Kethirit.

2) Shejhu fakih dhe usulij Muhamed bin Salih el Uthejmin (vdiq 1421). Tek ai mësoi gjatë viteve 1402-1403 gjatë periudhës së pushimeve zyrtare dhe gjatë mësimëve që shejhu jepte në Mek-keh, si dhe në kohë të tjera. Për njëfarë periudhe kohe jetonte së bashku me shejhun. Tek ai lexoi dhe mësoi librin e Teuhidit, Akiden Uasitije, Zadul Mustekni: fushën e adhurimeve, Axhrumijen, Muhtesar kauaid Ibn Rexheb, gjysmën e Sahihut të Buhariut.

Shejh Ibn Uthejmini e vlerësonte dhe kishte konsideratë të mirë për të, gjë të cilën unë e kam parë me sytë e mi.

3) Shejhu Abdullah bin Xhibrin, tek i cili ka qëndruar katër vjet duke studiuar. Tek ai lexoi dhe mësoi librin e Teuhidit të Ibn Huzejmes, Nunijen e Ibnul Kajimit nga e cila mësoi

përmendësh rreth njëmijë vargje, Zadul mustekni së bashku me er-Raudul murbi`, Mearixhul Kabul të hafidh el Hakemij.

Shejhu përfitoi shumë nga shejh Ibn Xhibrini

4)Shejhu Muhadithi Abdullah Duejsh (vdiq 1409 h), tek i cili ka mësuar gjatë periudhave të pushimeve zyrtare, në qytetin e Burejdes, librin el Elfijeh të el Irakij dhe një pjesë nga Suneni i Ebi Daudit.

5)Shejhu Salih el Etram, tek i cili ka mësuar në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin Muhamed bin Su`ud, si dhe në mësimet e tij që kishte në xhami.

6)Shejh Fehd el Hamin tek i cili ka mësuar në fikh dhe teuhid.

7)Shejh Abdullah bin Ku`ud tek i cili ka mësuar librin Fet-hul mexhid

8)Shejhu fakih dhe usulij Abdullah el Gudejan, tek i cili ka mësuar në Institutin e Lartë të Gjykatës

9)Shejhu Salih el Belihi (vdiq 1410 h), tek i cili mësoi nga libri Zadul mustekni

10) Shejhu Abdulkerim el kHudejr, tek i cili mësoi nga libri Nejlul Eutar të Sheukanit dhe Elfijen të el Irakij.

11) Shejhu Abdulmuhsin el Munif, i mirënjohur në lëndën e trashëgimisë, tek i cili mësoi librin er-Rahabijeh në vitin 1405 h.

Këta ishin vetëm disa nga shujhët tek të cilat ka mësuar, sidomos në mënyrën tradicionale të kërkimit të diturisë.

Ndërsa formimi i tij akademik, filloi me shkollën fillore që e

kreu në qytetin e Rijadit, më pas në Institutin e diturisë që është në varësi të universitetit Muhamed bin Su`ud, më pas në Fakultetin e Sheriatit, në po këtë universitet, ku i përfundoi studimet në vitin 1410 h. Më pas u caktua mësues në qytezën Kuaj iah (170 km larg Rijadit). Më pas filloi studimet pasuniversitare në Institutin e Lartë të Gjykatës, nga ku doli me titullin magjistër. Pas kësaj ai u caktua gjykatës pranë ministrisë së drejtësisë, por pas njëfarë kohe dha dorëheqjen. E caktuan në organin e ankimimit në qytetin e Xhid-des, por as aty nuk pranoi të qëndronte duke dëshiruar që të jetë larg ngarkimit me përgjegjësi për gjykimin mes njerëzve. U rikthye në Rijad si ligjërues në Institutin e Lartë të Gjykatës, ku dhe ndërkohë kreu doktoraturën (1422 h) nën përkujdesjen e muftiut Abdulaziz Ali Shejh. Më pas punoi si professor derisa vdiq.

Shejhu -Allahu e mëshiroftë- ishte tepër i edukuar, modest, i mirënjohur për mirësjelljen, të qënurit i shoqërueshëm, i ëmbël, i qeshur, me cdokënd. Këtë gjë e dëshmon cdokush që e ka njohur, ndaj dhe ata që u prekën nga vdekja e tij ishin të shumtë. E lusim Allahun që të na bashkojë me të në xhenetet e Tij të begata.

Shejhu ishte dhe poet i lindur, që thurte poezi tejet të bukura, të cilat i rridhnin natyrshëm pa u sforcuar, sepse poezinë e kishte dhunti. Shejhu e kishte lapsin të lehtë, ndaj megjithë moshën e tij relativisht të re, shkroi një sërë librash të dobishëm. Mëposhtë do përmend ato libra që unë di, duke theksuar se cili prej tyre është i botuar dhe cili jo.

- 1) El kaulu mubin fi hukmil istihzai bil muminin (Gjykimi për atë që tallet me besimtarët). i botuar
- 2) Ijkafun-nebil ala hukmit-temthil (Gjykimi për teatrimin). i botuar
- 3) Et-temen-nij (Shpresimi). i botuar

- 4) Auaikut-taleb (Pengesat në kërkimin e diturisë). i botuar
- 5) el Flamu bi ba`di ahkamis-salam (Njohje me disa nga rregullat e selamit). i botuar
- 6) el Huxhexhul kauijeh ala en-ne uestailed-daueh teukifijeh (Argumentet bindëse se metodat e daveetit janë të kushtëzuara me argument). i botuar
- 7) Daruratul ihtimami bis-sunen (Domosdoshmëria e kushtimit të vëmendjes praktikimit të suneteve). i botuar
- 8) El Ebjat el Edebijeh el hasirah (Vargjet letrare përmbledhëse). i botuar
- 9) El Ebjat el Ilmijeh el hasirah (Vargjet akademike përmbledhëse). i botuar
- 10) el Mu`tekadu es-Sahih el uaxhibu ala kuli muslimin i`tikaduhu (Besimi i saktë i obligueshëm për çdo musliman që ta besojë). i botuar
- 11) Ibtalu nisbetid-diuani el mensub li shejhil islam (Rrëzimi i pretendimit që ia dedikon Ibn Tejmijes librin ed-Diuani). i botuar
- 12) Mexhmu`u shi`ri shejhil islam (Përmbledhja e poezive të Ibn Tejmijes). i botuar
- 13) Muameletul hukam fij dau`il Kitabi ues-Suneh (Si duhet të sillemi me udhëheqësit, sipas Kuranit dhe Sunetit). i botuar.
- 14) el Emru bi luzumi xhemeatil muslimin ue imamihim (Urdhëri për bashkimin rreth xhematit të muslimanëve dhe prijësit të tyre). i botuar
- 16) et-Teuthik bil ukud fil fikhil islamij (Regjistrimi i marrëveshjeve, kontratave sipas fikhut islam). i pabotuar

17) Kat`ul mira fi hukmid-duhuli alel umera (Dhënia fund dyshimeve në lidhje me gjykimin e vizitës tek prijësit). i botuar

18) El ehadithun-nebeuijeh fi dhem-mil unsurijeh el xhahilijeh (Hadithet profetike që përcmojnë racizmin, si ves i xhahilijetit). i botuar

19) El hijaneh, dhem-muha ue ahkamuha (Tradhëtia, qortimi i saj dhe dispozita që kanë të bëjnë me të). i bërë gati për botim

20) Meshruijetu hibetuth-theuab (Ligjshmëria e dhurimit të sevapeve). i bërë gati për botim

21) el Muhadaratu fid-daueti ued-duah (Ligjërata në lidhje me thirrjen në islam dhe thirrësit).Libri përmban 13 ligjërata të shejhut, të cilat unë dhe vëlla Mensur bin Mubarak Seferi , i kemi transkriptuar, ia kemi paraqitur shejhut i cili i rishikoi dhe tani janë gati për botim.

22) Sherhul muharar fil hadith (Shpjegim i librit el Muharar).Jeta e tij nuk i bëri të mundur që ta mbarojë librin, megjithëse e donte shumë dhe kishte dëshirë të flaktë që ta realizonte këtë vepër.

23)Teduinul akideti es-selefijeh, xhuhudu eimetil islam fi neshri akidetil islamijeh (Shkrimi përmbledhës i akides-selefije, përpjekjet e dijetarëve imamllarë për përhapjen e akides islame).Libri ishte konceptuar në dy vëllime, në vëllimin e parë do përfshihen shtatë shekujt e parë, ndërsa në të dytin shtatë shekujt e tjerë, por arriti të realizonte vetëm vëllimin e parë, i cili është gati për botim.

24) Kitabun fil fikh (Një libër rreth fikhut). Shejhu e përmendte shpesh që po punonte në të por nuk e di deri ku ka arritur.

25) Teraxhimu ba`dil dijetarëve (Biografite e disa dijetarëve), por nuk e di se çfarë është bërë me të.

26) Bejanu meshruijeti ed-dua alel kafirine bil umum (Sqarimi i ligjshmërisë së lutjes kundra kafirave në mënyrë të përgjithshme). i botuar

27) Darbul mer`ah bejne hukmish-sher`i ue uaki`in-nas (Goditja e gruas, sipas gjykimit fetar dhe realitetit të njerëzve)

Shejhu mund të ketë dhe libra të tjerë që unë nuk di rreth tyre. Gjithashtu, shejhu ka një numër të madh artikujsh të botuara në gazeta apo revista të ndryshme. Po ashtu, kishte një përkushtim të vecantë ndaj verifikimit dhe recensimit të librave të dijetarëve të davetit (Muhamed bin AbdulUehab dhe pasardhësit e tij), nga të cilat ka recensuar mbi 22 libra, si dhe përpiquej të gjente dorëshkrimet e tyre që t`i fotokopjonte apo përpiquej tia ofronte ato dikujt që donte të merrej me recensimin e tyre dhe sic më kanë treguar vetë autorët, janë mbi 30 libra që ata i kanë marrë dorëshkrimet nga biblioteka e shejhut.

Po të duam mund të mbledhim dhe më shumë nga lajmet e jetës së tij por shpresojmë që kjo të jetë për një rast tjetër. E lus Allahun që të na falë neve dhe atë dhe të na bashkojë me të në vendbanimin e paqes.

Bismilahi Rrahmani Rrahim

Parathënie: Hamdi i përket vetëm Allahut, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin për të Dërguarin e Tij.

E më pas:

Këto janë disa çështje që kanë të bëjnë me rregullat e selamit. I shkrova në mënyrë të përmbledhur duke dëshiruar që të shërbejnë si përkujtim për të shkujdesurin dhe mësim për fillestarin. Origjina e kësaj broshure është një ligjëratë e mbajtur dikur dhe e cila më pas është botuar, pastaj i shtova disa çështje, si dhe korrigjova disa gabime të ndodhura gjatë ligjëritimit. Allahu është që jep sukses dhe që udhëzon për në rrugën e drejtë.

Autori. Rijad 10/09/1412 h

- **Kush jep selam i pari?**

Ky është një sunet të cilit shumë njerëz nuk i përmbahen dhe pothuajse po zhduket ky sunet. U takon muslimanëve që t'i përmbahen këtij suneti në madhërim të Sunetit të Profetit salallahu alejhi ue selem dhe ripërtëritje të këtij suneti të lënë pas dore. Disa mahniten nga perëndimorët kafira kur i shohin ata që u përmbahen rregullave shoqërore apo të një natyre tjetër, qofshin të vendosura nga udhëheqësit (të parët e tyre) apo dikush tjetër. Në të vërtetë muslimanët i kanë të përcaktuara rregullat e mirësjelljes dhe edukatës shoqërore, si dhe të fushave të tjera, të cilat janë në çdo aspekt më të përsosura dhe më perfekte sesa ato që kanë pabesimtarët, por e meta qëndron në (praktikuesit) bartësit e këtyre rregullave të cilët nuk i zbatojnë ato, madje të cilët kanë hequr dorë prej tyre dhe janë dhënë pas të tjerave (të importuarave). Ky sunet -që ka të bëjë me faktin se kush përshëndet i pari me selam- është fakt, argument i qartë dhe dëshmues i drejtë që vërteton virtytet e larta që gëzojnë muslimanët, qoftë dhe në detaje, pa folur më tej për çështjet madhore. Buhariu ka transmetuar në Sahihun e tij (11/15) si dhe Muslimi (4/1703) nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se ai ka thënë: Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Përshëndet me selam ai që është hypur (mbi kafshë apo mjet tjetër udhëtimi) atë që ecën në këmbë. Këmbësori përshëndet atë që është i ulur dhe ata që janë pak përshëndesin ata që janë shumë”. Po ashtu Buhariu ka transmetuar (11/14) nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “I vogëli përshëndet më të madhin, ai që kalon (ecën) përshëndet atë që është ulur dhe ata që janë të paktë në numër përshëndesin ata që janë shumë”. Në këto dy hadithe tregohet se kush duhet të fillojë i pari me selam.

-Përshëndet me selam ai që është hypur (në kafshë apo mjet) atë që ecën në këmbë (këmbësorin).

Urtësia në këtë qëndron në faktin se të ecurit me mjet mund të shkaktojë mendjemadhësi dhe mburrje, ndaj u ligjërua dhe u

konsiderua e pëlqyeshme që t'i japë i pari selam këmbësorit ashtu që ta largojë ndjenjën e vetëpëlqimit dhe të shfaqë modesti. Maziriu ka thënë: U urdhërua ai që është hypur, të japë selam, sepse ka një veçori më shumë sesa këmbësori (pra, ecjen me mjet) ndaj iu kompesua këmbësorit kundrejt kësaj veçorie duke iu dhënë selam nga ana e atij që është hypur. Kjo e ruan atë që është hypur nga mburrja dhe kryelartësia, e cila mund të ndodhë nëse do veçohet me të dyja veçoritë (ecjen mbi mjet dhe që t'i jepej selam nga këmbësori)¹. Kërkohet nga ai i cili ecën me makinë apo biçikletë, etj, që tu japë selam i pari këmbësorëve dhe atyre që janë ulur duke ndenjor, duke u bazuar në përgjithësimin e fjalës së Profetit salallahu alejhi ue selem sipas transmetimit të dytë: “Ai që kalon (ecën) i jep selam atij që është ulur” sepse fjala: “Ai që kalon” përfshin atë që ecën në këmbë, atë që është i hypur mbi kafshë apo makinë, etj.

-Ai që ecën përshëndet me selam atë që është ulur.

Urtësia në këtë -Uallahu ealem- qëndron në faktin se ai që është i ulur e ka të vështirë t'i kushtojë vëmendje dhënies selam atyre që kalojnë (pranë tij) duke pasur parasysh numrin e shumtë të tyre, ndaj iu lehtësua atij duke mos iu kërkuar që të japë i pari selam, sepse kjo është e vështirë dhe e mudimshme për të, në ndryshim nga ai që kalon sepse nuk është e vështirë për të (të japë selam)². Tirmidhiu ka transmetuar në Sunenin e tij 5/62 po ashtu dhe Buhariu në el Edebul mufrad 2/460 nga Fudalete bin Ubejd se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kalorësi i jep selam këmbësorit, këmbësori atij që po qëndron”³. El Hafidhu (Ibn Haxheri) ka thënë: Nëse do kuptojmë me fjalën “atij që po

¹ Kjo fjalë është marrë nëpërmjet librit të Ibn Haxherit, Fet-hul Barij 11/17. Shumica e materialit të këtij paragrafi është marrë nga Ibn Haxheri dhe unë nuk kam bërë tjetër veçse e kam sistemuar dhe kam bërë zgjedhjen e mendimit më të saktë.

² Maziriu ka përmendur disa urtësi rreth kësaj por unë u mjaftova vetëm me këtë arsyetim sepse kjo përputhet plotësisht me realitetin që përjetojmë.

³ Tirmidhiu pasi që e transmetoi tha: Hadith hasen Sahih (Sh.p: E saktësoi gjithashtu Albani).

qëndron” qëndrimin në prehje (të kundërtën e ecjes) atëherë kjo përfshin qëndrimin në këmbë, ulur, mbështetur (në krah) dhe i shtrirë ⁴.

- Ata që janë të paktë u japin selam atyre që janë shumë:

Urtësia në këtë qëndron në faktin se xhemati që janë të bashkuar kanë vlerë në shariat, ndaj është e përshtatshme që tu jepet atyre selam fillimisht nga pala tjetër më e paktë në numër, ose urtësia ka të bëjë me faktin se nëse ata që janë grup do t’i jepnin selam të parët atij që është vetëm, kjo ndoshta mund ta bëjë atë të mburret dhe kryelartësohet, ndaj u ligjërua në këtë formë që të jetë si masë sigurie për të (që e mbron nga veset) ⁵.

- I vogëli (në moshë) i jep selam atij që është më i madh se ai.

Urtësia në këtë është: Dhënia përparësi moshës, e cila është e vlerësuar dhe merret në konsideratë në çështje të shumta në shariat.

-Pasiqë u njohëm me këtë edukatë profetike dhe u bënë të qarta urtësitë e saj, duhet të cekim faktin se ka disa situata që mund të jenë të paqarta (në aspektin e dhënies përparësi në selam) sepse nuk janë të theksuara shprehimisht, psh nëse takohen dy persona që po kalojnë, duke ecur në këmbë apo hypur mbi mjet (ose kafshë) cili nga këta të dy duhet të japë selam i pari?

E sakta në këtë çështje është: Se pozita e tyre në këtë rast është e barabartë, ndaj ai që jep selam i pari është më i mirë (në këtë aspekt), duke u bazuar në atë që ka transmetuar Buhariu në el Edebul mufrad (2/458) menjëherë pasiqë transmetoi hadithin e Ebu Hurejres: “Ai që është hypur i jep selam atij që ecën (në këmbë)” nga Ibn Xhurejxhi i cili tha: Më ka treguar Ebu Zubejri se ai e ka dëgjuar Xhabirin radijallahu anhu duke thënë: Nëse takohen dy këmbësorë, më i miri prej tyre është ai i cili fillon i pari me selam” ⁶.

⁴ el Fet-h 11/16.

⁵ el Fet-h 11/16.

⁶ Ibn Haxheri ka thënë: Zinxhiri i tij është i saktë.

Situatë tjetër: Nëse bie ndesh moshë me ndonjë kriter tjetër të vlerësuar, si psh të jetë më i ditur ai që është më i vogël në moshë. Mendimi që më duket më afër të vërtetës është : konsiderimi i moshës, sepse kjo është që kuptohet në pamje të parë të hadithit dhe siç dihet i jepet përparësi kuptimit real të shprehjes ndaj kuptimit figurativ (simbolik)⁷.

Situatë tjetër: Nëse takohet një i madh me një të vogël: nqs njëri prej tyre është i hypur mbi mjet ose kafshë, atëherë i takon atij që t`i japë selam këmbësorit, ndërsa nqs janë të dy këmbësorë ose që të dy mbi kafshë ose mjet, atëherë i vogëli jep selam i pari. Këtë mendim e ka thënë Ibn Rushdi⁸.

Situatë tjetër: Nëse këmbësorët që po ecin janë më të shumtë në numër se sa ata që janë të ulur, u takon atyre që janë në këmbë të fillojnë të parët me selam. Ka thënë në librin el Ikra: Nëse këmbësorët kalojnë pranë një të uluri apo një grupi personash të ulur, ai që fillon me selam është këmbësori, sido që të jetë (diferenca numerike)⁹. Neueuiu në el Edhkar ka thënë: Kjo edukatë ka të bëjë nëse dy persona takohen në rrugë, ndërsa nqs kalon pranë një personi të ulur apo grupi personash të ulur, atëherë i takon atij që po kalon të fillojë me selam sido që të jetë, qoftë i madh apo i vogël, qofshin shumë (në numër) apo të paktë¹⁰.

Nëse dikush nuk i përmbahet kësaj edukate, p.sh: duke i dhënë këmbësori selam i pari atij që është hypur mbi kafshë apo mjet ose më i madhi i jep i pari selam më të vogëlit ose ata që janë më të shumtë në grup i japin selam të parët grupit më të vogël, e arrijnë shpërblimin e përhapjes së selamit inshaAllah, por zbatimi i hadithit që përmendëm (në fillim) është më parësor duke kërkuar të arrijmë atë që është më e mira dhe për tu përputhur me Sunetin. Neueuiu në shpjegimin e Muslimit ka thënë: Kjo që u përmend në hadith... të gjitha kanë gjykimin: vepra të pëlqyeshme, prandaj nëse dikush

⁷ el Fet-h 11/17.

⁸ el Fet-h 11/17

⁹ Ibn Haxheri në el Fet-h 11/17 dhe nga ai e ka marrë Sefarinij dhe e ka përmendur në Gidhaul elbab 1/283.

¹⁰ el Edhkar fq 219.

vepron të kundërtën lejohet, por do jetë lënie e asaj që është më e mirë¹¹. Ibn Abdul Kauij el Hanbelij ka thënë në vjershën e tij:

Nëse ai që është i urdhëruar ta kthejë selamin, e jep atë i pari, e ka arritur shpërblimin e sunetit sepse e dha selamin i pari.

Ibn Muflihit i dukej se ky varg përmban kuptim të pa saktë (el Adabul esh-sher`ijeh 1/418) ndaj Sefariniu iu përgjigj në shpjegimin e vjershës (Gidhaul elbab 1/283) se qëllimi i autorit është se personi e ka arritur vlerën e dhënies selam i pari, vetëm kaq. Pra, ai nuk ka arritur përsosmërinë e sunetit, ka arritur vetëm shpërblimin e fillimit me selam ndërsa shpërblimin e përputhjes me sunetin në renditjen e dhënies së selamit siç u përmend në hadith, nuk e ka arritur. Uallahu ealem (Allahu e di më së miri).

Obligueshmëria e kthyerjes së selamit

U pyet imam Ahmedi rreth një personi i cili kaloi pranë një grupi njerëzish dhe u dha selam atyre por asnjëri prej tyre nuk ia ktheu selamin, u përgjigj: Le t`i shpejtojë hapat që të mos e zërë mallkimi së bashku me atë grup njerëzish¹². Ibn Abdul Berri në librin e tij et-Temhid ka thënë: Argumenti që vërteton obligueshmërinë e kthimit të selamit është fjala e Allahut: **“Kur t`u përshëndesin me ndonjë përshëndetje përgjigjuni me përshëndetje më të mirë se ajo ose (të paktën) ktheni të njëjtën”** (Nisa: 86) -pastaj tha- dhe kthimi i selamit konsiderohet uaxhib (obligim) tek të gjithë ata (dijetarët)¹³.

Kurtubiu ka thënë: Të gjithë dijetarët kanë rënë dakort se dhënia e selamit fillimisht është Sunet shumë i preferuar (i pëlqyeshëm) ndërsa kthimi i tij është farz (obligim)¹⁴. Po ashtu para tij kanë komunikuar ixhmaun (unanimitetin) e

¹¹ Sherhu Neueui ala Muslim 14/141 dhe nga ai e ka marrë Ibn Muflihi dhe e ka përmendur në librin e tij: el Adabul esh-sher`ijeh 1/418.

¹² el Adab esh-sher`ijeh 1/379 dhe nga ai e ka marrë Sefarinij dhe e ka përmendur në Gidhaul elbab 1/277.

¹³ et-Temhid 5/288-289.

¹⁴ Tefsirul Kurtubi 5/297.

dijetarëve rreth kësaj çështjeje Ibn Abdul Berri, Ibn Hazmi, gjithashtu dhe shejhul islam Ibn Tejmijeh¹⁵.

Ibn Kethiri pasi që tregoi fjalën e Hasen el Basriut ku ka thënë: Dhënia e selamit është vepër vullnetare ndërsa kthimi i tij është farz, tha: Kjo që ai tha, njëkohësisht është mendimi i të gjithë ulemave pa përjashtim: dmth kthimi i selamit është detyrë për atë që i jepet selam dhe ngarkohet me gjynah nëse nuk e kthen atë, sepse e ka kundërshtuar urdhërin e të Lartësuarit¹⁶. Mos kthimi i selamit është diçka shumë e urryer dhe e shëmtuar, gjë me të cilën janë sprovuar shumë njerëz në këtë kohë (duke rënë në këtë gabim) dhe arsyeja që i shtyn ata për diçka të tillë është mendjemadhësia dhe vetëpëlqimi (hyrja e vetes në qejf), ndaj ne u drejtohem këtyre personave dhe u themi: Ngadalë, ngadalë. Kush jeni ju?! Nga se jeni të krijuar ju?! :**“I mallkuar qoftë njeriu (mosbesimtar) sa mosmirënjohës është ai! Prej çfarë gjëje Ai e krijoi atë? E krijoi nga një pikë lëngu dhe e formësoi atë (në masa të përcaktuara)”** (Abese: 17-19) A mos ndoshta ju jeni me vlerë më të madhe dhe pozitive më të lartë se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem ? Ai e kthente selamin ndaj të vogëlit dhe të madhit, ndaj skllavit dhe atij që ishte i lirë, madje u jepte selam i pari, prandaj le të keni shembullin më të mirë tek Profeti salallahu alejhi ue selem . E lusim Allahun të na udhëzojë dhe t`i japë sukses të gjithëve.

Vërejtje: Nëse dikush ngrihet nga mexhlisi për tu larguar dhe jep selam, është detyrë që t`i kthehet selami ndryshe nga ai mendim që ka dikush nga dijetarët.

Dijetari shafi`ij el Mustedh-hirij ka thënë: është sunet(e pëlqyeshme) të jepet selam kur dikush largohet ndërsa përgjigjia ndaj tij është uaxhib. Neueuiu ka thënë: Ky mendim është i saktë (i vërtetë)¹⁷.

¹⁵ el Adabul esh-sheh`ijeh 1/379.

¹⁶ Tefsiru Ibni Kethir 1/532.

¹⁷ el Edhkar fq 220 dhe nga ai e ka marrë Ibn Haxheri dhe e ka përmendur në el Fet-h 11/7 dhe unë nga ai e mora.

Mënyra e kthimit të selamit nëse i jepet një grupi njerëzish

Ebu Daudi ka transmetuar në Sunenin e tij (5/387) nëpërmjet Seid ibn Halid el Huzajj, i cili tha: Abdullah bin-el Fadl¹⁸ më ka thënë mua: Ubejdullah ibn Ebi Rafij na ka thënë, nga Alij bin Ebi Talib: “Nëse kalon një grup njerëzish mjafton që të japë selam njëri prej tyre dhe po ashtu mjafton që tua kthejë selamin njëri nga ata që janë të ulur” Ebu Daudi tha: Hasen ibn Alij e referon këtë si hadith¹⁹. El hafidh (Ibn Haxheri) në el Fet-h (11/7) ka thënë: Në zinxhirin e tij ka dobësi por dëshmon për të një transmetim tjetër tek Taberani nga Hasen ibn Alij, zinxhiri i këtij transmetimi është i përfolur. Po ashtu dëshmon për të një transmetim tjetër mursal në el Mueta nga Zejd bin Eslem (mbaroi fjala e tij). El Hafidh e konsideroi zinxhirin e këtij hadithi të dobët sepse në të ka dy të meta:

E para: Transmetuesi Seid bin Halid nuk është i fortë (në memorie)²⁰. Është konsideruar si transmetues i dobët nga një grup dijetarësh, si psh Ebu Zur`ah, Ebu Hatim, Jakub ibn Shejbeh dhe e konsideruan këtë hadith të refuzuar sepse ky transmetues është veçuar me këtë transmetim me këtë zinxhir²¹. Ibn Hibani ka thënë: Nuk e preferoj argumentimin me këtë hadith, me të cilin është veçuar ky transmetues me transmetimin e tij (et-Tehdhib 4/21). E meta e dytë është shkëputja (ndërprerja) ndërmjet Abdullah bin el Fadl dhe Ubejdullah bin ebi Rafi. Ibn Abdul Berri tha: Abdullah bin Fadl nuk ka dëgjuar (transmetim) nga Ubejdullah bin Rafi, ndërmjet tyre gjendet el Earaxh në shumë hadithe. (mbaroi). Këtë hadith e ka transmetuar el Mehamilij në el Emalij²².

Nga Abdullah bin el Fadl nga el Earaxh nga Ubejdullah bin Ebi Rafi²³. Darekutni në el Iel (4/22) ka thënë: E sakta në

¹⁸ Në disa kopje të Sunen Ebi Daudit thuhet: Ibn Mufedel por Ibn Haxheri në et-Tekrib 6/42 tha: E sakta në emrin e tij është: Ibn el Fadl.

¹⁹ Hasen ibn Alij është shejhu i Ebu Daudit në këtë hadith. E transmeton këtë si fjalë të Profetit salallahu alejhi ue selem .

²⁰ el Iel të Darekutnit 4/22.

²¹ et-Temhid 5/290.

²² el Adabu esh-she`ijeh 1/379.

²³ 5/62-2 dhe shiko el Iel të Darekutnit 4/22.

këtë mes është transmetimi i atij që nuk e ka përmendur el Earaxh ndërmjet tyre, ndaj hadithi nuk është i saktë (mbaroi). Por megjithatë hadithi ka disa rrugë të tjera transmetimi që dëshmojnë për të -siç tha Ibn Haxheri- ndërsa Ibn Abdul Berri tha për hadithin e Aliut: Ai është hadith hasen (i mirë). Këtë hadith e ka konsideruar hasen nga dijetarët bashkëkohorë muhadithi shejhul islam el Albani²⁴. Allahu e di më së miri të vërtetën. Ibn Muflihi ka thënë: është e mjaftueshme nëse jep selam vetëm njëri nga një grup personash dhe mjafton nëse e kthen vetëm një person nga grupi. Ibn Abdul Berri ka thënë: Maliku, Shafiju, pasuesit e tyre dhe njëkohësisht është mendimi i banorëve të Medines, kanë thënë: Nëse një person i jep selam një grupi njerëzish dhe ia kthen vetëm njëri prej tyre, kjo e shlyen obligimin e tyre (kthimin e selamit). Shafiju e përngjasoni këtë me (farzet kifaje) namazin me xhemat²⁵, kërkimin e diturisë dhe të kuptuarit e fesë, larja e të vdekurve dhe varrosja e tyre, udhëtimi (për xhihad) drejt tokës së armikut për t'i luftuar ata. Tha: Të gjitha këto janë farze kifaje (obligime kolektive) që nëse një pjesë e atij populli (grupi njerëzish) i kryen ato, atëherë bie obligimi nga pjesa tjetër e atij populli (grupi)²⁶.

Hanefitë kanë kundërshtuar në këtë çështje. Ebu Jusufi ka thënë: Nuk bie obligimi (i kthimit të selamit) përveçse nëse e kthejnë atë të gjithë. Ebu Xhafer Tahauij ka thënë: Nuk dimë të ketë diçka të transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem në lidhje me këtë çështje përveç hadithit që transmetohet nga Malik bin Zejd bin Eslem dhe diçka tjetër që është transmetuar nga Ebu Nadri, ish skllavi i Umer ibn Ubejdullah nga Profeti salallahu alejhi ue selem, por që të dyja këto transmetime nuk mund të argumentohet me to (për shkak të dobësisë së tyre)²⁷.

²⁴ el Irua 3/242.

²⁵ Sh.p: Kjo sepse namazi me xhemat tek Shafiitë konsiderohet farz kifaje.

²⁶ et-Temhid 5/288.

²⁷ Marrë nëpërmjet librit et-Temhid 5/288

T'i dërgosh selam dikujt nëpërmjet një personi ndërmjetës dhe komunikimi i tij

Profeti salallahu alejhi ue selem ishte që ia ngarkonte dikujt që t'i komunikonte selamin e tij dikujt që ishte në mungesë . Në të njëjtën kohë e pranonte selamin që i komunikoj nga dikush i largët. Shembulli i situatës së parë është hadithi që ka transmetuar Muslimi në Sahihun e tij 3/1506 nga Enes bin Malik se një djalosh nga fisi Eslem tha:

O i Dërguari i Allahut, unë dëshiroj të luftoj por nuk posedoj gjërat e nevojshme për t'u përgatitur (për të dalë në luftë). Tha: “Shko tek filani sepse ai ishte bërë gati për të dalë në luftë por u sëmur”. Djaloshi shkoi tek ai person dhe i tha: Vërtetë, i Dërguari i Allahut të dërgon selam dhe thotë: Më jep mua ato me çfarë ishe përgatitur për të dalë në luftë. Ai i tha gruas së tij: “Oj filane jepja ato me çfarë unë isha përgatitur për luftë dhe mos i ndal asgjë prej tyre. Uallahi nëse ti ia ndal (pengon) ndonjë gjë prej tyre, nuk do të kesh bereqet në të”. Nga ky hadith përfitohet ligjshmëria e dërgimit të selamit atij që është në mungesë dhe kjo gjë është vepruar nga muslimanët (në të gjitha kohërat) dhe vazhdon të veprhet. Gjithashtu e përforcon këtë, hadithi që Ebu Daudi ka transmetuar nga Ibn Abasi i cili tha: Profeti salallahu alejhi ue selem vendosi të nisej për haxh. Një grua i tha bashkëshortit të saj: Ma bëj të mundur që ta kryej haxhin sëbashku me Profetin salallahu alejhi ue selem. Tha: Nuk kam me çfarë të të mbart për në haxh. Ajo tha: Më mbart mbi devenë tënde. Tha: Atë deve e kam caktuar vetëm për xhihad në rrugë të Allahut az-ze ue xhel-le. Atëherë ky person erdhi tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe tha: Vërtetë gruaja ime të përshëndet me selamin dhe mëshirën e Allahut. Ajo më kërkoi të kryej haxhin me ty duke më thënë: Ma bëj të mundur kryerjen e haxhit me Profetin salallahu alejhi ue selem. Unë i thashë: Nuk kam me çfarë të të mbart për në haxh. Ajo më tha: Më mbart mbi devenë tënde filanen. i thashë: Atë deve e

kam caktuar vetëm për në xhihad. Atëherë Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Nëse ti e mbart gruan tënde mbi atë deve që të kryejë haxhin kjo do të jetë në rrugë të Allahut”. Tha: Ajo më porositi të të pyes se çfarë vepre mund të jetë e barabartë me një haxh me ty? Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Përsëndete nga unë me selamin dhe mëshirën e Allahut dhe bereqetet e Tij dhe lajmëroje se ajo është e barabartë me një haxh me mua” kishte për qëllim Umren në Ramazan (ky shpjegim është nga transmetuesi)²⁸. Dërgimi i selamit nuk është i përkufizuar vetëm me ato raste kur njeriu ka një nevojë të caktuar për tia komunikuar dikujt në mungesë, përkundrazi është i përgjithshëm dhe përfshin edhe ato raste kur dëshiron të komunikojë një nevojë të caktuar apo edhe pa pasur diçka të tillë, kjo gjë është e transmetuar në tekste dhe gjurmë të selefëve dhe do i përmendim më vonë disa prej tyre. Përsa i përket Sunetit në situatën e dytë: Pranimi i selamit nga Profeti salallahu alejhi ue selem që tia komunikonte dikujt tjetër. Shembulli për këtë është hadithi që transmetohet në dy Sahihet²⁹, nga Ebu Hurejra i cili tha: Erdhi Xhibrili tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe i tha: O i Dërguari i Allahut. Hadixheja po vjen duke mbartur me vete një enë, e cila ka ushqim dhe pije. Kur ajo të mbërrijë tek ti, komunikoji asaj selam nga Zoti i saj dhe nga unë dhe përgëzoje me një shtëpi me kallama në xhenet, aty ku nuk ka klithma e britma e as lodhje e mundime”. Gjithashtu në dy Sahihet³⁰ transmetohet nga Aisheja e cila tha: Profeti salallahu alejhi ue selem një ditë prej ditësh tha: “Oj Aishe, ky është Xhibrili që po të dërgon selam. Thashë: Ue alejhis-selam (edhe mbi atë qoftë selami) dhe mëshira e Allahut dhe bereqetet e Tij. Ti sheh atë që unë nuk shoh” kishte për qëllim Profetin salallahu alejhi ue selem. Ky ishte teksti i Buhariut ndërsa tek Muslimi

²⁸ Sunen Ebi Daud, libri i riteve të haxhit 2/505 dhe zinxhiri i tij është i mirë, i pranueshëm inshallah, dhe ka transmetime të tjera që dëshmojnë për të.

²⁹ el Buhari, libri i mirësive të Ensarëve 7/133 dhe Muslimi, libri mirësitë e sahabëve 4/1887.

³⁰ Buhari, libri mirësitë e sahabëve 7/106 dhe Muslimi 4/1895.

transmetohet pa shtuar fjalën: dhe bereqetet e Tij (ue berakatuhu). Neueuiu në shpjegimin e Muslimit 15/211 ka thënë: Nga ky hadith përfitohet pëlqyeshmëria e dërgimit të selamit, ndërkohë që ai i cili e merr përsipër e ka detyrë ta komunikojë këtë selam. (mbaroi)

el alameh Ibn Muflihu në el Adab 1/419 ka thënë : Ky e ka detyrë komunikimin e selamit nëse e merr përsipër diçka të tillë, sepse është i urdhëruar që t'i çojë në vend amanetet, por nëse nuk e merr përsipër komunikimin e tij atëherë nuk e ka detyrë. (mbaroi)

el hafidh Ibn Haxheri në el Fet-h 11/38 ka thënë: Mendimi më i pjekur në lidhje me këtë çështje është të thuhet se nëse personi e merr përsipër komunikimin e selamit tek dikush tjetër, kjo i përngjason besës së dhënë dhe amanetit, ndërsa nëse nuk e merr përsipër atëherë është njësoj sikur dikush që kërkon t'i lërë diçka në ruajtje (uediah) por ky nuk pranon tia marrë përsipër ruajtjen e saj, në këtë rast nuk ka asnjë detyrim ndaj tij. (mbaroi)

Pra, duke u bazuar në këtë, themi se personi që i ngarkohet komunikimi i selamit dikujt, ka dy situata:

E para: i kërkohet mbartja e selamit dhe komunikimi i tij, por ai nuk e merr përsipër diçka të tillë (në mënyrë obliguese) duke thënë: Inshallah duke pasur për qëllim lënien e realizimit të kësaj gjëje në dëshirë të Allahut, pra nëse i kujtohet e komunikon, nëse jo nuk mban përgjegjësi dhe nuk ka për qëllim me këtë fjalë përforcimin dhe vërtetimin e realizimit të asaj që mori përsipër³¹, e shprehje të tjera të ngjashme. Në këtë rast nuk e ka detyrë komunikimin e selamit.

E dyta: E merr përsipër komunikimin e selamit duke thënë: Do tia komunikoj selamin tënd ose do tia komunikoj inshallah, duke pasur për qëllim përforcimin dhe vërtetimin e realizimit të asaj gjëje, apo shprehje të tjera të ngjashme.

³¹ Sh.p: Fjala inshallah thuhet duke pasur për qëllim mbështetjen e asaj gjëje në dëshirën e Allahut por mund të thuhet dhe në formë përforcimi dhe vërtetimi të realizimit të diçkaje siç gjendet në suren Fet-h: 27 dhe në duanë e varrezave.

Në këtë rast e ka detyrë komunikimin e tij, sepse e mori përsipër si amanet duke ia bërë detyrë vetes këtë gjë. Argumenti për këtë gjykim janë përgjithësimet e ajeteve dhe haditheve³² të cilat vërtetojnë obligueshmërinë e ruajtjes së amanetit dhe çuarjen e tij në vend. Allahu e di më së miri.

Mënyra se si e kthen selamin ai që iu komunikua.

Nëse dikush të komunikon selamin e dikujt për ty, e ke për detyrë tia kthesh selamin. Pra, nëse komunikuesi të thotë: Filani të bën selam ose Filani të përshëndet me selam, ti do përgjigjesh: ue alejhisselam (edhe mbi atë qoftë selami), nëse shton ue rahmetullahi ue berekatuhu, është gjë e mirë dhe e pëlqyeshme. Kjo duke u bazuar në atë që transmetohet në dy Sahihet nga Aishja radijallahu anha se Profeti salallahu alejhi ue selem i tha asaj një ditë prej ditësh: “Oj Aishe, ky është Xhibrili po të bën selam. Ajo tha: ue alejhisselam ue rahmetullahi ue berekatuhu” Ky është teksti i Buhariut. Gjithashtu duke u bazuar në parimin se kthimi i selamit është uaxhib, ndaj thënia është e njëjtë sin ë mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu dhe në komunikim. Neueuiu në shpjegimene tij të Sahihu Muslimit 15/211 në lidhje me hadithine mësipërm të Aishes ka thënë: Dijetarët tanë (të medhhebit) kanë thënë: Kthimi i këtij selami është detyrë e menjëhershme (sapo t'i komunikohet), po ashtu të njëjtin gjykim ka, nëse i komunikohet selami nga një i largët

³² Në përgjithësimin e këtyre ajeteve dhe haditheve ka kundërpërgjigje ndaj shpjeguesit të librit el Edebul mufrad, shejh Fadlullah el Xhejlani i cili thotë në lidhje me këtë fjalë të Ibn Haxherit: Le ta zëmë se komunikimi i selamit i përngjason amanetit, ama çfarë argumenti ka që vërteton se zbatimi i amanetit është detyrë?! (mbaroi) Thashë (autori): Argumenti për këto është fjala e Allahut: “**Me të vërtetë Allahu ju urdhëron që tua jepni amanetet të zotëve të tyre**” [Nisa: 57] Ky ajet është i përgjithshëm dhe përfshin gjërat materiale si psh pasuritë, po ashtu dhe gjërat kuptimore (metafizike) psh dituria, etj. Në librin el Musanef të Abdu Rrazakut 10/393 transmetohet nga Ebu Kilabeh se një person erdhi tek Selman el Farisij dhe tha: Ebu Derda të thotë: Alejkes - selam. Tha (Selmani) Kur ke mbërritur? Tha: Që prej tre ditësh. Tha: Nëse ti nuk do ta komunikojë këtë selam do të ngelej amanet tek ti.

nëpërmjet letrës, e ka detyrë t'ia kthejë selamin me të shqiptuar menjëherë sapo ta lexojë atë. (Mbaroi)

A duhet t'ia kthejë selamin duke e përfshirë dhe komunikuesin (ndërmjetësin) duke thënë: Alejhi ue alejkes-selam (mbi të dhe mbi ty qoftë selami)? Në hadithin e Aishes shihet se ajo ia ktheu selamin vetëm Xhibrilit, gjë e cila tregon se obligimi i kthimit të selamit ka të bëjë me dërguesin e selamit dhe jo me komunikuesin (ndërmjetësin), por janë transmetuar hadithe të tjera që tregojnë se lejohet t'i kthehet selami dërguesit dhe komunikuesit sbashku. Më i miri nga këto hadithe është ai që ka transmetuar Nesaiu në librin e tij *Amelul jeumi uel- lejleh* fq.301 nga Xhafer bin Sulejman nga Thabiti nga Enesi radijallahu anhu i cili tha: Erdhi Xhibrili tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe në praninë e tij ishte Hadixheja radijallahu anha. Ai tha: Vërtet Allahu i dërgon selam Hadixhesë. Ajo tha: Me të vërtetë Allahu është es-Selam. Mbi Xhibrilin qoftë selami dhe mbi ty (dmth. Profetin) qoftë selami dhe mëshira e Allahut (ue alejkes-selamu ue rahmetullahi)”.

el Hakimi në librin e tij *el Mustedrak* 3/186 ka thënë: Hadithi është i saktë në përputhje me kushtin e Muslimit edhe pse ai vetë nuk e ka transmetuar.³³ El Hafidh(Ibn Haxheri) heshti dhe nuk dha gjykim për të në *el Fet-h* 7/139, ndërsa Ibn Muflihi në *el Adab* 1/419 ka thënë: Është e pëlqyeshme që t'i jepet selam edhe komunikuesit të selamit. Dikush i tha imam Ahmedit: Filani të dërgon selam, tha: alejke ue alejhis-slam (mbi ty dhe mbi të qoftë selami). Ndërsa në një rast tjetër tha: ue alejke ue alejhis-selam (edhe mbi ty edhe mbi atë qoftë salami. Neueuiu në *el Edhkar* fq 212 ka thënë: Preferohet që

³³ Në zinxhirin e këtij hadithi gjendet Xhafer bin Sulejmani i cili është i përfolur, kështuqë e sakta në lidhje me këtë transmetues është të thuhet se hadithi që ai transmeton është i mirë (hasen), siç tha el Hafidhu për të : saduk por ka mendime të shiave. Duke u bazuar në këtë që thamë arrijmë në përfundimin se zinxhiri i hadithit është hasen (i mirë).

Sh.p: Termi saduk është një epitet që tregon një nga shkallët e besueshmerisë dhe vërtetësisë së transmetuesit. Kush cilësohet si i tillë është një gradë më poshtë se vlerësimi thikah (i besueshëm).

tia kthejë selamin gjithashtu edhe komunikuesit duke thënë: ue alejke ue alejhis-selam.

Shoqërimi i selamit me përqafim

Disa njerëz të thjeshtë (auam) mendojnë (besojnë) se ashtuqë përshëndetja të jetë sa më e plotë, duhet të shoqërohet me përqafim, pra sa herë që t'i japë dikujt selam e përqafon dhe madje ndoshta dikush prej tyre zemërohet nëse nuk silllesh me të në përshëndetje me këtë lloj mënyre. Në Sunet ka ardhur ndalimi i qartë nga ky lloj veprimi (në përshëndetje) siç transmetohet në Musnedin e imam Ahmedit, në sunenin e Tirmidhiut dhe atë të Ibn Maxhes nga Enes bin Maliki radijallahu anhu se ai tha: Një person tha: O Rasulullah, kur dikush nga ne e takon shokun e tij, a i përkulet atij? Profeti salallahu alejhi ue selem tha: Jo. Tha: A e mbështet për trupi dhe e puth? Tha: Jo. Tha: A ia jep dorën? Tha: Po”.

Në transmetimin e Ahmedit thuhet: “Po, nëse do” ndërsa në transmetimin e Ibn Maxhes: “Jo, por jepjani dorën njëri tjetrit”. Tirmidhiu tha për hadithin: Hasen³⁴. Hadithi tregon se personi kur takon shokun e tij mjaftohet me selamin dhe dhënien e dorës, por përjashtohet nga ky gjykim përqafimi i atij që kthehet nga udhëtimi, sepse në këtë rast kjo gjë është e pëlqyer duke u bazuar në atë që është saktësuar nga Enes bin Maliki radijallahu anhu se ai ka thënë: Shokët e Profetit salallahu alejhi ue selem ishin që kur takoheshin i jepnin dorën njëri tjetrit ndërsa kur ktheheshin nga udhëtimi përqafoheshin”. E ka transmetuar Taberani në el Euset. Hejthemiu në librin e tij Mexhmeu ez Zeuaid ka thënë për këtë ether: Transmetuesit e tij janë transmetuesit e Sahihut. (Mbaroi)

Ky ether tregon se sahabët kur takoheshin me njëri tjetrin mjaftoheshin me dhënien e dorës, përveçse kur dikush kthehej nga udhëtimi, atëherë e përqafohin dhe e puthnin.

Vërejtje: Shumë njerëz gabojnë në përqaftimin që i bëjnë të afërmeve të të vdekurit gjatë ngushëllimit të tyre, sepse

³⁴ Po ashtu dhe Albani e konsideroi hasen.

përqaftimi i përshtatet gëzimit dhe jo hidhërimit. Gjithashtu sepse ky veprim hyn në ndalimin e lartpërmendur dhe në kundërshtimin e sunetit dhe në mospërputhjen me menhexhin e selefëve. Allahu e di më së miri.

Ngritja në këmbë për atë që hyn (brenda në shtëpi apo në mexhli kudo qoftë) në momentin që përshëndetet me të.

Çështja e të ngriturit në këmbë për atë që hyn brenda është bërë problematike dhe janë shtuar shumë mospajtimet dhe debatet rreth saj. Para se te fillojmë në trajtimin e kësaj çështjeje kam dëshirë të cek dy gjëra të cilat duhet që nxënësi i dijes të ketë parasysh kur bëhet fjalë për çështjen në fjalë apo çështje të tjera të ngjashme të bazuara në ixhtihad³⁵ në të cilat ndodh mospajtimi rreth mënyrës së kuptimit të argumenteve në varësi të muxhtehidave:

E para: Nuk duhet të ketë qortim në lidhje me çështjet ixhtihadije (të bazuara në ixhtihad). Dmth: Nëse rreth një çështjeje mund të ketë këndvështrime të ndryshme të bazuara në argumente ose ndryshon mënyra e të kuptuarit të qëllimit të argumenteve të asaj çështjeje dhe e sakta në këtë rast nuk është e qartë si dielli, në këtë rast nxënësi i dijes duhet të **përmendë atë që ka kuptuar dhe përfundimin në të cilin ka arritur pas përpjekjeve të bëra për të kuptuar çështjen, i përgjigjet argumenteve të palës tjetër duke i debatuar ato dhe me kaq mjaftohet. Sepse nëse do të qortojë veprimin e atij që nuk është dakort me të në këtë çështje, atëherë do të dalë dikush tjetër që do e qortojë këtë dhe zgjedhjen e tij, duke bërë që çështja të shndërrohet në një cikël ta pafund kritikash dhe qortimesh duke bërë që muslimanët të harrojnë dhe lënë pas dore gjëra më të rëndësishme se sa kjo çështje, duke i shtuar kësaj dhe shpërqendrimin e njerëzve të thjeshtë dhe hutimin e tyre.**

E dyta: Obligueshmëria e marrjes në konsideratë të parimit fetar: Nëse njeriu ndodhet ndërmjet dy të këqijave (duke mos

³⁵ Sh.p: Ixhtihadi: Është përpjekja që bën dietari muxhtehid dhe dhënia e mundit maksimal për të nxjerrë gjykimin në një çështje të caktuar nëpërmjet studimit dhe kuptimit të argumenteve.

qenë e mundur shmangia e tyre) atëherë do i shmanget dëmit më të madh duke vepruar atë më pak të dëmshmen.

Po ashtu dhe parimin tjetër: i jepet përparësi shmangies së dëmeve ndaj arritjes së të mirave(dobive,interesave).

Pas kësaj parathënieje le të hyjmë në temë:Dijetarët kanë mospajtim rreth kësaj çështjeje, si në kohët e hershme po ashtu dhe në ato bashkëkohore:Pra a lejohet ngritja për atë që hyn apo është e ndaluar, apo lejohet për një kategori të caktuar dhe ndalohet për pjesën tjetër,etj.Para se të trajtojmë mospajtimin e dijetarëve, le të bëjmë të qartë se cila është pika e mospajtimit mes dijetarëve.Ngritja në këmbë është disa llojesh:

1. Ngritja (qëndrimi) në këmbë mbi personin.

Dmth: Një person apo më shumë qëndrojnë të ngritur në këmbë pranë një personi tjetër që është i ulur, siç ndodh me mbretërit dhe udhëheqësit. Kjo lloj ngritjeje në këmbë është e ndaluar sepse ka ardhur ndalim i qartë në hadithin e Xhabirit radijallahu anhu , teksti i të cilit është si mëposhtë: U sëmur Profeti salallahu alejhi ue selem dhe u fal ulur, ndërsa ne faleshim (në këmbë) pas tij, Ebu Bekri radijallahu anhu i komunikonte njerëzve tekbirot e tij (Profetit salallahu alejhi ue selem). Papritmas (Profeti salallahu alejhi ue selem) ktheu kokën anash dhe na pa që faleshim në këmbë, na bëri me shenjë që të uleshim, u ulëm dhe u falëm ulur siç falej ai. Pasiqë dha selam tha: “Qëparë për pak sa nuk po vepronit ashtu siç vepronë persët dhe romakët, të cilët qëndrojnë në këmbë tek mbretërit e tyre kur ata rrinë ulur, mos e bëni diçka të tillë”³⁶. Përrjashtohet nga ky ndalim nëse ka dobi nga ky qëndrim.Ibn Muflihi në el Adab 1/460 ka thënë: Ndërsa qëndrimi në këmbë për diçka të dobishme p.sh: Siç bëri Malik bin Jesari i cili rrinte në këmbë duke mbajtur një degë peme

³⁶ Transmeton Muslimi në Sahihun e tij 1/176.

mbi kokën e Profetit salallahu alejhi ue selem (për t'i bërë hije) në kohën e mbajtjes së besëlidhjes. Këtë hadith e transmeton Muslimi. Po ashtu ka vepruar dhe Ebu Bekri radijallahu anhu për t'i bërë hije Profetit salallahu alejhi ue selem. Kjo është e pëlqyer.

2. Ngritja në këmbë për të uruar apo ngushëlluar.

Kjo lloj ngritjeje është e lejuar sepse Profeti salallahu alejhi ue selem ia miratoi Talha bin Ubejdullahit ngritjen që bëri për të përgëzuar Kab bin Malikun radijallahu anhum për pranimin e teubes nga Allahu. Mëposhtë po sjellim fragmetin e asaj ngjarjeje që dëshmon për këtë që thamë. Kabi tha: Derisa hyra në xhami, aty ishte i ulur Profeti salallahu alejhi ue selem dhe rreth tij qëndronin njerëzit. Atëherë Talha bin Ubejdullah u ngrit me vrap dhe më dha dorën e më përgëzoi. Uallahi askush tjetër nga muhaxhirët nuk u ngrit përveç Talhas, ndaj Kabi nuk ia harroi kurrë këtë veprim Talhas”. Të njëjtin gjykim merr dhe ngushëllimi, sepse përderisa u lejua ngritja në këmbë në kulmin e gëzimit, atëherë lejimi i saj në kulmin e pikëllimit është më parësore. Uallahu ealem.

3. Ngritja në këmbë për të ndihmuar të pafuqishmin.

Kjo lloj ngritjeje është e pëlqyeshme, duke u bazuar në atë që është saktësuar në Musnedin e imam Ahmedit nga Aisheja radijallahu anha në lidhje me ngjarjen e fisit jehudi Benu Kurejdah, ndër të tjera: Ebu Seidi tha: Kur mbërriti Sad ibn Muadhi tek Profeti salallahu alejhi ue selem , ai (Profeti) tha: “Ngrihuni për tek zotëriu juaj dhe zbriteni (nga kafsha)”. Umeri radijallahu anhu ka thënë: Zotëriu ynë është Allahu. Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Zbriteni” dhe e zbritëm. Ibn Haxheri në el Fet-h ka thënë: Zinxhiri i tij është hasen (i mirë). Ky transmetim na bën të qartë se urdhëri i

Profetit salallahu alejhi ue selem që të ngriheshin për tek ai, ishte për shkak që ta ndihmonin sepse ishte plagosur në luftën e Hendekut. Nga kjo ngjarje përfitohet pëlqyeshmëria e ngritjes në këmbë për të ndihmuar të pafuqishmin (të dobëtin). Nëse ngritja për të cilën Profeti salallahu alejhi ue selem i urdhëroi, do të ishte për një arsye tjetër përveç kësaj që përmendëm, atëherë urdhëri nuk do të ishte i veçantë vetëm për ensarët. Këtë e tha Ibnul Haxhi në el-Med-khal 1/159, i cili gjithashtu tha: Nëse ngritja për Sadin do të ishte në formë respekti dhe nderimi, atëherë Profeti salallahu alejhi ue selem do ishte i pari që do ngrihej dhe do urdhëronte për diçka të tillë më të dalluarit e sahabëve që ishin të pranishëm, por përderisa nuk i urdhëroi që ta bënin, as vetë nuk e bëri dhe as nuk e bënë të tjerët (përveç ensarëve). Kjo tregon se urdhëri i tij (për ensarët) që të ngriheshin për tek ai, është çështje tjetër, e ndryshme nga ajo për të cilën ka ndodhur mospajtimi mes dijetarëve, sepse ata u ngritën që ta zbrisnin nga kafsha e tij për shkak të sëmundjes që kishte.

4. Ngritja në këmbë e birit për babain e tij ose gruaja për burrin e saj dhe e kundërta.

Kjo lloj ngritjeje është e lejuar duke u bazuar në atë që është transmetuar në Sahihul Buhari nga Aisheja radijallahu anha në hadithin që flet rreth ngjarjes së shpifjes, ndër të tjera thotë (Aisheja): Nëna ime më tha mua: Ngrihu për tek ai (Profeti salallahu alejhi ue selem). Thashë: Uallahi nuk do ngrihem për tek ai, vërtet që unë nuk falënderoj dikë tjetër përveç Allahut”. Profeti salallahu alejhi ue selem e miratoi thënien e nënës së Aishes (për tu ngritur në këmbë për burrin). Gjithashtu nga ky hadith përfitohet lejimi i ngritjes për urim ose përgëzim, siç e thamë më heret.

Po ashtu transmetohet nga Aisheja radijallahu anha se ajo tha: Nuk kam parë askënd që t’i përngjasojë më shumë Profetit

salallahu alejhi ue selem në paraqitje, në qëndrim, në udhëzim - Hasani tha: në të folur dhe bisedim - se sa Fatimeja. Kur ajo hynte tek Profeti salallahu alejhi ue selem , ai ngrihej tek ajo, e merrte për dore, e puthte dhe e ulte në vendin ku ishte i ulur vetë. Po ashtu kur Profeti salallahu alejhi ue selem e vizitonte atë, ajo ngrihej tek ai, ia merrte dorën, e puthte dhe e ulte në vendin ku ajo ishte e ulur³⁷. Nga ky hadith përfitohet lejimi i ngritjes në këmbë të fëmijës për prindërit dhe e kundërta. Në të njëjtin gjykim përfshihet dhe nëna, xhaxhai, daja dhe tezja. Allahu e di më së miri. Hanbeli e pyeti imam Ahmedin –siç është një nga transmetimet nga ai- duke i thënë: A e konsideron të lejuar që personi të ngrihet për dikë kur e sheh atë? Tha: Jo, nuk duhet të ngrihet askush për askënd përveçse fëmija për babain ose nënën e tij, kurse për të tjerët përveç prindërve jo. Profeti salallahu alejhi ue selem ka ndaluar nga diçka e tillë³⁸.

U pyet imam Maliku në lidhje me bashkëshorten e cila dëshiron ta respektojë dhe nderojë burrin e saj, sa më shumë, duke i dalë përpara për ta pritur, ia heq rrobat dhe qëndron në këmbë derisa të ulet (burri), tha: Dalja dhe pritja nuk ka problem ndërsa qëndrimi në këmbë nuk lejohet sepse kështu veprohet me despotët.Umer ibn AbdulAzizi e ka refuzuar (urryer) një veprim të tillë³⁹.

³⁷ Transmeton Ebu Daudi në Sunenin e tij 20/155(Sh.p: E ka saktësuar Albani).Ibn Muflihi në el Adab pasi që përmendi zinxhirin e këtij hadithi, tha: Zinxhiri i tij është i saktë, e ka transmetuar Nesaiu dhe Tirmidhiu dhe ky i fundit tha: Sahih.

³⁸ Marrë nga el Adab të Ibn Muflihut 1/463.

³⁹ Marrë nga Fet-hul Bari 11/51.

5. Ngritja në këmbë për atë që vjen nga udhëtimi.

Kjo lloj ngritjeje është e lejuar, sepse sahabët ishin që kur vinin nga udhëtimi përqafoheshin. Ibn Muflihi në el Adab 1/459 ka thënë: Përqaqimi nuk mund të realizohet veçse duke u ngritur në këmbë. Muthena e pyeti Ebu Abdullah Ahmed ibn Hanbelin: çfarë mendimi ke për përqaqimin? Dhe a lejohet që dikush të ngrihet për dikë për t'i dhënë selam kur e sheh? Tha: Nuk lejohet të ngrihet askush për askënd, ndërsa nëse vjen nga udhëtimi nuk di të ketë ndonjë problem (ndalesë) në qoftë se e bën nga lidhja për fe` dhe dashuria për Allah, duke u bazuar në hadithin e Xhaferit radijallahu anhu se Profeti salallahu alejhi ue selem e përqafoi atë dhe e puthi në ballë mes dy syve.

6. Ngritja për të pritur dikë që po vjen.

Pra, ngrihet një person nga vendi ku është i ulur për të pritur dikë që po vjen tek ai, kjo është e lejuar. El Alameh Ibnul Kajimi i konsideroi hadithet e transmetuara në lidhje me ngritjen e Profetit salallahu alejhi ue selem për Fatimen dhe ngritjen e saj për të, se ato kanë të bëjnë me këtë lloj ngritjeje. Ai duke u munduar të bëjë bashkim dhe përputhje mes haditheve që ndalojnë nga ngritja në këmbë dhe haditheve që e lejojnë, tha: Përsa i përket haditheve të mësipërme (ngritja e Profetit salallahu alejhi ue selem për Fatimen) ngritja e përmendur në to ishte për arsye të pritjes së atij që po vinte, ishte ngritje për tek personi për ta pritur dhe takuar dhe nuk ishte ngritje për të (për hir të tij, thjesht ngritje ulje nderimi), ky është kuptimi i hadithit të Fatimes.

Pra, e ndaluar është ngritja për personin (për hir të tij), ndërsa për tek ai, për ta mirëpritur kur vjen, lejohet dhe nuk ka

problem. Në këtë mënyrë përputhen hadithet mes tyre. Uallahu ealem⁴⁰.

Po ashtu në një fragment tjetër në po të njëjtin libër (8/93) Ibnul Kajjimi thotë: Ka dallim ndërmjet ngritjes për personin dhe ngritjes mbi personin, siç bënin persët dhe romakët, të cilat që të dyja janë të ndaluara dhe mes ngritjes për tek personi, kur ai vjen, e cila është traditë e arabëve, sepse hadithet tregojnë vetëm lejimin e kësaj të fundit.

Ibn Haxheri në el Feth 11/51 ka sjellur fjalën e Ibnul Kajimit të marrë nga libri Hashijetus Sunen, ky është teksti i fjalës së tij: Ibnul Kajimi ka thënë: Ngritja në këmbë ndahet në tre lloje:

- a) Qëndrim në këmbë mbi kokën e dikujt, kështu veprohet me despotët
- b) Ngritje për tek dikush që po vjen, kjo lejohet.
- c) Ngritje për dikë kur e sheh atë. Në këtë ka mospajtim.

7. Ngritja në këmbë kur e sheh dikë.

Domethënë: Njerëzit janë të ulur në mexhlis dhe hyn dikush, ata ngrihen për të dhe i japin selam. Janë shtuar polemikat rreth gjykimit të këtij lloji ngritjeje, por fjala më e saktë – ishaAllahu- është ndalimi i saj dhe konsiderimi haram, sepse janë transmetuar argumente të sakta që ndalojnë nga kjo dhe sepse hadithet e tjera me të cilat argumentohen ata që e lejojnë ose janë të sakta por nuk argumentojnë qartë për atë që thonë ose janë të sakta dhe nuk ka asnjëlloj mënyrë të argumentuari me to për çështjen në fjalë ose janë të pasakta fare.

Ndër argumentet e ndalimit:

⁴⁰ Marrë nga Hashijetus-Sunen 8/84.

Transmeton imam Ahmedi në Musnedin e tij 20/353, Ebu Daudi në Sunenin e tij 20/167, Tirmidhiu etj, nga Ebu Mixhlezi se Muauija hyri në një shtëpi ku ishte Ibn Amir dhe Ibn Zubejri. Ibn Amiri u ngrit në këmbë ndërsa Ibn Zubejri qëndroi ulur. Muauija tha: Ulu, sepse vërtetë unë e kam dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem duke thënë: “Kush dëshiron (është i kënaqur) që t’i ngrihen robërit (e Allahut) në këmbë le t’ia përgatisë vetes një ulës (karrige) në zjarr”, ky është teksti i imam Ahmedit. Tirmidhiu tha: Hadithi është hasen (i mirë)⁴¹

Ky hadith tregon ndalimin e ngritjes në këmbë kur sheh atë që po hyn. Mënyra e të argumentuarit me këtë hadith është se sahabiu i nderuar, transmetuesi i hadithit: Muauija, kuptoi nga ky hadith ndalimin e ngritjes në këmbë për atë që hyn dhe asnjë nga të pranishmit aty nuk e kundërshtoi këtë lloj kuptimi. Ky gjykim dihej tek sahabët, ndaj Ibn Zubejri nuk u ngrit për Muauijen kur ai hyri. Është argumentuar me këtë hadith për ndalimin e ngritjes në këtë formë el alameh Ibnul Kajimi dhe bëri të qartë aspektin e të argumentuarit me hadithin dhe iu kundërpërgjigj atyre që pretendojnë se hadithi nuk e përfshin këtë lloj ngritjeje. Fjala e tij gjendet në Hashijetus Sunen 8/93 dhe në mënyrë të përmbledhur mund të themi se Ibnul Kajimi ceku pikat e mëposhtme:

a. Kundërpërgjigjia ndaj atyre që pretendojnë se ky hadith përfshin vetëm ngritjen mbi personin siç bënin persët dhe romakët. Ky pretendim hidhet poshtë për disa arsye:

1. Teksti i hadithit të Muauijes tregon të kundërtën e këtij pretendimi.

⁴¹ Sh.p: Hadithin e ka saktësuar dhe Albani.

2.Profeti salallahu alejhi ue selem i ndalonte njerëzit që të ngriheshin për të kur ai dilte tek ta.

3.Arabët nuk e njihnin një veprim të tillë.

4.Kësaj lloj ngritjeje nuk i thuhet ngritje për personin por ngritje mbi personin.

- b. Ky hadith tregon ndalimin e ngritjes për personin. Ibnul Kajimi në el Hashijeh 8/48 në lidhje me këtë hadith tha: Në të ka kundërpërgjigje ndaj atyre që pretendojnë se kuptimi i hadithit është: Të qëndrojnë në këmbë për dikë i cili rri ulur, sepse Muauija transmetoi hadithin për shkak të atij që u ngrit në këmbë kur ai hyri.

Ibnul Haxhi në el Med-khal 1/185 ka thënë: Shiko –Allahu të mëshiroftë ty dhe ne- se si Muauija radijallahu anhu i cili e kishte marrë hadithin drejtëpërdrejtë nga goja e bartësit të shariatit -salallahu alejhi ue selem - ndaloi nga ngritja në këmbë në mënyrë të përgjithshme, sepse kështu e kishte kuptuar hadithin, ndaj kërkohet që të pasohet në kuptimin dhe fikhun e tij.(mbaroi fjala e tij)

Nëse dikush thotë: Fjala e Profetit salallahu alejhi ue selem : “Kush dëshiron (është i kënaqur) që robërit (e Allahut) t’i ngrihen në këmbë le tia përgatisë vetes një ulëse në zjarr”, tregon se njeriu e meriton këtë kërcënim nëse e dëshiron dhe e pëlqen që njerëzit të ngrihen në këmbë, ndërsa nëse nuk e dëshiron diçka të tillë, atëherë nuk ka asnjë përgjegjësi për të, po ashtu nuk ka problem as për personin që ngrihet për të sepse në hadith nuk u përmend fare ai që ngrihet dhe nuk ka ndonjë kërcënim për të.

Për t’iu përgjigjur këtij dyshimi kemi nevojë për një parathënie të shkurtër:

Së pari: Dallimi mes atij që nuk e pëlqen që njerëzit t'i ngrihen në këmbë dhe atij që e pëlqen, është diçka e pamundur për njerëzit.

Së dyti: Bashkëpunimi për vepra të mira, devotshmëri dhe largimi nga bashkëpunimi në gjynahe e shkelje të dispozitave është obligim me shariat. Mbi këtë parim bazohen gjykime të panumërta.

Pas kësaj që thamë bëhet e qartë se mosngritja në këmbë është detyrë për t'i mbyllur shtigjet e së keqes sepse ti nuk mund ta dish a e pëlqen ai person për të cilin u ngrite apo jo. Përderisa këtë gjë nuk mund ta dish, atëherë t'i japësh përparësi ndalimit është më e sigurtë, sepse shpirtat e njerëzve e kanë në natyrë dëshirën për tu madhëruar nga të tjerët dhe çështja për të cilën po flasim është një nga situatat ku mund të ndodhë diçka e tillë, ndaj ndalohet ngritja në këmbë duke bashkëpunuar për vepra të mira dhe devotshmëri.

E qartëson këtë edhe më shumë ajo që imam Ahmedi ka transmetuar në el Musned 3/132 dhe Tirmidhiu nga Enes bin Maliki radijallahu anhu i cili ka thënë: Askush nuk ishte më i dashur për sahabët se sa Profeti salallahu alejhi ue selem, e megjithatë ishin ⁴² që kur e shihnin nuk ngriheshin në këmbë për të sepse e dinin urrejtjen e tij ndaj këtij këtij veprimi.

Tirmidhiu tha: Hadithi është hasen sahih ⁴³.

Vëre dhe medito në këtë udhëzim madhështor profetik ashtuqë të të bëhet i qartë udhëzimi i tij dhe kujdesi që i kushtonte mbylljes së shtigjeve dhe shkaqeve që çojnë në haramë e të këqija. Ky ishte i Dërguari i Allahut i cili i edukonte shokët e tij që të mos ngriheshin për të dhe ata e

⁴² Sh.p: Folja “ishte” në përgjithësi tregon shpeshhtësinë e përsëritjes së atij veprimi nga vepruesi në fjalë, si p.sh. në këtë hadith, por ka disa hadithe që folja: “ishte” tregon të kundërtën, pra ndodhinë e atij veprimi vetëm një herë ose shumë rrallë.

⁴³ Sh.p: Gjithashtu e ka saktësuar dhe Albani

përvetësuan këtë edukatë, prandaj dhe nuk ngriheshin për të, megjithëse ishte personi më i dashur për ta. U takon poseduesve të dijes ta zbatojnë këtë udhëzim dhe t'i ndalojnë njerëzit e thjeshtë (masat e popullit) nga ai veprim ashtuqë të përhapet Suneti dhe të lartësohet flamuri i tij. Askush nuk mund ta sigurojë veten se nuk mund ta dojë ngritjen e njerëzve në këmbë për të dhe nëse kjo ndodh e përfshin qartazi kërcënimi i ashpër që u përmend në hadith.

çfarë i pengon muslimanët e thjeshtë që ta praktikojnë këtë udhëzim profetik dhe me këtë veprim ata shmangin sherrin nga dijetarët e tyre, të dalluarit e tyre dhe prijësit e tyre? Të vjen shumë keq kur sheh ndonjë “dijetar” që i vrenjtet fytyra nëse nuk ngrihesh në këmbë për të. Nëse do t'i flasësh për këtë çështje do mundohet të justifikohet me hadithe që e lejojnë diçka të tillë - që në të vërtetë nuk janë hadithe të sakta ose nuk ka argument në to për këtë çështje- duke harruar që edhe nëse le ta zemë se ato hadithe tregojnë për lejimin e saj, çfarë do bëjë me këtë hadith i cili qartëson udhëzimin e Mustafasë salallahu alejhi ue selem në lidhje me ngritjen në këmbë?! A nuk është ai njeriu më i meritueshëm për tu pasuar dhe marrë për shembull? Në këtë udhëzim profetik kemi kundërpërgjigjen më të përsosur ndaj atyre që pretendojnë se ngritja në këmbë për dijetarët e të ngjashëm me ta në pozitë, në formë respekti dhe nderimi është e pëlqyeshme dhe sunet.

el Alameh muhadithi Albani ka thënë: Nëse ngritja në këmbë do të ishte nderim i konsideruar në shariat atëherë nuk do ishte e lejuar për shokët e Profetit salallahu alejhi ue selem ta urrenin këtë traditë dhe të tregonin mungesë respekti për Profetin(duke mos u ngritur për të) sepse ai është njeriu më i merituar për tu nderuar dhe njëkohësisht ata (sahabët) janë njerëzit që e njohin më së miri të drejtën e tij ndaj besimtarëve.

Përsa i përket fjalës së atij që thotë: Ai që ngrihet në këmbë nuk ka ndonjë përgjegjësi (gjynah) sepse ai nuk u përmend gjëkund në hadith dhe as nuk u kërcënua me ndonjë dënim. Përgjigjia është të themi: Muauijetu bin Ebi Sufjan – transmetuesi i hadithit- është një ndër fukahatë e sahabëve dhe ai u argumentua me këtë hadith të cilin veshi i tij e ka dëgjuar nga goja e Profetit salallahu alejhi ue selem , për ndalimin e ngritjes në këmbë për atë që hyn , gjithashtu ia miratoi këtë argumentim Ibn Zubejri i cili është sahabij, po ashtu bënë edhe të pranishmit e tjerë, ndaj kuptimi i tyre në lidhje me këtë hadith është më i meritueshëm për t’i dhënë përparësi se sa kuptimi i të tjerëve pas tyre. Ai që mediton në këtë çështje e kupton se ai që ngrihet në këmbë ka pjesën e tij të kërcënimit si shpërblim për ndihmën që i jep shejtanit ndaj vëllaut të tij që vjen dhe hyn në atë mexhlis. Uallahu ealem. Imamllarët e daues⁴⁴, janë pyetur me pyetjen e mëposhtme: çfarë mendimi keni në lidhje me ngritjen në këmbë për emirat (prijësat), dijetarët dhe njerëzit e nderuar, ashtu siç veprojnë persët dhe romakët. Disa të kapur pas fesë japin fetva se ngritja në këmbë lejohet për dijetarët dhe njerëzit e nderuar? Përgjigje: Nuk lejohet ngritja në këmbë për dijetarët e as për emirat duke bërë që të praktikohet ky veprim si traditë dhe zakon, madje ky veprim është nga veprimet e njerëzve të xhahilijetit dhe sundimtarëve zullumqarë (despotë) si p.sh: mbretërit e persëve dhe romakëve, etj. Ata e bënin diçka të tillë me parinë e tyre.

⁴⁴ Sh.p: Me këtë shprehje ka për qëllim shejhun Muhamed bin Abdul Uehab dhe pasardhësit e tij dijetarë të cilët morën përsipër ripërtëritjen e thirrjes së teuhidit dhe sunetit në zonën e Nexhdit dhe Hixhazit dhe që më pas u kurorëzua me formimin e shtetit Saudi (Allahu e ruajtë nga çdo e keqe dhe intrigë dhe e përforcoftë në të vërtetën). Gjurmët dobiprurëse dhe mirësitë e pashtershme të kësaj daveje vazhdojnë të jenë të dukshme qartazi edhe sot e kësaj dite për çdokënd i cili ka dy sy dhe një mendje të shëndoshë.

Është vërtetuar se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kujt i pëlqen që t’i ngrihen njerëzit në këmbë le t’i përgatisë vetes një ulëse në zjarr”, ndërsa në një hadith tjetër nga Enesi radijallahu anhu se ai tha: Askush nuk ishte më i dashur për sahabët se sa Profeti salallahu alejhi ue selem, e megjithatë ishin që kur e shihnin nuk ngriheshin në këmbë për të sepse e dinin urrejtjen e tij ndaj këtij veprimi....⁴⁵.

Në bazë të kësaj që thamë dalim në përfundimin se:

Ngritja në këmbë kur e sheh atë që hyn është diçka e ndaluar, ndaj kërkohet nga muslimanët që të shmangen nga ky veprim dhe ta qortojnë atë që e bën diçka të tillë, si dhe t’i edukojnë fëmijët e tyre me moskryerjen e këtij veprimi ashtuqë të shpëtojnë nga dënimi dhe të pasojnë Profetin salallahu alejhi ue selem . Njëkohësisht kjo bën që të ruhet dashuria dhe harmonia mes njerëzve, e cila shpeshherë pëson çarje dhe ndarje për shkak të ngritjes apo jo në këmbë, sepse është një veprim i urryer tek natyra e pastër njerëzore për shkak të mundimit dhe sikletit që bart me vete. Ka raste që në disa mexhlise “duhet” të ngrihesh mbi njëzet herë si mikëpritje dhe nderim për atë që po vjen, kjo gjë i bën këto mexhlise të padëshirueshme, e ndoshta sjell bojkotimin e tyre dhe shmangien prej tyre, ashtu siç ndodh në realitet nga shumë njerëz.

Ibnul Imad ka përmendur një histori në librin e tij Shedheratu edh-Dheheb 3/123 që ia vlen ta përmendim këtu sepse i përshtatet çështjes në fjalë.

Ibn Betah kaloi pranë el Ahnef el Ukburij i cili u ngrit në këmbë për të. Kjo gjë Ibn Betas nuk i pëlqeu ndaj el Ahnefu thuri një poezi⁴⁶ në moment:

⁴⁵ Kjo përgjigje është marrë nga libri Mexhmuati Rasail 1/36

⁴⁶ Sh.p:Do përkthejmë kuptimet e vargjeve pa marrë përsipër paraqitjen e tyre në formë poezie

Mos më qorto pse u ngrita / sepse e meriton prej meje që të mos lodhem së ngrituri për ty sa herë që të të shoh / ti je njeriu më i nderuar tek unë / dhe është nga detyrat e mia që t'i respektoj të nderuarit.

Atëherë Ibn Betah iu përgjigj po me poezi:

Gjithmonë prej teje kam hasur respekt dhe shfaqje madhërimi / megjithëse ke meritë sepse je më i madh se unë (në moshë dhe dije) / ne nuk duam të të vemë në situatë sikleti e sforcimi / prandaj lëre mënjanë të ngriturën në këmbë / ose përndryshe do më detyrosh të të shpërblej për të ngriturën tënde me të ngritur / dhe unë e urrej shumë diçka të tillë / sepse në të ka shtirje dhe gjynah / mos e detyro vëllaun tënd të të takojë me diçka të ndaluar / nëse ndërgjegjet tona janë të pastra / nuk kemi nevojë të lodhim trupat tanë (me ulje-ngritje) / secili prej nesh është i bindur në dashurinë e vëllaut të tij / prandaj pse të sikletosemi dhe sforcohem.

Në librat e historisë janë transmetuar disa qëndrime që kanë mbajtur disa dijetarë ndaj kësaj çështjeje, po përmendim disa prej tyre që të jenë shembull për dijetarët e sotëm dhe që të shërbejnë si përforcues për ta në refuzimin e ngritjes në këmbë.

Ibn Kethiri në librin el Bidajetu uen-nihajeh 10/171 në ngjarjet e ndodhura në vitin 176H, ndër të tjera ka thënë: Në këtë vit vdiq Feraxh bin Fedaleh et-Tenukhij el Himsij.....nga mirësitë e tij është: Se një ditë Mensuri (prijësi) hyri në pallatin e artë, të gjithë u ngritën përveç Feraxh bin Fedaleh. Ai u zemërua dhe i tha atij: Pse nuk u ngrite? Tha: Kisha frikë se Allahu do më pyesë për këtë dhe do të të pyesë dhe ty: Pse ishe i kënaqur me diçka të tillë? Profeti salallahu alejhi ue selem e ka urreyer ngritjen në këmbë për njerëzit. Atëherë Mensuri qau, e afroi atë rreth vetes dhe ia kreu të gjitha nevojat që kishte.

Hatibul Bagdadi ka transmetuar në Tarihul Bagdad 11/360 nga AbduRrezak bin Sulejman bin Alij el Xhadi i cili tha: E kam dëgjuar babain tim duke thënë: Prezantuan tek Me`muni (khalifeja) disa të devijuar në akide (filozofë) dhe polemizoi me ta, pastaj Memuni u ngrit dhe doli për diçka personale , të gjithë u ngritën përveç Xhadit i cili nuk u ngrit. Memuni e vështrroi gjithë zemërim dhe e mori veçmas që t'i fliste, i tha: O shejh çfarë të pengoi të ngriheshe për mua siç bënë shokët e tu? Tha: E respektova prijësin e besimtarëve duke u bazuar në hadithin e trashëguar nga Profeti salallahu alejhi ue selem . Tha: Cili është ai hadith? Alij bin Xhadi ka thënë: E kam dëgjuar el Mubarek bin Fedaleh të thotë: E kam dëgjuar Hasenin(el Basrij) të thotë: Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush dëshiron që t'i ngrihen njerëzit në këmbë le tia përgatisë vetes një ulëse në zjarr”. Memuni qëndroi njëfarë kohe duke meditaruar rreth hadithit pastaj ngriti kokën dhe u tha shoqëruesve: Të mos blihet nga dikush tjetër përveç këtij shejhu. Tha (transmetuesi): Atë ditë u blenë prej tij në vlerën e 30,000 dinarëve.

Shejh Albani në Silsileh Sahihah 1/629 ka thënë: E ngjashme me këtë histori është dhe ajo që ka përmendur Dejnuri në el Munteka minel muxhaleseh 8/1: Na ka treguar Ahmed bin Alij el Basri i cili tha: Muteuekili (khalifeja) ftoi Ahmed bin el Adl e të tjerë nga ulematë që të mblidheshin tek shtëpia e tij. Pasiqë u mblodhën ai (khalifeja) doli, të gjithë u ngritën në këmbë përveç Ahmed bin el Adl. Muteuekili i tha Ubejdullahit: Ky person siç duket nuk na e ka dhënë besën (për bindje ndaj prijësit sepse nuk na konsideron prijës të ligjshëm). Ai i tha: Përkundrazi o prijës i besimtarëve, por e ka shikimin të dobët ⁴⁷. Atëherë Ahmed bin el Adl tha: O prijës i besimtarëve shikimi im nuk ka asnjë të metë por unë

⁴⁷ Sh.p: Duke u munduar ta justifikonte dijetarin për mosngritjen

të mbrojta ty nga shkakut i dënimit të Allahut. Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush dëshiron që t’i ngrihen njerëzit në këmbë le tia përgatisë vetes një ulëse në zjarr”.

Vërejtje: Kërkohet nga ata nxënës dije të cilët janë me mendimin se ngritja në këmbë për atë që vjen është haram, që tua tërheqin verëjtjen njerëzve nga kjo vepër duke bërë të qarta argumentet e ndalimit të saj dhe duke sqaruar udhëzimin e Profetit salallahu alejhi ue selem në këtë çështje, por gjithmonë duke pasur parasysh pikat e mëposhtme:

1. **Të mos tregohen të ashpër qoftë me fjalë apo me veprime gjatë refuzimit dhe qortimit të kësaj vepre.**
2. **Nëse qëndrimi i tyre ulur për atë që vjen, çon në urrejtje dhe zemërim – apo në çdo gjë tjetër të cilat me unanimitet janë të ndaluara dhe dëmi i së cilës është më i madh se dëmi i kësaj çështjeje – atëherë është detyrë ngritja në këmbë, por megjithatë kërkohet që ta bëjë të qartë gjykimin e kësaj çështjeje dhe të përpiqet t’i bindë, gjithmonë duke përdorur urtësinë dhe butësinë.**

Do mjaftohem në argumentimin për dy pikat e mësipërme me një fetua të shejhul islamit Ibn Tejmijeh, nëpërmjet së cilës bëhet e qartë mprehtësia e mendimit dhe e të kuptuarit, të cilat i posedonte ky imam në trajtimin e teksteve të shariatit. Ky është teksti i fetuasë:

U pyet shejhul islam, i vetmi i kohës së tij (i pakrahasueshëm me asnjë nga brezi i tij) Tekijud-din Ebul Abas Ahmed bin Abdil Halim bin Abdis-salam bin Tejmijeh, (Allahu e bekoftë shpirtin e tij dhe ia ndriçoftë varrin e tij): çfarë thonë dijetarët eminentë, prijësat e fesë - Zoti qoftë i kënaqur me të gjithë ata – në lidhje me ngritjen në këmbë të cilën njerëzit e kanë

bërë zakon në formë respekti kur vjen dikush që gëzon pozitë dhe konsideratë? A lejohet apo jo, në qoftë se atij që rri ulur ia merr mendja se ai që vjen zemërohet ose sikletoset dhe lëndohet përbrenda nëse nuk i ngrihen në këmbë, madje ndoshta shkon deri aty sa që lind tek ai urrejtje dhe armiqësi? Përgjigje: El Hamdu lillah: Nuk ka qenë nga zakoni i selefëve në kohën e Profetit salallahu alejhi ue selem dhe të halifeve të drejtë pas tij që të ngriheshin , ashtu siç e kishin zakon që tia kthenin selamin (atij që vinte) ndryshe nga ç'veprojnë sot shumë njerëz, biles Enes bin Maliki radijallahu anhu ka thënë: Askush nuk ishte më i dashur për sahabët se sa Profeti salallahu alejhi ue selem, e megjithatë ishin që kur e shihnin nuk ngriheshin në këmbë sepse e dinin urrejtjen e tij ndaj këtij veprimi”. Ishin që kur e shihnin nuk ngriheshin për të sepse e dinin që ai e urren këtë veprim por ndoshta ngriheshin për atë që vjen pas një kohe mungese siç është transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem se ai është ngritur për Ikrimen radijallahu anhu po ashtu u tha ensarëve kur erdhi Sad bin Ubadete: “Ngrihuni për tek zotëriu juaj”. E tha këtë kur erdhi Sadi nga Medineja ku po mjekohej, për të vajtur tek Beni Kurejdha (jehudët) në lindje të Medines që të gjykonte se si do veprohej me ta.

Duhet që njerëzit ta bëjnë zakon e traditë pasimin e selefëve ashtu siç ishin në kohën e Profetit salallahu alejhi ue selem sepse ata janë brezi më i mirë. Fjala më e mirë është fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit, prandaj mos të shmanget dikush nga udhëzimi i krijesës më të mirë dhe udhëzimi i brezit më të mirë, për të pasuar diçka të pavlerë. Kërkohet nga ai që i bindet Allahut, ta praktikojë këtë me shokët e tij në mënyrë të atillë që kur ta shohin të mos ngrihen për të e as ai të mos ngrihet për ta në takimet e zakonshme. Ndërsa ngritja për të pritur atë që vjen nga

udhëtimi apo të ngjashme⁴⁸ është diçka e mirë. Nëse është zakon tek njerëzit që ngritja në këmbë për atë që vjen është respekt dhe nderim dhe nëse nuk ngrihesh ata mendojnë se e bën këtë për tia ulur vlerën atij personi apo e konsiderojnë mosrespekt dhe ai nuk e di se a është apo jo zakoni i atyre njerëzve në përputhje me Sunetin, atëherë në këtë rast më e dobishmja është të ngrihet për atë person sepse me këtë ai bën pajtim dhe përmirësim mes njerëzve dhe shmang inatet dhe urrejtjet, ndërsa nëse e di që zakoni i atij populli është në përputhje me Sunetin atëherë nëse nuk ngrihet nuk konsiderohet kjo mosrespektim dhe lëndim i atij që vjen.....

Më poshtë thotë: Përmbledhja e kësaj është të themi se ajo që duhet të jetë tek muslimanët është pasimi i traditës së selefëve dhe moralit të tyre, duke u përpjekur për tia arritur kësaj sipas mundësisë. Nëse nuk e di që zakoni i atij populli është apo jo në përputhje me Sunetin ose e di që zakoni i tyre nuk përputhet me të dhe nëse nuk sillen sipas zakonit të tyre të cilin ata e konsiderojnë respekt, do të ketë pasoja të dëmshme më të mëdhaja se sa ngritja, atëherë duhet të shmanget dëmi më i madh duke vepruar atë që është më pak e dëmshme ashtu siç është detyrë të veprohet gjëja që ka më shumë dobi edhe nëse kjo çon në humbjen e diçkaje më pak të dobishme⁴⁹.

⁴⁸ Sh.p: Si p.sh: pritja e mysafirit që ka ardhur për vizitë apo pas një mungese të gjatë.

⁴⁹ El alameh Neueuiu ka shkruar një broshurë me titull: Lejimi i ngritjes në këmbë për njerëzit me meritë dhe pozitë e vlera tek muslimanët, kësaj broshure i është kundërpërgjigjur me mënyrën më të mirë duke ia zhvlerësuar dhe hedhur poshtë argumentet e saj, Ibnul Haxh el Malikij në librin e tij el Med-khal 1/157-187.

Mosdhënia e selamit bidatçinjve dhe gjynahqarëve.

Mosdhënia e selamit bidatçinjve dhe gjynahqarëve është e lidhur ngushtë me çështjen e hexhrit (bojkotimit, lënies, ndërprerjes së lidhjes) ndaj dhe shohim se një nga përkufizimet e dijetarëve të hexhrit është: Lënia e selamit dhe e të folurit, kur takohesh me të. Ky përkufizim është marrë nga hadithi i Aishes radijallahu anha në të cilin Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Nuk i takon muslimanit që ta bojkotojë muslimanin (t’i bëjë hexhr) më shumë se tre ditë. Kur e takon atë i jep selam tre herë, e në asnjrën prej tyre ai nuk ia kthen. Ai ka merituar gjynahun e tij”. E ka transmetuar Ebu Daudi. Ibn Muflihi në el Adab 1/287 ka thënë: Hadith hasen⁵⁰.

Pas kësaj që thamë do sjellim më poshtë një pjesë nga fjalët e qëlluara të shejhul islamit Ibn Tejmijeh nëpërmjet së cilës bëhet e qartë se kur lejohet praktikimi i hexhrit të ligjësuar dhe kur nuk është me vend praktikimi i tij.

Ai –Allahu e mëshiroftë- tha: Lloji i dytë: Hexhri (bojkotimi) si mjet disiplinimi dhe edukimi. Ky lloj ka të bëjë me bojkotimin e atyre që shfaqin haptazi veprat e ndaluara dhe gjynahet, u bëhet hexhr derisa të pendohen prej atyre veprimeve. (Më pas thotë) : **Ky lloj hexhri ndryshon në varësi të pozitës së atyre që e praktikojnë hexhrin, në varësi të forcës apo dobësisë së tyre, numrit të shumtë apo të paktë të tyre. Sepse qëllimi me këtë lloj, është frenimi i atij që i bëhet hexhr (të bojkotuarit = el mehxxhur) edukimi i tij dhe largimi i masave popullore nga ai lloj veprimi. Nëse dobia është më e madhe në praktikimin e hexhrit duke bërë që të pakësohet, zbutet dhe dobësohet e keqja, atëherë ai është i ligjësuar dhe i pëlqyer. Ndërsa në**

⁵⁰ Sh.p:Gjithashtu e ka bërë hasen dhe Albani

qoftë se me atë hexhr (bojkotim) nuk frenohet as i bojkotuari (mehxhuri) e as të tjerët veç tij, përkundrazi e keqja veçse shtohet më shumë dhe bojkotuesi (el haxhir) është i dobët (në pozitë apo numër) duke bërë që dëmi i këtij veprimi të jetë më i madh se dobia e tij, atëherë hexhri nuk është i ligjëruar (ndalohet)⁵¹. Ka njerëz me të cilët është më e dobishme përdorimi i mënyrës së të mbajturit afër, ndërkohë që ka njerëz të tjerë me të cilët përdorimi i hexhrit (bojkotit) është më i dobishëm se sa të mbajturit afër. Prandaj shohim se Profeti salallahu alejhi ue selem i afronte dhe i merrte me të mirë disa persona, e ndërkohë u bënte hexhr (bojkot) disa të tjerëve⁵².

Në një vend tjetër thotë: Ndërsa përsa i përket hexhrit disiplinues p.sh: Siç veproi Profeti salallahu alejhi ue selem me tre shokët e tij që nuk vajtën në luftë ose siç veproi Umeri radijallahu anhu dhe muslimanët së bashku me të duke i bërë hexhr Sabigut, ky është ndër llojet e ndëshkimeve. Nëse me këtë hexhr arrihet diçka e dobishme apo frenohet apo shmanget diçka e dëmshme atëherë ai është i ligjëruar dhe i pëlqyeshëm, ndërsa në qoftë se me këtë hexhr ndodh dëm më i madh se sa dëmi i atij gjynahu, atëherë nuk është i ligjëruar⁵³.

El kHalalu në librin e tij el Muxhanebeh ka thënë: Ebu Abdilahi –dmth Ahmed bin Hanbeli- ka thënë: U bëhet hexhr (bojkotim) gjynahqarëve dhe atij që bën vepra të ulëta dhe atij që e lë mënjanë hadithin e Profetit salallahu alejhi ue selem (i shkel kufinj të përcaktuara me hadith dhe nuk i

⁵¹ Sh.p:Për fat të keq sot hexhri po praktikohet ngadisa injorantë në mënyrë të gabuar, të cilët nuk kuptojnë dëmin dhe dobinë, biles as nuk u shkon mendja që të vënë në peshojë këto dy aspekte, duke e kthyer hexhrin në formë të shprehjes së rrugacërisë së tyre

⁵² Marrë nga Mexhmual Fetaua të shejhu islamit 28/204-206.

⁵³ Marrë nga Mexhmual Fetaua 28/216-217.

merr parasysh), nëse këta i bëjnë këto gjëra në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur shpesh. Ndërsa kush pi alkool rrallë apo dehet ndonjëherë apo bën ndonjë vepër nga gjërat e ndaluara, por jo haptazi në sy të njerëzve dhe duke mos flakur cipën e turpit, atëherë është më e mirë që të frenohet gjuha nga nderet e tyre dhe nga nderet e muslimanëve ⁵⁴.

Shejhul islam në lidhje me atë që bën diçka të ndaluar si p.sh: imoralitet (zina), pirja e alkoolit, agresioni, etj, ka thënë: Nëse personi e bën këtë duke u fshehur (ruajtur) nga sytë e njerëzve dhe nuk e shfaq haptazi, qortohet fshehurazi për këtë të keqe dhe i mbulohet ajo gjë e turpshme nga njerëzit përveç nëse dëmi i atij veprimi bie mbi dikë tjetër të pafajshëm ⁵⁵. Nëse e këshillon fshehurazi dhe i kërkon të heqë dorë nga ai veprim, por nëse ai nuk heq dorë, atëherë ndërmerr masën më të përshtatshme me të cilën e frenon atë, qoftë ajo masë hexhr (bojkotim) apo diçka tjetër, nëse kjo është më e dobishme sipas dobisë që sjell ⁵⁶.

Pas këtij sqarimi kemi të drejtën për të folur rreth çështjes tonë të rradhës, ndaj themi: Shumica e dijetarëve janë të

⁵⁴ Sh.p: Imam Ahmedi si dhe shumë selefë të tjerë ruheshin shumë në dhëniën e gjykimeve të shariatit në formë të prerë sidomos nëse çështja ka debat mes dijetarëve dhe argumenti nuk është shumë i qartë ndaj përdornin shprehje të tilla si p.sh.: Është më e mirë, e pëlqej këtë, është më e dashur për mua, duke pasur për qëllim obligueshmërinë e asaj gjëje (kjo në përgjithësi sepse mund të ketë dhe raste që ka për qëllim se ajo vepër është sunet shumë i pëlqyeshëm e jo vaxhib). Po kështu në përdorimin e shprehjeve ndaluese thonin: nuk më pëlqen, mekruh, e urrej këtë, është më parësore ta lerë, etj. Pra edhe një herë e theksojmë se këto shprehje selefët i përdornin në ato çështje ku ka mospajtim mes dijetarëve apo që argumenti i asaj çështjeje nuk është shumë i qartë.

⁵⁵ Sh.p: Për shembull: Hajduti që vjedh fshehurazi. Në këtë rast dëmi i tij bie mbi atë që po i vidhet pasuria ndaj ose lajmërohet policia ose çdokush që arrin ta frenojë ose qortohet dhe këshillohet fshehurazi ky hajdut ashtuqë të pendohet me kusht që tia kthejë pasurinë e vjedhur pronarit të saj dhe t'i kërkohet të falur.

⁵⁶ Marrë nga Mexhmual Fetaua 28/217.

mendimit se nuk i jepet selam fasikut (gjynahqarit të prishur) dhe as bidatçiut.

El Muheleb ka thënë: Mosdhënia e selamit gjynahqarëve është traditë e hershme. Me të njëjtin vendim kanë gjykuar shumica e dijetarëve dhe për bidatçinjtë⁵⁷.

Në bazë të kësaj që u tha përftojme disa pika:

1. Hexhri (bojkotimi) në shariat është ligjruar me qëllim frenimi, prandaj nëse kjo arsye ekziston atëherë hexhri është i pëlqyeshëm si p.sh: hexhri që babai i bën fëmijës së tij apo dijetari nxënësit të tij, eprori atij që ka nën vartësi, e kështu me radhë nga çdokush i cili nëse i bën hexhr dikujt do ketë ndikimi tek ai (për mirë) duke bërë që të frenohet nga ajo vepër e shëmtuar për shkak të së cilës iu bë hexhr.
2. Hexhri në shariat është i ligjruar me qëllim frenimi dhe përmirësimi, prandaj nëse kjo gjë në një situatë të caktuar nuk mund të realizohet me hexhr, atëherë ai nuk është i ligjruar, mund të jetë haram ose mekruh ose thjesht i lejuar.
3. Hexhri – sipas sqarimit të mësipërm - praktikohet me ata persona që i shfaqin gjynahet haptazi ndërsa ai që i bën gjynahet fshehurazi është detyrë që të këshillohet dhe t'i mbulohet ai gjynah nga njerëzit, por nëse pas këshillimit nuk heq dorë nga ai gjynah, atëherë merret ndaj tij masa që i përshtatet qoftë hexhr apo diçka tjetër. Imam Buhariu në Sahihun e tij në Librin e kërkimit të lejes, ka thënë: Kapitulli: Në lidhje me atë person që nuk i jep selam atij që ka bërë gjynah dhe atë person që nuk ia kthen selamin (gjynahqarit) derisa të bëhet i qartë pendimi dhe deri kur bëhet i qartë pendimi i gjynahqarit.

⁵⁷ Marrë nga Fet-hul Barij 11/40.

Abdullah bin Amri ka thënë: Mos u jepni selam atyre që pijnë alkool. Pastaj transmeton me zinxhirin e tij nga Abdullah bin Kabi i cili tha: E kam dëgjuar Kab bin Malikun duke na treguar historinë e mosvajtjes në betejën e Tebukut: Profeti salallahu alejhi ue selem i ndaloi njerëzit nga të folurit me ne, i shkoja Profetit salallahu alejhi ue selem i jepja selam dhe thoja me vete: A i lëvizi buzët e tij për të më kthyer selamin apo jo? Vazhdoi kjo situatë derisa u plotësuan 50 netë, pastaj Profeti salallahu alejhi ue selem pasi që fali namazin e sabahut na lajmëroi se Allahu na e kishte pranuar pendimin (teuben).

Gjithashtu Buhariu në el Edebul mufrad 2/472 ka thënë: Kapitulli: Nuk i jepet selam fasikut (gjynahqarrit), pastaj solli me zinxhirin e tij nga Abdullah bin Amri bin el As i cili ka thënë: Mos u jepni selam pirësve të alkoolit.

Transmetohet nga Hasen el Basri se ai ka thënë: Nuk ka mes teje dhe fasikut shenjtëri (pra nuk ka pengesë për përgojim dhe për bojkotim).

Transmetohet nga Alij bin Abdullah bin Abas se ai ka thënë: Mos u jepni selam atyre që luajnë shah sepse ai është një lloj bixhozi. Më pas tha (Buhariu): Kapitulli: Në lidhje me atë që nuk i jep selam atij që është lyer me khaluk (lloj parfumi me ngjyrë, i veçantë për gratë) dhe gjynahqarëve.

Në këtë kapitull ai solli disa hadithe, ndër të tjera prej tyre përmendi: Hadithi i Ebu Seid el Hudrij i cili tha: Erdhi një burrë nga Bahrejni⁵⁸ tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe i dha selam (Profetit) por Profeti salallahu alejhi ue selem nuk ia ktheu – sepse në dorën e tij kishte unazë floriri dhe kishte të veshur një xhybe të mëndafshtë- atëherë personi u

⁵⁸ Sh.p: Tek sahabët Bahrejn quhej një zonë që sot ndodhet në pjesën lindore të Saudisë (Asir) dhe nuk është për qëllim shteti i sotëm i Bahrejnit.

largua i mërzitur. Shkoi dhe u ankua tek gruaja e tij për atë që ndodhi, ajo i tha: Ndoshta Profeti salallahu alejhi ue selem u soll kështu për shkak të xhybes dhe unazës tënde, ndaj hiqi dhe kthehu tek ai pa këto. Ashtu bëri dhe kur erdhi , (Profeti) ia ktheu selamin.....⁵⁹.

Ebu Daudi në Sunenin e tij në Librin e Sunetit ka thënë: Kapitulli: Mosdhënia e selamit pasuesve të tekave (bidatçinjve). Pastaj solli me zinxhirin e tij nga Jahja bin Jamer nga Amar bin Jasiri i cili tha⁶⁰: U ktheva një natë tek gruaja ime dhe më ishin çarë duart (nga puna) dhe mi leu duart me zaferan⁶¹. Kur u gdhi dita shkova tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe i dhashë selam por nuk ma ktheu selamin e as nuk më shprehu mirëseardhje, më tha: “Shko laje atë me çfarë je lyer”. Shkova e lava pastaj u ktheva por më kishin ngelur akoma gjurmë të saj. i dhashë selam por nuk ma ktheu selamin e as nuk më uroi mirëseardhjen dhe më tha: “Shko dhe laje atë me çfarë je lyer”. Shkova, e lava, pastaj erdha dhe i dhashë selam atëherë ma ktheu selamin dhe më uroi mirëseardhje, më pas tha: “Vërtet engjëjt nuk janë të pranishëm në përcjelljen e xhenazes së kafirit , as në të atij që është i përlyer me zaferan (lëngun e marrë nga bima e zaferanit) dhe as të xhunubit”.

⁵⁹ Këtë hadith e ka transmetuar Ahmedi 3/14 -15 dhe Nesaiu 7/175 me zinxhir të mirë.

⁶⁰ Tekstin e këtij hadithi e mora nga Suneni i Daudit 4/402 nga Libri i krehjes së flokëve, kapitulli: Në lidhje me përdorimin e Halukut (Iloj parfumi me ngjyrë) nga meshkujt. i dhashë përparësi këtij teksti sepse është më i plotë se sa në Librin e Sunetit.

⁶¹ Sh.p: Zaferani është bimë nga familja e qepujkave, e njohur në fushën e mjekësisë popullore për efektin shërues të plagëve dhe për përdorim ngjyrosjeje.

Tha (transmetuesi): E lejoi për xhunubin që para se të flerë apo para se të hajë apo të pijë, të marrë abdes⁶².

Po ashtu Ebu Daudi e ka transmetuar nga Jahja bin Jamer nga një person nga Amari. Darekutnij ka thënë: Jahja nuk ka arritur të takojë Amarin por hadithi i tij është i saktë nëpërmjet atij personi që ka takuar Amarin. Marrë nga libri et-Tehdhib 11/305⁶³.

Në librin Mesailul imami Ahmed të Ebu Daudit ka thënë: i thashë Ahmedit: Nëse kaloj pranë një grupi njerëzish që shahen dhe ofendohen mes tyre, a tu jap selam? Tha: Ata janë njerëz mendjelehtë ndërsa fjala es-Selamu është nga emrat e Allahut⁶⁴.

Is-hak bin Mensuri i tha imam Ahmedit: Nëse kalojmë pranë një grupi njerëzish që po luajnë shah apo tavëll, a tu japim selam? Tha: Ata nuk e meritojnë që tu jepet selam⁶⁵.

Transmetohet nga el Menkirij i cili tha: Seid bin Xhubejri ishte që kur kalonte pranë atyre që luanin tavëll nuk u jepte selam.

Transmetohet nga el Muafa bin Imran se ai u pyet: Nëse kaloj pranë një grupi njerëzish që po veprojnë diçka të ndaluar, a tu jap selam atyre? Tha: Nëse dëshiron që tu flasësh për t'i urdhëruar për të mirë dhe ndaluar nga e keqja jepu selam përndryshe mos u jep selam⁶⁶.

⁶² Transmeton Ebu Daudi nëpërmjet Ata el Hurasanij nga Jahja bin Jamer. E ka pasuar Ataun në këtë transmetim Umer bin Ata bin Ebil Huar i cili është thikah (i besueshëm). Jahja bin Jamer nuk e ka dëgjuar hadithin në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga Amar bin Jasir.

⁶³ Sh.p.: Hadithin e lartëpërmendur Albani e ka konsideruar hasen.

⁶⁴ Mesailul iami Ahmed të Ebu Daudit fq 279.

⁶⁵ Marrë nga libri: el Emru bil marufi uen-nejhu anil munkeri të el kHalal fq 94.

⁶⁶ Mesailul imami Ahmedi të Ebu Daudit fq 280.

Nga këto transmetime përftohet mosdhënia e selamit atij që po kryen një gjynah (gjatë kohës së veprimit të atij gjynahu) përveçse për atë person që dëshiron t'i këshillojë.

kHalali ka transmetuar nga imam Ahmedi se ai u pyet në lidhje me një person i cili kishte komshi (fqinj) një rafidij (shii), a t'i japë selam atij? Tha: Jo, bile edhe nëse ai (rafidiu) i jep i pari selam mos t'ia kthejë⁶⁷.

Imam Maliku ka thënë: Nuk u jepet selam bidatçinjve (pasuesve të tekave).

Ibn Dekik el Idi tha: Mosdhënia e selamit atyre bëhet në formë ndëshkimi për ta dhe për të treguar të qënurit larg prej tyre⁶⁸.

Ibnul Kajimi ka thënë: Ishte nga udhëzimi i Profetit salallahu alejhi ue selem mosdhënia e selamit fillimisht dhe moskthimi i tij ndaj atij personi që vepronte diçka të ndaluar derisa të pendohej nga ai veprim, siç i bëri hexhr Kab bin Malikut dhe dy shokëve të tij apo kur nuk ia ktheu selamin Amar bin Jasirit të cilin gruaja e tij e kishte lyer me zaferan dhe i tha: “Shko laje atë me çfarë je lyer”⁶⁹.

⁶⁷ Marrë nga el Adab esh-sher`ijeh 1/268.

⁶⁸ Marrë nga Fet-hul Barij 11/40.

⁶⁹ Marrë nga libri Zadul mead 2/428.

Dhënia e dorës njëri tjetrit pas mbarimit të çdo namazi.

Shumë njerëz pyesin për gjykimin e veprimit që bëjnë disa muslimanë të cilët pasi që mbarojnë faljen e namazit farz i japin dorën atyre që kanë në krah nga e djathta dhe nga e majta. Rreth kësaj është përgjigjur shejhul islami Ibn Tejmijeh duke thënë: Dhënia e dorës pas namazit nuk është nga Suneti, përkundrazi është bidat⁷⁰.

Sa e bukur është ajo që ka thënë Ibnul Haxhi duke këshilluar nxënësin e dijes: Duhet që nxënësi i dijes ta pengojë dhe ndalojë këtë vepër të shpikur, dhënien e dorës pas namazit të sabahut, pas namazit të ikindisë dhe pas namazit të xhumasë, bile disa prej tyre e veprojnë këtë gjë pas të pesë namazeve farz. E gjithë kjo është nga bidatet.

Dhënia e dorës në shariat është e ligjëruar kur muslimani takon vëllain e tij musliman dhe jo pas përfundimit të pesë namazeve, e gjitha kjo është nga bidatet. Ne e veprojmë dhënien e dorës aty ku e ka përcaktuar shiari, ndërsa dhënia pas namazeve duhet të ndalohen njerëzit nga ky veprim dhe të qortohet vepruesi i saj sepse ka rënë në kundërshtim me Sunetin⁷¹.

El alametun Ibnul Haxher ka thënë: Ajo që bëjnë njerëzit duke i dhënë dorën njëri-tjetrit pas pesë namazeve, është diçka e urryer dhe e pabazuar në shariat. Dikush nga dijetarët e ka cekur se dhënia e dorës pas namazit është nga zakonet e rafidijve –Allahu i poshtëroftë⁷².

Pasi që i dëgjove fjalët e dijetarëve rreth kësaj dhënie të dorës nuk të ngelet gjë tjetër veçse t'i largohesh asaj dhe ta urresh atë dhe t'i këshillosh auamët (njerëzit e thjeshtë) që ta lënë

⁷⁰ Mexhmual Fetava 23/339.

⁷¹ el Med-hal 2/223.

⁷² Shiko librin es-Siajeh fq 264 të el-Lekneuj

këtë veprim ashtuqë të ruhen nga rënia në bidate, të cilat ia deformatojnë fenë robit dhe ia zhvlerësojnë atë vepër. Dije, se gjykimi i dijetarëve të mësipërm se kjo lloj dhënie e dorës është bidat, bazohet në faktin se kjo vepër është ibadet i shpikur pas kohës së Profetit salallahu alejhi ue selem dhe brezave të lavdëruar. Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush punon një vepër e cila nuk përputhet me çështjen (fenë) tonë ajo është e refuzuar”. Është për tu çuditur nga rrënjësia e bidatit në zemrat e vepruesve të tij, duke i bërë ata të shndërrohen në mburojë të koracuar për bidatet, duke i mbrojtur ata nga çdo gërvishtje, ndërkohë që ehlu sunetin i pushton ndrojtja dhe dobësia në mbrojtjen e suneteve dhe ringjalljen e tyre dhe në kundërpërgjigjen ndaj atyre që i kundërshtojnë sunetet. A nuk e sheh këtë bidat (për të cilin po flasim) se si njerëzit i përmbahen dhe e konsiderojnë adhurim, saqë nëse dikush do e përmendë përciptazi se kjo është diçka e papëlqyeshme, do i bërtasin njerëzit nga të gjitha anët dhe do e akuzojnë se po sjell një fe të re!!

E gjithë kjo për shkak se disa dijetarë nuk janë aktivë aq sa duhet në luftimin e bidateve – sado të vogla qofshin- dhe përtesa në praktikimin e Sunetit, ina lilahi ue ina ilejhi raxhiun ue hasbuna Allahu ue nimel uekil (të Allahut jemi dhe tek Ai do kthehemi, na mjafton Allahu dhe Ai është mbrojtësi, përkrahësi më i mirë).

Selami që xhemati i japin imamit pas çdo namazi farz.

Me aq sa di, nuk është transmetuar asnjëherë që dikush nga sahabët t'i ketë dhënë selam Profetit salallahu alejhi ue selem pas kryerjes së namazit, para se të ngrihej nga vendi ku u fal, megjithëse sahabët transmetonin çfarë ndodhte në namaz me Profetin salallahu alejhi ue selem para dhe pas namazit, ashtuqë umeti ta njihte Sunetin e tij e të punonin me të. Sahabët kanë vënë re drejtimin nga i cili Profeti salallahu alejhi ue selem anohej pas namazit, nga e djathta apo nga e majta, po ashtu kanë vënë re fjalët të cilat i thoshte pas namazit, etj, dhe nuk është përmendur në asnjë transmetim që ai t'i ketë dhënë selam dikujt apo që dikush t'i ketë dhënë selam atij pas kryerjes së çdo namazi farz.

Nëse do vëresh çfarë ndodh në disa vende muslimane, do çuditësh se sa shumë lodhet imami nga selami që njerëzit i japin pas kryerjes së çdo namazi farz dhe “mjerë për të” nëse nuk i përgjigjet selamit të atyre. Ky veprim është diçka e paligjëruar me shariat dhe është shumë afër bidatit, sepse ai (Profeti salallahu alejhi ue selem) që na e ligjëroi selamin dhe na nxiti për të, nuk e veproi diçka të tillë pas namazit, megjithëse ai ishte i pari në çdo mirësi, prandaj përderisa ai nuk e ka bërë, bëhet e qartë se ajo që njerëzit vepronë sot është diçka e shpikur dhe jashtë udhëzimit të Mustafasë salallahu alejhi ue selem. Është saktësuar se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kush punon një vepër e cila nuk përputhet me çështjen (fenë) tonë, ajo është e refuzuar”.

E gjithë kjo që thamë ka të bëjë me ata njerëz të cilët e kanë bërë zakon të tyrin dhënien selam imamit pas çdo namazi, ndërsa nëse dikush vjen tek imami për t'i folur për diçka dhe i jep selam apo ka kaluar kohë e gjatë pa u takuar me këtë person ndaj e takon dhe i jep selam apo për ndonjë shkak

tjetër, në këtë rast lejohet duke u bazuar në argumentet e përgjithshme të dhënies së selamit. Uallahu ealem (Allahu e di më së miri).

Shtesa pas fjalës “ue berakatuhu” gjatë dhënies së selamit fillimisht apo kthimit të tij.

Selami i ligjëruar i plotë është të thuhet: Es-selamu alejkum ue rahmetull-llahi ue berakatuhu. Argument për këtë është hadithi që ka transmetuar Ebu Daudi në Sunenin e tij⁷³ nga Imran bin Husejn i cili tha: Erdhi një person tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe tha: Es-selamu alejkum. Profeti salallahu alejhi ue selem ia ktheu selamin, pasta ai u ul. Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Dhjetë (të mira)”. Pastaj erdhi një tjetër dhe tha: Eselamu alejkum ue rahmetullah, ia ktheu selamin dhe u ul. Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Njëzet (të mira)”. Pastaj erdhi një tjetër dhe tha: “Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu, ia ktheu selamin dhe u ul. Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Tridhjetë (të mira)”. El Hafidhu (Ibn Haxheri) në el Fet-h 11/6 në lidhje me këtë hadith ka thënë: E ka transmetuar Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Nesaiu me zinxhir të fortë. Ibn Muflihi në el Adab ka thënë: Zinxhiri i tij është i mirë⁷⁴.

Buhariu ka transmetuar në librin e tij el Edebul mufrad një hadith të ngjashëm me të, nga Ebu Hurejra ku në të thuhet: “Dhjetë të mira”, “Njëzet të mira”, “Tridhjetë të mira”.

El alametua el Kurtubij në tefsirin e ajetit të sures Nisa 86: “Kur tu përshëndesin me ndonjë përshëndetje, përgjigjuni me përshëndetje më të mirë se ajo ose (të paktën) kthejeni të njëjtën”, ka thënë: Kthimi i përshëndetjes me më të mirë është të thotë: Alejke-selamu ue rahmetullahi, në përgjigje të atij që

⁷³ 20/133

⁷⁴ Sh.p: Hadithin e ka saktësuar dhe Albani.

i thotë: Selamun alejkum. Nëse i thotë: Selamun alejke ue rahmetullahi, atëherë përgjigja do të jetë duke shtuar: ue berakatuhu, dhe ky është caku i fundit i përgjigjes, nuk ka shtesë tjetër mbi të.

Allahu duke lajmëruar rreth familjes fisnike (të Ibrahimit), ka thënë: “(engjëjt thanë:) Mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi ju o ehlul bejt (familje e Ibrahimit), me të vërtetë Ai është i Lavdëruar dhe i Falënderuar” (Hud 73). (Më poshtë Kurtubiu thotë): Ky ajet gjithashtu tregon se caku i fundit i selamit është fjala: ue berakatuhu, ashtu siç Allahu na lajmëroi për thënien e robërve të Tij të mirë (engjëjve).

Janë transmetuar argumente që tregojnë moslejimin e shtesës në selam pas “ue berakatuhu”, nga këto argumente:

Ibn Kethiri në tefsirin e ajetit: “Kur tu përshëndesin me ndonjë përshëndetje” (Nisa 86) ka transmetuar nga Selman el Farisij se ai ka thënë: Erdhi një person tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe tha: Eselamu alejke o Rasulallah. Tha: “Ue alejkumus-selamu ue rahmetullah. Pastaj erdhi një tjetër dhe tha: “Eselamu alejke o Rasulallah ue rahmetullahi ue berakatuhu. Profeti salallahu alejhi ue selem i tha: Ue alejke. Personi (i fundit) tha: O Profet i Allahut, bëfsha kurban për ty nënën dhe babain tim. Të erdhi filani dhe filani e të dhanë selam dhe ua ktheve atyre me më shumë se sa ma ktheve mua. Profeti salallahu alejhi ue selem i tha atij: “Ti nuk le gjë për ne. Allahu ka thënë: “Kur tu përshëndesin me ndonjë përshëndetje përgjigjuni me përshëndetje më të mirë se ajo ose (të paktën) kthejeni të njëjtën” dhe ne ta kthyem ty”⁷⁵.

⁷⁵ Në zinxhirin e tij ka dobësi. el Hafidhu Ibn Kethiri tha: Në këtë hadith ka argument se nuk lejohet të shtohet në selam diçka tjetër mbi thënien: Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu, sepse nëse do ishte e ligjëruar të shtohet diçka tjetër më shumë se kaq atëherë do ta kishte shtuar Profeti salallahu alejhi ue selem .(Tefsir Ibn Kethiri 1/531).

Nga argumentet e tjera: Transmeton imam Maliku në el Mueta me zinxhir të mirë nga Muhamed bin Amri bin Ata se ai tha: Po rrija ulur tek Abdullah bin Abasi, kur hyri tek ai një person nga Jemeni dhe tha: Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu, pastaj shtoi dhe diçka tjetër. Ibn Abasi –të cilit në atë kohë i kishte ikur shikimi- tha: Kush është ky? Thashë: Ky është jemenas -ia përshkruam atë, Ibn Abasi tha: Selami mbaron tek fjala el berekeh.

Po ashtu ka transmetuar Bejhakiu në esh-Shuab 6/455 me këtë tekst: Muhamed bin Amr bin Ata ka thënë: Ndërkohë që po rrija tek Ibn Abasi dhe aty pranë ishte dhe i biri, kur erdhi një pyetës dhe i dha selam duke thënë: Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu ue magfiratuhu ue riduanuhu dhe shtoi ca fjalë të ngjashme. Ibn Abasi tha: çfarë është ky lloj selami? U zemërua aq shumë sa që iu skuqën mollëzat e faqeve. Atëherë, i biri i tij, Aliu tha: O babai im, ai është thjesht një pyetës si gjithë pyetësit e tjerë. Ibn Abasi tha: Vërtetë Allahu e ka përkufizuar selamin duke e përcaktuar atë dhe e ka ndaluar shtesën mbi të, pastaj lexoi: “(engjëjt thanë): Mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi ju o familja e Ibrahimit. Me të vërtetë Ai është i Lavdëruar dhe i Falënderuar. (Hud 73)

Gjithashtu Bejhakiu ka transmetuar në esh-Shuab nga Zehrate bin Mabed i cili tha: Umeri radijallahu anhu ka thënë: Selami ka përfunduar tek “ue berakatuhu”.

El hafidhu Ibn Haxher për këtë ether në el Fet-h 6/11 ka thënë: Transmetimuesit e tij janë thikatë (të besueshëm).

AbduRrezaku në Musanefin e tij 10/390 ka transmetuar nga Ma`meri nga Ejubi nga Nafi`u apo dikush tjetër se një person e takonte Ibn Umerin në rrugë dhe i jepte selam duke thënë: Eselamu alejke ue rahmetullahi ue berakatuhu ue magfiretuhu ue muafatuhu. Ibn Umeri i tha atij: Edhe mbi ty qofshin

njëqind herë, por nëse e përsërit dhe njëherë këtë do të të disiplinoj.

Bejhakiu në esh-Shuab 6/456 ka transmetuar se një person i dha selam Abdullah bin Umerit duke thënë: Selamun alejke ue rahmetullahi ue berakatuhu ue magfiratuhu. Ibn Umeri e ndaloi nga kjo dhe i tha: Të mjafton që të ndalosh tek “ue berakatuhu” sepse deri këtu tha Allahu. Thashë: Ka për qëllim ajetin(73) të sures Hud: “(engjëjt thanë): Mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi ju o familja e Ibrahimit. Me të vërtetë Ai është i Lavdëruar dhe i Falënderuar

Gjithashtu në esh-Shuab 6/510 ka transmetuar nga Zebrate bin Mabed nga Uruah bin Zubejr se një person i dha selam atij duke thënë: Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu. Uruetu tha: Nuk la ndonjë shtesë për ne sepse selami mbaron tek “ue berakatuhu”.

Në bazë të gjithë kësaj që thamë, bëhet e qartë se është e ndaluar të shtohet në selam diçka tjetër mbi fjalën “ue berakatuhu” qoftë në dhënien fillimisht apo në kthimin e tij. Ky është udhëzimi i Profetit salallahu alejhi ue selem siç e ka thënë këtë verifikuesi i madh Ibnul Kajimi⁷⁶. Ato hadithe që janë transmetuar dhe që tregojnë lejimin e shtimit (shtesës) nuk janë të sakta. Në mënyrë më të hollësishme themi: Shtimi mbi fjalën “ue berakatuhu” është transmetuar në disa hadithe: i pari është hadithi i Sehl bin Muadh bin Enes nga babai i tij nga Profeti salallahu alejhi ue selem :pastaj erdhi një tjetër dhe tha: Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu ue magfiratuhu. Tha (Profeti): “Dyzet. (pastaj tha): Kështu janë mirësitë”. Me fjalën e tij: Dyzet ka për qëllim: Dyzet të mira. Këtë hadith e ka transmetuar Ebu Daudi në Sunenin e tij në Librin e Edukatës, kapitulli: Si jepet selami? 5/380. El alameh Ibn Muflihi në el Adab 1/382 ka

⁷⁶ Në Zadul Mead 2/417.

thënë: Hadithi është i dobët dhe bie në mospërputhje me atë që është e mirënjohur (në çështjen e selamit).

El alameh Ibnul Kajim në Zadul Mead 2/418 ka thënë: Ky është hadith nuk qëndron. Ibn Haxheri në el Fet-h 11/6 ka thënë: Senedi (zinxhiri) i tij është i dobët⁷⁷.

Hadithi i dytë nga Enesi radijallahu anhu i cili tha: Ishte një person që ruante (kulloste) kafshët e të zotit të tij dhe kur kalonte pranë Profetit salallahu alejhi ue selem thoshte: Eselamu alejke o Rasulallah dhe Profeti i përgjigjej duke i thënë: Alejkes-selamu ue rahmetullahi ue berakatuhu ue magfiratuhu ue riduanuhu.....”

Ibnul Kajimi tha: Ky është më i dobët se ai para tij. Neueuiu në el Edhkar fq 209 ka thënë: Zinxhiri i tij është i dobët.

Ibn Haxheri në el Fet-h 11/6 ka thënë” Zinxhiri i tij është shumë i dobët.

Hadithi i tretë: Buhariu në et-Tarihul Kebir 1/330 ka thënë: Muhamedi tha:Na ka treguar Ibrahim bin el Muhtar nga Shu`beh nga Harun bin Sa`di nga Thumamete bin Ukbeh nga Zejd bin Erkami i cili tha: Kur Profeti salallahu alejhi ue selem na jepte selam, ishim që thonim: Ue alejkes-selamu ue rahmetullahi ue berakatuhu ue magfiratuhu”.

Ky zinxhir është shumë i dobët. E meta e tij është Muhamedi –shejhu i Buhariut- i cili është Ibn Humejdi. Ebu Zur`ah tha: Buhariu e ka lënë atë⁷⁸. Nesaiu ka thënë për të: Kedhab (gënjeshtar i madh), ndërsa në një vend tjetër tha: Nuk është i besueshëm. Ibn kHarashi ka thënë: Uallahi ai gënjente. Marrë nga et-Tehdhib 9/127.

⁷⁷ Sh.p: Po ashtu zinxhirin e këtij hadithi e konsideroi të dobët edhe Albani.

⁷⁸ Sh.p: Shprehja e kanë lënë, është e ashpër në shkencën e kritikimit të transmetuesit, sidomos nëse kjo lënie vjen nga Buhariu, atëherë kjo tregon dhe më shumë për dobësinë e atij transmetimi sepse Buhariu konsiderohet nga kategoria e dijetarëve mesatarë të shkencës në Xherlit ue Tadilit, as nuk është i ashpër dhe as tolerant.

Ibn Haxheri tha: Ai është hafidh, i dobët. Ibn Meini kishte mendim të mirë për të.

Këtë hadith e ka transmetuar Bejhakiu në Shuabul iman 6/45 nr. 8881 duke u shprehur qartë se Muhamedi i përmendur në sened është Ibn Humejdi.

Pasiqë e përmendi, Bejhakiu tha: Muhamed bin Galib e ka pasuar në këtë transmetim Ali bin Husejnin nga Muhamed bin Humejd, nëse ky hadith saktësohet do kemi si mendim atë që përfitohet nga kuptimi i këtij hadithi por problemi qëndron se gjatë zinxhirit të tij deri tek Shubeh është një transmetim që nuk merret për bazë. Ualallahu ealem.

El hafidhu (Ibn Haxher) në el Fet-h 11/35 e ka konsideruar të dobët këtë zinxhir⁷⁹.

Në bazë të kësaj që thamë bëhet e qartë se shtesa pas fjalës: ue berakatuhu, në selam nuk është e ligjëruar qoftë në dhënien fillimisht apo në kthimin e tij. Si mund të jetë e ligjëruar përderisa Allahu e mbaroi selamin me fjalën: ue berakatuhu?!

⁷⁹ Shejhu i nderuar, imami, Muhamed Nasirudin Albani -Allahu e ruajtë- (Sh.p: Sepse libri është shkruar para vdekjes së shejhut, ndërsa tani na takon të themi: Allahu e mëshiroftë Albanin dhe autorin i cili ka ndërruar jetë)- ka folur rreth këtij hadithi dhe saktësisht të tij në parathënien e vëllimit të tretë të Silsiletu es-Sahihia duke ecur me idenë se Muhamedi (transmetuesi) i përmendur në zinxhirin është Ibn Seid el Ensarij. Këtë mendim shejhu nuk e ka bazuar në fakte të prera të vërtetuara por e bëri këtë zgjedhje në bazë të argumentimeve indirekte. Ajo që u bë e qartë është se Muhamedi ishte Ibn Humejdi siç u shpreh qartë Bejhakiu, duke qenë se ky është i njëjti hadith që transmeton Buhariu dhe Bejhakiu, përveçse Buhariu tha: Muhamed, duke mos e përcaktuar më tej, ndërsa Bejhakiu e përcaktoi qartë duke thënë Ibn Humejd, na ka treguar Ibrahim bin el Muhtar, nga Shubeh nga Harun bin Seid nga Thumamete bin Ukbeh nga Zejd bin Erkam.....

Si mundet diçka e tillë, ndërkohë që ajo që dihet dhe njihet nga të gjithë është se Profeti salallahu alejhi ue selem ndalonte tek fjala: ue berakatuhu ?! Si mundet, duke qenë se transmetimet në të cilat tregohet shtesa, të gjitha së bashku janë të dobëta dhe nuk e përforcojnë dot njëra-tjetrën, pa folur më pas për secilin transmetim më vete?! Allahu është Ai që jep sukses.

Dhënia selam muslimanit me shprehjen: Eselamu ala menit-tebeal huda (Paqja qoftë mbi atë që pason udhëzimin).

Dhënia e selamit në këtë formë është selam i kushtëzuar, domethënë: Paqja qoftë mbi atë që pason udhëzimin, pra nëse ai të cilit i jepet selam është i tillë (pasues i udhëzimit) e përfshin kjo dua, nëse jo atëherë nuk e përfshin. Prandaj shohim se në tekstet e sheriatit ky lloj selami nuk i drejtohet dikujt tjetër përveçse atij që shpresohet në udhëzimin e tij dhe hyrjen e tij në islam.

Allahu në historinë e Musait dhe Harunit me Faraonin tha (duke treguar fjalën e Musait në bashkëbisedim me Faraonin): “Vërtetë të kemi ardhur ty me argumente nga Zoti yt dhe paqja e shpëtimiti është për atë që pason udhëzimin (rrugën e drejtë)” (Taha 47).

Po ashtu në letrën që Profeti salallahu alejhi ue selem ia dërgoi Herakliut, thuhej: Bismilahi Rrahmani Rrahim. Nga Muhamedi, robi i Allahut dhe i dërguari i Tij, drejtuar Herakliut i madhëruari i romakëve (i pari i tyre). Paqja dhe shpëtimiti qofshin mbi atë që pason udhëzimin”.

AbduRrezaku ka transmetuar nga Ma`meri nga Katadeh i cili ka thënë: Nëse hyni në shtëpitë e ithtarëve të librave (ehlu kitab) atëherë selami që u jepet atyre është: Es-selamu ala menit-tebeal huda. Po ashtu Ibn Ebi Shejbeh ka transmetuar të njëjtën gjë nga Muhamed bin Sirini.

El hafidhu Ibn Haxheri në lidhje me ajetin e mësipërm dhe me letrën e Profetit salallahu alejhi ue selem parashtroi një pyetje, duke thënë: Nëse dikush thotë: Si lejohet që të përshëndetet kafiri me selam fillimisht? Përgjigja është të themi se mufesirët (komentuesit e Kuranit) kanë thënë: Me këtë nuk është për qëllim përshëndetja por kuptimi i saj është: Ai që pranon Islamin, ka shpëtuar nga dënimi i Allahut, prandaj erdhi ajeti vijues: “Sigurisht që ne na është shpallur se ndëshkimi do jetë për atë që përgënjeshton (të vërtetën) dhe i kthen shpinën asaj”. Në këtë kontekst vazhdon pjesa tjetër e letrës që Profeti salallahu alejhi ue selem i dërgoi Herakliut: “Nëse i kthen shpinën (të vërtetës) do bartësh mbi vete gjynahet e romakëve”. Pra, përgjigjia e kësaj pyetjeje në mënyrë të përmbledhur është se Profeti salallahu alejhi ue selem nuk i dha selam kafirit fillimisht, duke pasur këtë gjë për qëllim edhe pse ndoshta kjo shprehje deri diku lë të kuptohet diçka e tillë, por kjo nuk ishte për qëllim sepse kafiri të cilit iu drejtua kjo shprehje nuk është nga ata që pasuan udhëzimin ndaj nuk i dha selam atij.

Urtësia në të komunikuarit me ta fillimisht me këtë shprehje ka të bëjë me përfitimin e zemrave të tyre, animin e tyre nga besimi, tu jepet të kuptojnë dhe të ndjejnë paqen, sigurinë dhe shpëtimin nëse e realizojnë kushtin e kësaj gjëje: të udhëzuarit në rrugën e drejtë. Uallahu ealem. Allahu e di më së miri.

Kjo urtësi nuk ekziston në lidhje me besimtarin, sepse pa asnjëlloj dyshimi ai është i udhëzuar, ndaj nuk lejohet t'i thuhet kjo shprehje besimtarit sepse lë për të nënkuptuar diçka

të pakëndshme. Selami i Profetit salallahu alejhi ue selem që u jepte shokëve të tij dhe selami i tyre ndaj tij, ka qenë gjithnjë me shprehjen Eselamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu, gjë e cila na bën të qartë se përshëndetja e besimtarëve mes tyre bëhet me këtë shprehje. Ndërsa shprehja e mëparshme është e veçantë vetëm për komunikimin me jobsimtarët ndaj është detyrë që të mos përdoret kjo shprehje mes besimtarëve. Uallahu ealem.

Dhënia e selamit me shprehjen: alejkes-selam.

Tirmidhiu, Ebu Daudi, Ahmedi, etj kanë transmetuar –teksti sipas transmetimit të Tirmidhiut– nga Ebu Temimete el Huxhejmi nga një person prej fisit të tij- qartësohet në transmetimet e tjera se ai është Ebu Xhuraj el Huxhemij- i cili tha: Kërkova ta takoj Profetin salallahu alejhi ue selem por nuk arrita ta gjej dot se ku ishte, ndaj u ula dhe po rrija. Aty pranë meje ishin një grup njerëzish dhe me ta ishte Profeti salallahu alejhi ue selem duke bërë pajtim mes tyre, por unë nuk e njihja. Pasiqë mbaroi me ta u ngrit, dikush prej tyre e thërriti: O Rasulallah, kur e pashë dhe e dallova cili ishte thashë: Alejkes selamu o Rasulallah, alejkes selamu o Rasulallah, alejkes selamu o Rasulallah. Tha: “Thënia: alejkes-selamu është përshëndetja që u thuhet të vdekurve, alejkes-selamu është përshëndetja që u thuhet të vdekurve, alejkes-selamu është përshëndetja që u thuhet të vdekurve, pastaj u afrua drejt meje dhe tha: “Kur dikush e takon vëllain e tij musliman le të thojë: “Eselamu alejkum ue rahmetullah”. Pastaj Profeti salallahu alejhi ue selem ma ktheu selamin duke

thënë: Ue alejke ue rahmetullahi, Ue alejke ue rahmetullahi, Ue alejke ue rahmetullahi”.

Tirmidhiu tha: Ky është hadith Hasen Sahih⁸⁰.

Janë disa ata dijetarë të cilët në librat e tyre të hadithit e kanë titulluar këtë hadith: Kapitulli: Është e urryer të thuhet: Alejkes-selam, siç bëri Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.

Në këtë hadith ka argumentim të prerë që tregon ndalimin nga dhënia e selamit fillimisht me këtë shprehje. Ky argumentim përftohet nga disa këndvështrime të ndryshme rreth hadithit:

Së pari: Fakti që Profeti nuk ia ktheu selamin atij menjëherë.

Së dyti: Fakti që Profeti e kritikoi dhe ia refuzoi këtë shprehje.

Së treti: Sepse Profeti e udhëzoi atë për shprehjen e saktë të selamit sipas sheriatit, duke treguar kështu se shprehja që përdori personi nuk është në përputhje me sheriatin.

Ibnul Kajimi ka cekur një meditim të mrekullueshëm në lidhje me urtësinë e ndalimit nga thënia: Alejkes-selam, duke thënë –në pasim të asaj që ka thënë el kadij Ijad: Këtu kemi të bëjmë me një meditim të mrekullueshëm që duhet ta vëmë re. Dhënia e selamit është e ligjëruar për të gjallët dhe të vdekurit, duke i dhënë përparësi në përmendje fjalës selam ndaj emrit të atij që i jepet salami, sepse kjo është lutje për mirësi dhe më e mira është që në duanë për mirësi t’i jepet përparësi përmendjes së duasë (lutjes) ndaj përmendjes së atij për të cilin lutet. Siç e shohim këtë tek fjala e Allahut: “Mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi ju o familja e Ibrahimit” dhe fjala e Tij: “Selami (paqja, shpëtimi, siguria) qoftë mbi Ibrahimin” dhe fjala e Tij: “Selami (paqja, shpëtimi, siguria) qoftë mbi Nuhun” dhe fjala e Tij “Selami (paqja,

⁸⁰ Sh.p: Hadithin e ka saktësuar edhe Albani në Sahiha nr 1403.

shpëtimi, siguria) qoftë mbi Iljasin” dhe fjala e Tij “Selami qoftë mbi ju për shkak se bëtë durim”.

Ndërsa në lutjen për të keqe i jepet përparësi përmendjes së atij ndaj të cilit po lutesh –kjo në përgjithësi, por nuk është kusht gjithmonë- si p. sh. Në fjalën e Allahut duke iu drejtuar Iblisit: “Dhe vërtet mbi ty qoftë (është) mallkimi Im” dhe: “Vërtetë mbi ty është mallkimi” dhe “Mbi ta qoftë (është) e keqja dhe kurthet” dhe: “Dhe mbi ta qoftë (është) zemërimi”. Urtësia në këtë –Uallahu ealem- qëndron në faktin se duaja për mirësi është diçka e dëshiruar dhe e dashur për shpirtrat, është diçka pas së cilës rendin dhe e kërkojnë dhe kanë dëshirë ta dëgjojnë diçka të tillë, ndaj i jepet përparësi të dëgjojë fillimisht atë gjë që aq shumë e dëshiron dhe e kërkon, ashtuqë të fillojë zemra e tij ta parafytyrojë, pra kështu hap zemrën dhe dëgjimin e tij duke e bërë dëgjuesin të jetë në pritje: Kujt do t’i ndodhë kjo mirësi, kush do e arrijë atë, pastaj i përmendet emri i tij duke thënë (pas duasë): Mbi ty qoftë, për ty qoftë, duke bërë të ndjejë gëzim e kënaqësi, gjë e cila më pas sjell si pasojë dashamirësinë mes tyre, të dashurit e njëri-tjetrit, mëshirën mes tyre, të cilat janë qëllimi që kërkohet të arrihet nëpërmjet selamit. Ndërsa në duanë ndaj tij (me të keqe) i jepet përparësi përmendjes së emrit të atij mbi të cilin do bjerë duaja, si një formë lajmërimi për specifikimin e tij me atë të keqe, duke i bërë të qartë se ajo që u përmend është e veçantë vetëm për të, është njësoj si t’I thuash: Kjo është vetëm për ty, nuk ke ortak tjetër në të. Ndryshe nga duaja për të mirë, e cila është mirë të përgjithësohet dhe sa më shumë që lutësi të përgjithësojë dhe përfshijë, aq më mirë është.

Nga kjo mënyrë e të shprehurit përfitojmë diçka tjetër: Kur lutet ndaj tij (me të keqe) dhe thotë në fillim: Mbi ty qoftë, ai i vë veshin, përqendrohet vëmendja e tij, përmallohet zemra e

tij për atë që pritet, duke bërë kështu që kur të përmendet lutja kundra tij ta gjejë zemrën e tij të përmalluar dhe të gatshme për zbulimin e asaj duaje, duke qenë në këtë mënyrë goditja më e ashpër dhe më dëshpëruese për të ⁸¹.

Vërejtje: Fjala e Profetit salallahu alejhi ue selem : “sepse: alejkes-selam është përshëndetja që i thuhet të vdekurve” nuk ka për qëllim konsiderimin të ligjësuar të këtij selami për të vdekurit por është thjesht përshkrim i realitetit ekzistues dhe i thënies që kishin ata nëpër gjuhët e tyre në vizitën e të vdekurve në atë kohë dhe përshkrimi i realitetit nuk tregon për lejimin e asaj gjëje, e aq më pak që të jetë sunet. Përkundrazi, ndalimi që bëri Profeti salallahu alejhi ue selem nga kjo thënie, megjithëse në të njëjtën kohë na lajmëroi rreth asaj që thonin njerëzit, kjo tregon se ajo thënie nuk është e ligjësuar. Gjithashtu tregon se selami sipas Sunetit është që t’i jepet përparësi fjalës es-selamu ndaj emrit të atij që i jepet selami, qoftë në selamin që u jepet të gjallëve apo të vdekurve. Ashtu siç nuk i jepet selami të gjallëve: alejkumu selam po ashtu nuk u jepet selam të vdekurve me të.

Këto dy çështje i ka vërtetuar Suneti i saktë dhe i qartë ⁸². Ibnul Kajimi këtë sqarim e ka marrë nga el kadij Ijad, po ashtu e ka cekur diçka të tillë edhe el hafidhu Ibn Haxher në el Fet-h 1/5.

⁸¹ Marrë nga libri: Bedauiul Feuid 2/174.

⁸² Marrë nga fjala e Ibnul Kajimit në Bedauiul Feuid 2/173.

Bërja shenjë me dorë në dhënien salam.

Janë të shumtë ata muslimanë të cilët mjaftohen duke bërë me shenjë kur përshëndesin dikë, duke mos e shoqëruar këtë shenjë me dhënien e selamit dhe shqiptimin e tij. Është transmetuar ndalim nga ky veprim siç tregon hadithi që gjendet tek Tirmidhiu nëpërmjet zinxhirit të Amru bin Shuajb nga babai i tij nga gjyshi i tij nga Profeti salallahu alejhi ue selem se ai tha: “Mos u përngjasoni me çifutët dhe të krishterët. Përshëndetja e çifutëve është me gishta kurse përshëndetja e të krishterëve është me pëllëmbën e dorës”. Tirmidhiu tha: Ky është hadith garib, zinxhiri i tij është i dobët.

El hafidhu Ibnu Haxher ka thënë: Në zinxhirin e tij ka dobësi por të njëjtin kuptim e ka transmetuar dhe Nesaiu me zinxhir të mirë nga Xhabiri radijallahu anhu nga Profeti salallahu alejhi ue selem : “Mos përshëndesni me përshëndetjen e çifutëve, vërtet përshëndetja e tyre është me kokë, me pëllëmbë dhe me shenjë”⁸³.

Është saktësuar tek Suneni i Tirmidhiut, etj nga Esma bint Jezidi se Profeti salallahu alejhi ue selem kaloi një ditë në xhami ku po rrinin ulur disa gra dhe u bëri shenjë me dorë me selam”. Tirmidhiu tha: Hadithi është hasen⁸⁴.

Nuk ka mospërputhje mes këtij dhe hadithit të mëparshëm, sepse hadithi i Esmasë mund të kuptohet se Profeti salallahu alejhi ue selem bashkoi mes shqiptimit me gojë dhe shenjës me dorë. E përforcon këtë kuptim, transmetimi i Ebu Daudit të këtij hadithi nga Esmaja e cila tha: Kaloi pranë nesh Profeti salallahu alejhi ue selem dhe ne ishim një grup grash dhe ai

⁸³ Marrë nga el Fet-h 11/14, Sh.p.: Hadithin Albani e ka konsideruar hasen, es-Sahih nr 2194.

⁸⁴ Sh.p.:Hadithin Albani e ka konsideruar Sahih me përjashtim të shprehjes: Bëri shenjë me dorë. Tek Sahihu i Tirmidhiut nr 2697

na dha salam”. Këtë lloj kuptimi (bashkimi mes shqiptimit të selamit dhe shenjës me dorë) e ka cekur el alamet u Neueuiu në Rijadu Salihin.

Vërejtje: El hafidhu Ibnu Haxheri ka thënë: Ndalimi nga përshëndetja me dorë është i përkufizuar me ata persona që kanë mundësi ta shqiptojnë selamin, sepse në të vërtetë përshëndetja me dorë është e ligjruar për atë person i cili është i zënë me diçka që e pengon nga shqiptimi i përgjigjes së selamit që i jepet, si p.sh: ai që po falet apo ai që është larg (dhe nuk dëgjohet zëri i tij) apo memeci apo dhënia e selamit atij që është i shurdhër.

Lënia dhe neglizhenca e përhapjes së selamit.

Shumë njerëz e nënvlerësojnë një mirësi të madhe kur kalojnë pranë vëllezërve të tyre në islam, duke u treguar kopracë në dhënien e selamit atyre: “Dhe kush bën kopraci le ta dijë se po bën kopraci ndaj vetes së tij”(Muhamed 38). Me të vërtetë është pamje dëshpëruese dhe veprim lëndues. Si ia lejon vetes muslimani diçka të tillë?! Si mund të pëlqejë për veten e tij këtë gjë?!

Ndërkohë që Profeti salallahu alejhi ue selem na ka lajmëruar se xheneti nuk mund të arrihet me diçka tjetër përveç besimit dhe se besimi nuk arrihet përveçse nëpërmjet dashurisë, duke na treguar gjithashtu se cila është mënyra për të shtuar dashurinë mes veti duke thënë: “A tu tregoj diçka, të cilën nëse e veproni do të duheni mes veti: Përhapeni selamin mes jush”. Transmeton Muslimi në Sahihun e tij nga Ebu Hurejra. Profeti salallahu alejhi ue selem na ka urdhëruar që ta përhapim selamin ashtuqë të përhapet mirësia, të afrohen dhe bashkohen zemrat dhe të njëhsohen rradhët.

Transmetohet nga Berra bin Azib se ai tha: Profeti salallahu alejhi ue selem na ka urdhëruardhe që të përhapim selamin”. Mutefekun alejhi.

Transmetohet nga Abdullah bin Selam se ai tha: E kam dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem duke thënë: “O ju njerëz: Përhapeni selamin, jepni ushqim (ushqeni ata që kanë nevojë), mbajini lidhjet familjare dhe faluni natën kur njerëzit janë në gjumë, ashtuqë të hyni në xhenet me selam⁸⁵”. Transmeton Tirmidhiu dhe tha: Hadithi është Hasen Sahih (i mirë, i saktë).

Dije – o musliman - se në përhapjen e selamit mes muslimanëve ka dobi të shumta dhe veçori madhështore, prej tyre:

- Kjo vepër është ripërtëritje (ringjallje) e sunetit të Mustafasë.
- Është praktikim i Sunetit të Mustafasë.
- Tregon për besimin e fortë dhe të lartë të atij që e përhap selamin.

Buhariu në Sahihun e tij 1/82 ka thënë: Kapitulli: Përhapja e selamit është nga islami.

Amari –bin Jasir- ka thënë: Kush i posedon këto tre cilësi e ka poseduar dhe përmbledhur besimin: Të tregohet i drejtë me veten e tij, t’i japë selam gjithë njerëzve (muslimanëve) dhe të japë sadaka atëherë kur ka pak (në varfëri e gjendje të vështirë)”.

Ndërsa në disa transmetime të tjera të këtij etheri jashtë Buhariut thuhet: “Kush i ka (posedon) këto tre cilësi e ka plotësuar besimin”.

Shpjegimi i etherit:

⁸⁵ Sh.p: paqe e siguri dhe duke u përshëndetur nga engjëjt me selam

- a. Ai që është i pajisur me cilësinë e të mbajturit drejtësi me veten e tij, do t'i kryejë të gjitha obligimet që i ka të ngarkuara mbi vete, qofshin obligime ndaj Zotit të tij apo ndaj njerëzve.
- b. Ai që i jep selam të gjithëve dhe e ka të lehtë këtë, pajiset me virtytet fisnike, të larta dhe kështu arrihet bashkimi, afrimiteti dhe dashuria mes muslimanëve.
- c. Ai që jep sadaka megjithëse është në varfëri e në rrizk të pamjaftueshëm, ka arritur kulmin e bujarisë dhe është i bindur në atë që Allahu posedon dhe jep⁸⁶.

Nga dobitë e përhapjes së selamit:

1. Pastrimi i vetes nga vesi i ulët i kopracisë, i cili është transmetuar në fjalën e Profetit salallahu alejhi ue selem : “Njeriu më koprac është ai që bën kopraci në dhënien e selamit”. Transmeton Taberaniu, hadithi është hasen.
2. Përhapja e selamit është shkak për hyrjen në xhenet.
3. Është shkak për përhapjen e dashurisë dhe afrimitetit mes muslimanëve.
4. Është dhënie e të drejtës së muslimanit. Është vërtetuar në Sahihun e Muslimit nga Ebu Hurejra se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Të drejtat e muslimanit ndaj muslimanit janë gjashtë: kur ta takosh jepi selam.....”.
5. Përhapja e selamit i zemëron dhe i mllëfos çifutët. Është vërtetuar tek Suneni i Ibn Maxhes nga Aisheja radijallahu anhu e cila tha: Profeti salallahu alejhi ue

⁸⁶ Këto përfitime janë përmbledhur nga ajo që Ibn Haxheri ka përmendur në el Fet-h 1/83 nga Ibn Siraxhi e dijetarë të tjerë dhe nga çfarë ka përmendur Neueuiu në el Edhkar fq 208.

selem ka thënë: “çifutët nuk ju kanë zili për diçka tjetër ashtu siç u kanë zili për selamin dhe thënien Amin”.

6. Ai që jep selam është më parësor për të qenë më afër Allahut. Është vërtetuar tek Suneni i Ebu Daudit nga Ebu Umameh radijallahu anhu i cili tha: Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Vërtet, njeriu më parësor tek Allahu është ai që u jep selam njerëzve i pari”⁸⁷.

El alametü en-Neueui në el Edhkar ka thënë: Duhet që secili nga ata dy muslimanë që takohen, të kujdeset që të jetë ai i pari që jep selam, duke u bazuar në këtë hadith. Kuptimi i hadithit është ashtu siç ka thënë el alametü el Menauij në Fejdul Kadir: “Më parësor tek Allahu” : domethënë nga më të zgjedhurit për të merituar mëshirën e Tij, faljen e Tij dhe afërsinë e Tij pasi të hyjnë në xhenet. Është thënë kuptim tjetër: Ai i cili i jep selam vëllaut të tij musliman është më afër Allahut me bindje ndaj Tij, sepse ishte i pari në përmendjen e Allahut. Prandaj Ebu Bekri radijallahu anhu i tha Egarr el Muzaniut: Mos të të paraprijë dikush në dhënien selam. E ka transmetuar Taberaniu dhe tha Ibn Haxheri në el Fet-h: Me zinxhir të saktë.

7. Duke dhënë selam arrin 30 të mira (sevape) nëse e jep atë të plotë.
8. Arrin shpërblimin e sadakasë të përmendur në fjalën e Profetit salallahu alejhi ue selem : “çdo ditë që gdhin, njeriu duhet të japë sadaka për çdo nyje të trupit të tij.dhe dhënia jote selam njerëzve është sadaka”. Hadithin e ka transmetuar Ahmedi me zinxhir të saktë,

⁸⁷ Sh.p:Hadithin e ka saktësuar Albani në verifikimin e tij të Sunen Ebi Daudit nr 5197.

po ashtu gjendet në Sahihun e Muslimit por pa përmendjen e selamit⁸⁸.

Këto ishin disa nga dobitë e përhapjes së selamit dhe pas kësaj themi: si mund tia lejojë vetes i logjikshmi i mençur që të neglizhojë në përhapjen e selamit?!

I takon muslimanit ta përhapë selamin në tokë, duke shpresuar në shpërblimin e Allahut për ringjalljen dhe praktikimin që po i bën Sunetit dhe të mos e shmangin nga vazhdimësia në këtë mirësi dhe rrugë, pengesat që mund të hasë si: tallja, lëndimet, mos kthimi i selamit, etj, sepse përhapja e suneteve ka nevojë për durim dhe kurajo: “Me të vërtetë u jepet shpërblim durimtarëve pa llogari”.

Tufejl bin Ubej bin Kab vinte tek Abdullah bin Umeri dhe dilte me të në treg. Tufejli tha: Kur dilnim në treg, Ibn Umeri nuk kalonte pranë dikujt veçse i jepte selam, qoftë ai teneqexhi apo tregtar apo miskin (i varfër) apo kushdo qoftë. Tufejli më pas tha: Shkova një ditë tek Abdullah bin Umeri dhe më kërkoi që të dilnim në treg, i thashë atij: çfarë do bësh në treg kur ti nuk qëndron diku për të blerë dhe as nuk pyet për çmimet e mallrave, as nuk bën pazar në çmime dhe as nuk ulesh në mexhliset e tregut? (Ibn Umeri) Tha: O plëncuk – sepse ishte njeri me bark- ne dalim për shkak të selamit, i japim selam çdokujt që takojmë”.

Neueuiu në Rijadus-Salihin ka thënë: E ka transmetuar Maliku në el Mueta me sened të saktë.

⁸⁸ El alametu es-Sefarinij i ka përmendur dobitë e selamit në shpjegimin e Mendhumetul adab. Unë lashë disa pa përmendur nga ato që ai ka thënë dhe shtova disa të tjera.

Neglizhimi i dhënies selam fëmijëve.

Dy shejhat (Buhariu dhe Muslimi) kanë transmetuar nga Enesi radijallahu anhu se ai po kalonte pranë disa fëmijëve dhe u dha selam, pastaj tha: Profeti salallahu alejhi ue selem ishte që vepronte kështu.

Në transmetimin e imam Ahmedit nga Shu`beh nga Sejari i cili tha: Isha duke ecur me Thabit el Bunanij, i cili kur kaloi pranë disa fëmijëve u dha selam dhe tregoi se njëherë po ecte me Enesin radijallahu anhu i cili kur kaloi pranë një grupi fëmijësh u dha selam atyre dhe tregoi se ai njëherë po ecte me Profetin salallahu alejhi ue selem i cili kur kaloi pranë një grupi fëmijësh u dha selam atyre.

Ibn Betali ka thënë: Dhënia e selamit fëmijëve i ushtron ata në praktikimin e rregullave dhe edukatës së sheriatit. Gjithashtu i bën të mëdhenjtë që të zhvishen nga mendjemadhësia dhe të pajisen me modesti e butësi⁸⁹.

El Kirmanij ka thënë: Kjo është pjesë e moralit të tij madhështor dhe edukatës së tij fisnike. Nga ky veprim përfitohet ushtrimi i tyre në mësimin e suneteve dhe zbatimin e edukatave të sheriatit ashtuqë kur të arrijnë moshën e bulugut (pubertetit) të jenë të edukuar sipas sheriatit. (Marrë nëpërmjet librit ed-Dalil të Ibn Il-lanit.

Njerëzit sot e kanë braktisur këtë sunet, përveç një pakice prej tyre, ndaj i takon muslimanit që ta ringjallë këtë sunet duke pasur si shembull në këtë veprim Profetin salallahu alejhi ue selem dhe shokët e tij fisnikë radijallahu anhum , si dhe duke pastruar veten nga sëmundja e mendjemadhësisë dhe duke qenë njëkohësisht ushtrim dhe mësim për të vegjëlit në praktikimin e Sunetit dhe moralit të mirë. Nëse dikush e sheh si të madhe këtë vepër dhe e konsideron veten e tij më lart se sa tu japë selam fëmijëve atëherë le të kujtojë Profetin

⁸⁹ Marrë nëpërmjet librit el Fet-h të Ibn Haxherit 11/33.

salallahu alejhi ue selem, zotëriun e bijve të Ademit (mbarë njerëzisë), modestinë dhe përrulshmërinë e tij, qoftë edhe me fëmijët.

“Me të vërtetë ju keni shembullin më të mirë tek Profeti. Kjo për atë që shpreson në Allahun dhe ditën e fundit”.

Tha (Ibn Haxheri) në el Fet-h: Përjashtohet nga dhënia e selamit fëmijëve, nëse ai është i bukur dhe dhënia e selamit mund të jetë shkak që të sprovohet me të (t’i hyjë në zemër), në këtë rast nuk ligjërohet selami sidomos nëse ai fëmijë është i njomë dhe i vetëm.

Dukuria e mosdhënies selam kur largohet nga mexhlisi.

Shumë njerëzve u është bërë zakon që kur dalin dhe largohen nga mexhlisi ku po rrinin, të mos u japin selam atyre që qëndrojnë në mexhlis por mjaftohen me shprehjen: Fi emanillah (qofshi në mbrojtjen dhe sigurinë e Allahut), ose: Meas-selameh (qoftë paqja me ty), e shprehje të tjera të ngjashme. Ky veprim bie në kundërshtim me udhëzimin profetik, i cili na mëson që nëse dikush del dhe largohet nga mexhlisi, të japë selam.

Në Musnedin e imam Ahmedit —e të tjerë— transmetohet nga Ebu Hurejra nga Profeti salallahu alejhi ue selem se ai tha: “Kur dikush prej jush të mbërrijë tek mexhlisi le të japë selam. Nëse dëshiron të ulet, le të ulet, pastaj nëse ngrihet dhe të tjerët vazhdojnë të qëndrojnë ulur, le të japë selam sepse selami i parë nuk është më i meritueshëm se sa i dyti”. Hadithi është i saktë.

Et-Tijbi ka thënë: Është thënë: Ashtu siç selami i parë tregon se ata njerëz janë të sigurtë dhe të ruajtur nga sherri i atij që

erdhi dhe dha selam, gjatë pranisë së tij aty, po ashtu selami i dytë është lajmërim që tregon sigurinë dhe ruajtjen e tyre nga sherri i tij në mungesë të tyre. Ruajtja dhe siguria nga e keqja e tij gjatë prezencës së tij nuk është më parësore se sa siguria prej tij në mungesë, bile përkundrazi kjo e dyta është më parësore.

Marrë nëpërmjet librit Delilul falihin të Ibn Il-lanit. Shpjeguesi i librit el Edebul mufrad ka thënë: Hadithi ka për qëllim se secila prej tyre është e drejtë e muslimanit dhe sunet i ligjëruar, që të jep të ndjesh një bashkëjetesë dhe mirëkuptim mes tyre, kurse nëse ai kthehet (largohet) pa dhënë selam ndoshta ky kthim i tij në mënyrë të heshtur i vë në pozitë të vështirë anëtarët e atij mexhlisi dhe i preokupon ata.(mbaroi). Prandaj, kërkohet nga muslimanët që ta ringjallin këtë sunet në mexhliset e tyre dhe të përkujdesen për zbatimin e tij, sepse udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit. Nuk ka ndonjë pengesë që e ndalon muslimanin të thojë edhe shprehje të tjera lamtumirëse dhe përsëritëse si p.sh.: fi emanil-lah, etj por me kusht që ta zbatojë Sunetin duke dhënë selam kur të largohet nga mexhlisi. Allahu është Ai që jep sukses.

Mosdhënia e selamit nëse koha e ndarjes mes tyre është e shkurtër.

Përsëritet shpesh takimi mes disa kategorive të shoqërisë (të cilët janë anëtarë të një bashkësie të caktuar njerëzish) si p.sh: në vendet e punës, në shkollë, etj dhe shumica prej tyre mjaftohen me selamin që japin kur takohen fillimisht, ndërsa nëse takohet me të më pas, një herë apo më shumë, nuk i jep më selam. Ky veprim është në kundërshtim me sunetin Profetik, sepse është vërtetuar se një person erdhi dhe u fal, pastaj erdhi tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe dha

selam. Profeti salallahu alejhi ue selem ia ktheu selamin dhe tha: “Ktheu dhe falu sepse nuk u fale (siç duhet)”. Personi u kthye dhe u fal pastaj erdhi dhe i dha selam Profetit salallahu alejhi ue selem. Profeti salallahu alejhi ue selem ia ktheu selamin dhe i tha: “Kthehu dhe falu sepse nuk u fale.....” Mutefekun alejhi.

Neueuiu në librin Rijadus-Salihin e titulloi kapitullin e këtij hadithi me titullin: Pëlqyeshmëria e përsëritjes së selamit ndaj atij me të cilin përsëritet takimi pas një kohe të shkurtër, si p.sh.: nëse hyn, pastaj del dhe rihyn menjëherë ose p.sh.: nëse ndan mes tyre një pemë apo diçka tjetër e ngjashme.

Kështu është Suneti, ndaj kërkohet nga muslimani i cili i dha selam vëllait të tij musliman dhe pastaj takohet me të përsëri pas pak, që ta përsërisë dhënien e selamit ashtuqë të arrijë shpërblimin e selamit dhe të shërbejë për shtimin e afrimitetit mes tyre. Allahu është Ai që jep sukses.

Dhënia selam atij që po falet dhe si ia kthen ai.

çështja e dhënies selam atij që po falet është paksa e gjerë dhe për ta përfshirë atë nga të gjitha anët ka nevojë për një broshurë të veçantë. Fjala përmbledhëse rreth saj është të themi: Lejohet dhënia selam atij që po falet dhe nuk është veprim i papëlqyeshëm (mekruh). Nëse i jepet selam atij që po falet, atëherë kthimi i selamit në këtë rast ka tre alternativa:

Alternativa e parë: Kthimi i selamit me të shqiptuar duke thënë: Ue alejkumus-selamu ue rahmetullahi ue berakatuhu. Nëse e kthen selamin në këtë mënyrë duke qenë në namaz, ky veprim e prish namazin sipas mendimit më të saktë nga mendimet e dijetarëve. Buhariu në Sahihun e tij në Librin: Veprimet në namaz (3/72) ka thënë: Kapitulli: çfarë ndalohe të

flitet në namaz, pastaj solli me zinxhirin e tij nga Alkameh nga Abdullah bin Mesudi i cili tha: Ishim që i jepnim salam Profetit salallahu alejhi ue selem kur ai po falej dhe ai na e kthente. Kur u kthyem nga Nexhashiu (emigrimi në Etiopi) i dhamë salam (kur ai po falej) por nuk na e ktheu pastaj tha: “Vërtet në namaz jemi të zënë (me diçka tjetër)”. Gjithashtu këtë hadith Muslimi e ka transmetuar në Sahihun e tij në Librin e Xhamive (me shpjegimin e Neueuiut 5/26). Neueuiu e titulloi kapitullin e këtij hadithi duke thënë: Kapitulli: Ndalimi i të folurit në namaz dhe anulimi i lejimit të tij që është më parë.

Ebu Daudi e ka transmetuar këtë hadith (1/568) nëpërmjet transmetimit të Ebul Uail nga Ibn Mesudi me tekst më të plotë se i mëparshmi duke thënë: Ishim që jepnim salam gjatë namazit dhe flisnim për nevojat që kishim, derisa një ditë erdha tek Profeti salallahu alejhi ue selem kur ai po falej dhe i dhashë salam por nuk ma ktheu. Unë u shqetësova në vetvete duke thënë me vete: çfarë ka ndodhur? Pasi që Profeti salallahu alejhi ue selem e kreu namazin tha: “S’ka dyshim se Allahu urdhëron me çfarë të dëshirojë dhe vërtet Allahu ka urdhëruar së fundmi: që të mos flisni në namaz” atëherë ma ktheu selamin. Gjithashtu e ka transmetuar dhe Nesai⁹⁰. Në dy Sahihet transmetohet nga Xhabir bin Abdullahi i cili tha: Ishim me Profetin salallahu alejhi ue selem dhe më dërgoi për diçka. Kur u ktheva, ai po falej mbi kafshën e tij të udhëtimit dhe nuk ishte i drejtuar nga kibleja, dhashë salam por nuk ma ktheu. Pasi që

⁹⁰ Sh.p: Albani e konsideroi hadithin Hasen Sahih në verifikimin dhe reçensimin e tij tek Sunen Ebi Daud nr 924

mbaroi tha: “Nuk më pengoi gjë që të ta ktheja selamin përveçse faktit që po falesha”.

Ky tekst është një nga transmetimet e Muslimit. Buhariu e ka titulluar kapitullin e këtij hadithi duke thënë: Kapitulli: Nuk kthehet selami duke qenë në namaz⁹¹.

Ibn Kudameh ka thënë: Nëse dikush i jep selam atij që po falet, nuk i lejohet muslimanit që tia kthejë selamin me të shqiptuar. Nëse ia kthen me të shqiptuar, namazi i tij priset. Ky është mendimi i Malikut, Shafiut, Is-hakut (bin Rahujeh) dhe Ebu Theurit⁹².

Alternativa e dytë: Ta kthejë selamin me shenjë, pa shqiptim. Ky veprim është gjë e mirë duke u bazuar në atë që ka transmetuar Ebu Daudi (1/569) nga Abdullah bin Umeri i cili tha: Profeti salallahu alejhi ue selem shkoi në xhaminë Kuba për tu falur. Tha: Erdhën ensarët tek ai dhe i dhanë selam gjatë kohës që po falej. Tha: i thashë Bilalit: Si e ke parë Profetin që ua kthente atyre që i jepnin selam kur ai po falej? Tha: Kështu, e shtriu dorën e tij, duke e lënë pëllëmbën e dorës poshtë dhe duke ngritur shpinën e dorës lart, të njëjtin veprim bëri dhe Xhafer bin Auni (njëri nga transmetuesit e zinxhirit të këtij hadithi)”. Tirmidhiu e transmeton këtë hadith të shkurtuar⁹³ dhe tha: Hasen Sahih⁹⁴.

Ibn Kudameh ka thënë: Ai që falet e kthen selamin me shenjë. Ky është mendimi i Malikut, Shafiut, Is-hakut

⁹¹ El Fet-h 3/86.

⁹² Marrë nga libri el Mugnij 2/460, botimi me verifikimin dhe reçensimin e docentit Abdullah Turkij dhe docentit: el Hul`vu.

⁹³ 2/204.

⁹⁴ Sh.p.: Po ashtu të njëjtën gjë tha dhe Albani: Hasen Sahih në verifikimin e tij tek Sunen Ebi Daud nr 927.

dhe Ebu Theurit⁹⁵.
Neueuiu në shpjegimin e tij të Sahihu Muslimit⁹⁶ ka thënë: Është mustehab (e pëlqyeshme) ta kthejë selamin me shenjë. Këtë mendim ka Shafiu dhe shumica e dijetarëve.

Në këtë hadith dhe atë para tij, kemi kundërpërgjigjen më të mirë ndaj atyre që pretendojnë se është mekruh (e papëlqyeshme) që t'i jepet selam fillimisht atij që falet (musaliut). Profeti salallahu alejhi ue selem nuk i qortoi ensarët për veprimin e tyre, përkundrazi ua ktheu atyre me shenjë, gjë e cila tregon ligjshmërinë e dhënies selam musaliut (atij që po falet) dhe se ai mund ta kthejë selamin në namaz me shenjë ose pasi ta kryejë namazin⁹⁷.

Alternativa e tretë: Ta kthejë selamin pasi të kryejë namazin. Gjithashtu kjo është gjë e mirë, duke u bazuar në hadithin e Abdullah bin Mesudit radijallahu anhu që e përmendëm më heret dhe hadithin e Xhabirit, dhe që të dy janë në dy Sahihet. El Hatibi në Mealimus-sunen 1/434 ka thënë: Kthimi i selamit me të shqiptuar duke qenë në namaz është i ndaluar, ndërsa kthimi i tij pas mbarimit të namazit është sunet, siç ia ktheu Profeti salallahu alejhi ue selem selamin Ibn Mesudit pasiqë e kreu namazin. Gjithashtu bërja me shenjë (për kthimin e selamit në namaz) është gjë e mirë, është transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem se ai ka bërë me shenjë në namaz (për kthimin e selamit).

⁹⁵ El Mugnij 2/460.

⁹⁶ 5/27.

⁹⁷ Kjo është fjala e Ibn Haxherit, el Fet-h 3/87.

Dhënia e selamit gjatë kërkimit të lejes (për të hyrë në shtëpi).

Suneti në kërkimin e lejes për të hyrë në shtëpi apo diku tjetër është: Ai që kërkon leje u jep selam banorëve të asaj shtëpie – apo ç’mund të jetë tjetër e ngjashme me shtëpinë-dmth:qëndron në të djathtë të derës apo në të majtë dhe pasi troket në derë thotë: Eselamu alejkum. Këtë veprim e përsërit tre herë dhe nëse i jepet leje për të hyrë, hyn ose përndryshe kthehet mbrapsht.

Shoqërimin me selam të kërkimit të lejes për të hyrë, e vërteton hadithi që është transmetuar në Sunenin e Ebu Daudit⁹⁸ nga Rib’ij bin Harash i cili tha: Një person nga fisi beni Amir na ka treguar se ai i kërkoi leje Profetit salallahu alejhi ue selem kur ai ishte në një nga shtëpitë (e grave të tij) duke thënë: A të hyj? Profeti salallahu alejhi ue selem i tha shërbëtorit të tij: “Dil tek ky person dhe mësoje si të kërkojë leje, i thuaj të thotë: Eselamu alejkum, a mund të hyj? Personi e dëgjoi këtë që nga jashtë dhe tha: Eselamu alejkum, a mund të hyj? Profeti salallahu alejhi ue selem i dha leje për të hyrë dhe hyri”. E ka saktësuar Darekutni.

Ibn Muflihi dhe Ibn Haxheri kanë thënë: Isnadi (zinxhiri) i tij është i mirë⁹⁹.

Gjithashtu në Sunenin e Ebu Daudit¹⁰⁰ transmetohet nga Keledete bin Hanbel se Safuan bin Umejeh e dërgoi atë tek Profeti salallahu alejhi ue selem për t’i dhuruar një sasi qumështi, një kaproll dhe disa tranguj, ndërkohë që Profeti salallahu alejhi ue selem ishte në pjesën e sipërme të Mekes.

⁹⁸ 5/369.

⁹⁹ Marrë nga el Fet-h 11/3 dhe el Adabu esh-sher`ijeh 1/449.

Sh.p.: Hadithin e ka saktësuar Albani në Sahiha nr 818.

¹⁰⁰ 5/368.

(Tha): Hyra tek Profeti salallahu alejhi ue selem pa dhënë selam, ai më tha: “Kthehu dhe thuaj: Eselamu alejkum”. Kjo ndodhi pasi që Safuan bin Umejeh kishte pranuar islamin”. Po ashtu e ka transmetuar Tirmidhiu¹⁰¹ dhe shtoi në transmetimin e tij: dhe thuaj: Eselamu alejkum, a të hyj”, pastaj tha: Hadithi është hasen.

Ibn Muflihi në el Adab 1/449 tha: Hadithi është i mirë¹⁰².

Transmetohet në Musanefin të Ibn Shejbeh nga Ibn Burejdeh i cili tha: Një person i kërkoi leje për të hyrë në njëri prej shokëve të Profetit salallahu alejhi ue selem . Ai duke qëndruar tek dera thoshte: A të hyj? Tre herë. Sahabiu që nga brenda po e shihte atë, por nuk i dha leje (nuk i foli). Pastaj personi tha: Eselamu alejkum, a mund të hyj? Atëherë i tha: Hyr. Më pas (sahabiu) i tha: Sikur të qëndroje tek dera deri në darkë duke thënë: A të hyj, nuk do të të jepja leje derisa të filloje me selam.

Buhariu në el Edebul mufrad në kapitullin: Kërkimi i lejes është diçka tjetër përveç selamit¹⁰³, ka transmetuar se Ebu Hurejra në lidhje me atë që kërkon leje para se të japë selam ka thënë: Nuk i jepet leje derisa të fillojë me selam.

Përsai përket kërkimit të lejes tre herë duke e shoqëruar me selam, kjo është e bazuar në atë që Buhariu ka transmetuar¹⁰⁴ dhe Muslimi¹⁰⁵ nga Ebu Musa el Esharij.

Në tekstin e Muslimit thuhet: Ebu Musa radijallahu anhu erdhi tek Umer bin el Hatabi radijallahu anhu dhe tha: Eselamu alejkum, jam Abdullah bin Kajsi. Umeri nuk i dha leje¹⁰⁶. Ai tha: Eselamu alejkum, jam Ebu Musa. Eselamu

¹⁰¹ 5/65.

¹⁰² Sh.p.: Hadithin e ka saktësuar Albani në Sahiha nr 88.

¹⁰³ 2/505-518.

¹⁰⁴ 11/26.

¹⁰⁵ 3/1396.

¹⁰⁶ Sh.p: Nuk i foli, nuk iu përgjigj me zë.

alejku, jam el Eshariu, pastaj u largua. Umeri i tha (shërbëtorit ose fëmijëve): Thirreni të vijë, thirreni të vijë. E thirren dhe erdhi. Umeri radijallahu anhu tha: O Ebu Musa, çfarë të bëri të ktheheshe? Unë isha i zënë. Tha (Ebu Musa): E kam dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem duke thënë: “Kërkimi i lejes bëhet tre herë, nëse të jepet leje hyr ose përndryshe kthehu”.

Duke u bazuar në këtë hadith, nuk duhet të shtojë mbi tre herë, gjithashtu në bazë të etherit që AbduRrezaku ka transmetuar në el Musanef¹⁰⁷ dhe Buhariu në el Edebul mufrad¹⁰⁸ nga Ebul Alanijeh¹⁰⁹ i cili tha: i dhashë selam Ebu Seid el Hudriut tre herë por nuk mu përgjigj askush. U mënjanova në një qoshe dhe po prisja. Doli një person që ishte dërguar për të më dhënë leje dhe tha: Hyr. Pasiqë hyra, Ebu Seidi radijallahu anhu më tha: Nëse do shtojë mbi tre herë nuk do të të jepja leje.

Imam Ibn Abdulberri në et-Temhid 24/204 në lidhje me hadithin e mëparshëm të Ebu Musës ka thënë: Hadithi –me aq sa kuptohet qartë prej tij në pamje të parë- e bën detyrë që të mos kërkohet leje mbi tre herë, nëse i jepet leje hyn, nëse jo kthehet. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Disa dijetarë kanë thënë: Dhënia selam herën e parë konsiderohet kërkim leje për të hyrë. Hera e dytë konsiderohet konsultim, a do t’i lejohet të hyjë apo jo? Hera e tretë është shenjë që tregon se duhet të kthehet dhe nuk shton mbi tre herë¹¹⁰.

¹⁰⁷ 10/381.

¹⁰⁸ 2/511.

¹⁰⁹ Ndërsa në el Fet-h 11/30, Ibn Haxheri thotë: Nga Ebul Alijeh.

¹¹⁰ Ibn Abdulberri gjatë trajtimit të kësaj çështjeje ka përmendur dhe fjalën e atyre dijetarëve që thonë: Nëse trokitësi mendon se nuk e kanë dëgjuar (Sh.p.: Sepse mund të ketë qenë trokitja e dobët apo shtëpia është e gjerë dhe me shumë dhoma) nuk ka problem që të shtojë mbi tre herë.

Urtësia të cilën e përmendi Ibn Abdulberri rreth kërkimit të lejes tre herë, është transmetuar diçka e ngjashme me të, nga prijësi i besimtarëve Alij bin Ebi Talib në el Musanef të Ibn Ebi Shejbeh se ai ka thënë: Hera e parë është lajmërim, hera e dytë është konsultim ndërsa e treta vendim, pas kësaj nëse i jepet leje hyn ose përndryshe të kthehet”.

Përsa i përket trokitjes së derës nga ai që po kërkon leje, kjo është e bazuar në hadithin që e ka transmetuar Buhariu¹¹¹ dhe Muslimi¹¹² nga Xhabir bin Abdullahi –teksti i mëposhtëm është i Buhariut- i cili tha: Erdha tek Profeti salallahu alejhi ue selem që t’i flisja rreth një borxhi që babai im kishte lënë pas dhe trokita në derë. Ai tha: “Kush është?” thashë: Unë. Tha: “Unë, Unë”, sikur nuk i pëlqeu kjo thënie.

Ibnul Arabiu ka thënë: Nga hadithi i Xhabirit përfitohet ligjshmëria e trokitjes së derës dhe nuk është përmendur në hadith sqarimi i faktit se trokitja ishte me ndonjë mjet apo pa mjet.

El hafidhu Ibn Haxheri i bëri një shënim fjalës së mësipërme të Ibnul Arabiut duke thënë: Thashë: Buhariu ka transmetuar në el Edebul mufrad një hadith nga Enesi se dyert e Profetit salallahu alejhi ue selem trokiteshin me thonj. E ka transmetuar dhe Hakimi në librin Ulumul hadith nga el Mugirah bin Shubeh. Ky veprim i tyre (trokitja me thonj) mund të konsiderohet si formë e lartë edukate dhe mirësjelljeje me Profetin salallahu alejhi ue selem dhe ky veprim është diçka e mirë nëse personi brenda në shtëpi, e ka vendqëndrimin e tij afër derës, ndërsa nëqoftëse vendqëndrimi i tij është larg derës dhe nuk arrin tek ai zhurma e trokitjes me

¹¹¹ 11/35.

¹¹² 3/1697.

thonj, atëherë është e pëlqyeshme të trokasë me diçka më të fortë (se thonjtë) në varësi të situatës (dhe llojit të derës)¹¹³.

Ebu Daudi në Sunenin e tij¹¹⁴ e titulloi kapitullin e hadithit të Xhabirit radijallahu anhu duke thënë: Kapitulli rreth personit që kërkon leje duke trokitur në derë.

El hafidhu Ibnu Haxheri ka përmendur se Xhabiri radijallahu anhu shkoi tek Profeti salallahu alejhi ue selem për një nevojë që kishte dhe nuk kishte për qëllim të hynte brenda, ndaj dhe nuk dha selam por u mjaftua me trokitjen e derës që ta njoftonte Profetin për ardhjen e tij, pra nga fjala e Ibn Haxherit kuptohet se ai bën dallim mes atij që vjen për një nevojë të tijën dhe nuk ka për qëllim hyrjen brenda dhe mes atij që vjen duke pasur për qëllim të hyjë brenda. (Sipas tij) : i pari mund të mjaftohet vetëm me të trokiturën, ndërsa i dyti duhet të japë selam. Uallahu ealem (Allahu e di më së miri).

Është mekruh (e papëlqyeshme) t'i jepet selam atij që është i zënë me kryerjen e nevojave fiziologjike (jashtëqitje apo urinim).

Duke qenë se es-Selamu është një nga emrat e Allahut, nuk është e pëlqyeshme që të përmendet në vendet e pisëta, ndaj i është ndaluar muslimanit që t'i japë selam atij që është i zënë me kryerjen e nevojave fiziologjike ashtu që të mos bëhet shkak që tia kthejë selamin duke qenë në atë gjendje.

Imam Muslimi në Sahihun e tij¹¹⁵ ka transmetuar nga Ibn Umeri radijallahu anhu se një person kaloi pranë Profetit salallahu alejhi ue selem kur ai po urinonte dhe i dha selam por Profeti salallahu alejhi ue selem nuk ia ktheu atij.

¹¹³ Marrë nga el Fet-h 11/36.

¹¹⁴ 5/374.

¹¹⁵ 4/65 me shpjegimin e Neueuiut.

Ibn Muflihi në el Adab¹¹⁶ ka thënë: Nuk preferohet t'i jepet selam atij që po kryen nevojën fiziologjike si dhe kthimi i atij selami. Këtë fjalë e ka thënë dhe imam Ahmedi, sepse Profeti salallahu alejhi ue selem nuk ia ktheu atij që i dha selam kur ai po urinonte, siç transmetohet tek Muslimi.

Neueuiu ka thënë: Dijetarët e medhhebit tonë kanë thënë: Nuk preferohet që t'i jepet selam atij që është i zënë me kryerjen e nevojave fiziologjike –jashtëqitje qoftë apo urinim-, nëse i jepet selam nuk është e pëlqyeshme për të që tia kthejë.

Preferohet që të jepet selami duke qenë i pastër (me abdes ose tejemum).

Duke qenë se selami është dhikr i ligjëruar, është e preferueshme që të zbatohet nga muslimani duke qenë me abdes. Është vërtetuar në dy Sahihet¹¹⁷, nga Ebul Xhuhejmi radijallahu anhu i cili tha: Profeti salallahu alejhi ue selem po vinte nga drejtimi i pusit Xhemel, kur e takoi një person dhe i dha selam por Profeti salallahu alejhi ue selem nuk ia ktheu në çast, u drejtua për tek muri (që kishte pranë, e preku atë) dhe fshiu fytyrën dhe duart e tij (duke marrë tejemum) pastaj ia ktheu selamin atij.

Gjithashtu ka transmetuar Nesai¹¹⁸, Ebu Daudi¹¹⁹ dhe Ibn Maxheh¹²⁰, të gjithë nga el Hasen (el Basrij) nga Husejn bin el Mundhir Ebu Sasan nga el Muhaxhir bin Kunfudh se ai i dha selam Profetit salallahu alejhi ue selem kur po urinonte por (Profeti) nuk ia ktheu derisa mori abdes. Pasiqë mori abdes ia ktheu. Ky ishte teksti i Nesaiut, ndërsa në tekstin e Ibn

¹¹⁶ 1/378.

¹¹⁷ Buhariu në Kapitullin e tejemumit (1/441) dhe Muslimi në Kapitullin e tejemumit (4/64 me shpjegimin e Neueuiut).

¹¹⁸ 1/37.

¹¹⁹ 1/23.

¹²⁰ 1/126.

Maxhes thuhet: Erdha tek Profeti salallahu alejhi ue selem dhe ai po merrte abdes. i dhashë salam por nuk ma ktheu selamin. Pasiqë mbaroi abdesin tha: “Nuk më pengoi gjë tjetër që të ta ktheja selamin përveçse fakti që nuk isha me abdes”.

Ibn Maxheh e ka titulluar kapitullin e këtij hadithi duke thënë: Kapitulli në lidhje me atë që i jepet salam kur ai po urinon.

Es-Sindij në shënimet e tij rreth Sunen Ibn Maxhes ka thënë¹²¹: Në këtë transmetim thuhet: “kur ai po merrte abdes” ndërsa në transmetimin e Nesaiut dhe Ebu Daudit thuhet: “kur ai po urinonte”. Fjala e tij: “kur ai po merrte abdes” mund të komentohej se kishte për qëllim: ishte në parapërgatitje për fillimin e abdesit. Autori e ceku këtë lloj kuptimi në mënyrë indirekte duke e titulluar kapitullin e këtij hadithi me titullin e mësipërm.

Hadithin e ka transmetuar edhe imam Ahmedi në Musnedin e tij¹²² dhe pas hadithit thuhet: el Hasen (el Basrij) nuk e pëlqente që të lexonte (Kuran) ose të përmendte Allahun duke qenë pa abdes, duke u bazuar në këtë hadith.

Hadithin e ka saktësuar el Hakimi¹²³ dhe ia miratoi këtë gjykim Dhehebiu. Ibn Muflihu në el Adab¹²⁴ ka thënë: Zinxhiri i tij është i mirë.

Ibn Hibani pasi që e transmetoi këtë hadith¹²⁵ ka thënë: Profeti salallahu alejhi ue selem me fjalën e tij “Nuk më pëlqente ta përmendja Allahun veçse duke qenë në pastërti”¹²⁶, kishte për qëllim veprimin e asaj që është më e mira, sepse dhikri që bëhet duke qenë me abdes është më i vlefshëm (se ai pa abdes) dhe nuk kishte për qëllim me mospëlqimin e tij,

¹²¹ Shënimet e tij janë të botuara së bashku me tekstin e Sunenit, Ne jemi bazuar në botimin e parë të el Ilmijeh të vitit 1313 në Egjipt, vëllimi 1/74.

¹²² 4/345.

¹²³ 1/167.

¹²⁴ 1/377.

¹²⁵ 3/83, el Ihsan.

¹²⁶ Sh.p.: Abdes apo tejemum.

ndalimin nga dhikri pa abdes. Këtë kuptim që Ibn Hibani parashtroi, e përforcon hadithi që Muslimi e ka transmetuar në Sahihun e tij nga Aisheja radijallahu anha e cila tha: Profeti salallahu alejhi ue selem ishte që e përmendte Allahun në çdo kohë (e gjendje që të ishte). Neueuiu ka thënë: Qëllimi i kësaj fjale është se Profeti salallahu alejhi ue selem e përmendte Allahun kur ishte me abdes dhe kur ishte pa abdes, duke qenë xhunub, në këmbë, i ulur, i shtrirë, në ecje e sipër, etj. Uallahu ealem¹²⁷.

Pra, nxjerrim si përfundim se hadithi i Aishes radijallahu anhu tregon atë që është e lejuar, kurse hadithi i el Muhaxhirit dhe Ebul Xhuhejmit tregojnë për atë që është më e mira të veprohet. Uallahu ealem.

Dhënia selam familjes kur hyn në shtëpi.

Shumë njerëz tregohen të shkujdesur ndaj këtij suneti të bekuar, duke hyrë në shtëpitë e tyre dhe fillojnë në bisedë me familjet e tyre para se të japin selam. Këta persona e meritojnë që të mos u jepet përgjigje (derisa të japin selam) duke u bazuar në atë që transmetohet nga Ibn Umeri radijallahu anhuma nga Profeti salallahu alejhi ue selem se ai ka thënë: “Kush fillon me bisedë para dhënies së selamit mos iu përgjigjni”. E ka transmetuar Ibn es-Sunij¹²⁸.

¹²⁷ Marrë nga shpjegimi i Neueuiut 4/68.

¹²⁸ Në librin Amelul jeumi uel-lejleh fq 60. Zinxhiri i tij do të ishte i mirë po të mos kishte në të shejhun e Ibn Suniut, që quhet: Abas bin Ahmed. Ibn Asakiri e ka përmendur këtë person në librin e tij: Tarihu Dimeshk (Historia e Damaskut) dhe nuk ka përmendur rreth tij as xherh e as tadil. Nga ky person kanë transmetuar disa. El alamet u el Albani e ka bërë hasen këtë hadith në es-Silsiletu es-Sahihah 2/477.

Tirmidhiu ka transmetuar të ngjashëm me këtë hadith¹²⁹ nga Xhabiri radijallahu anhu dhe tha: Hadith munker (i refuzuar)¹³⁰.

Ibn Kajimi në Zadul Mead 2/414 ka thënë: Ky hadith edhe nëse është i dobët, kuptimi i tij është i saktë dhe i praktikuar nga muslimanët. Ky veprim i atyre (që nuk japin selam kur hyjnë në shtëpi) bie në kundërshtim me Sunetin praktik.

Ebu Daudi ka transmetuar në Sunenin e tij¹³¹ -në Librin e Edukatës- kapitulli: çfarë thotë personi kur hyn në shtëpinë e tij? Nga Ebu Malik el Esharij radijallahu anhu i cili tha: Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Kur dikush të hyjë në shtëpinë e tij le të thotë: Allahume inij eseluke hajral meulixhi ue hajral mehraxhi. Bismilahi uelexhna ue bismilahi haraxhna ue alallahi rabina teuekelna (O Allah unë të kërkoj mirësinë e hyrjes dhe mirësinë e daljes. Me emrin e Allahut po hyjmë dhe me emrin e Allahut dalim dhe Allahut, Zotit tonë i jemi mbështetur), **pastaj le t'i japë selam familjes së tij**”. Zinxhiri i tij është i saktë¹³².

Transmetohet në Sahihun e Muslimit 3/1625 se Profeti salallahu alejhi ue selem vinte natën dhe jepte selam të atillë

¹²⁹ Në 5/59.

¹³⁰ Sh.p.: Tirmidhiu në Sunenin e tij ka thënë: Kapitulli rreth asaj që është transmetuar se: Selami duhet të jepet para se të fillohet në bisedë. Pastaj solli hadithin e Xhabirit i cili tha: Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Selami para bisedës” (para se të fillohet bisedë). Albani e konsideroi hadithin hasen. Për më tepër shiko es- Sahiha nr. 816.

¹³¹ 13/438.

¹³² Dikush nga dijetarët e ka dobësuar këtë hadith për shkak të transmetuesit Ismail bin Ajash, por mendimi i tij është absolutisht i pasaktë sepse transmetimet e Ismail bin Ajashit nga banorët e Shamit janë të vërtetuara, nuk ka të metë në to dhe hadithi në fjalë është një nga këto transmetime.

Sh.p: Hadithin e ka dobësuar Albani në ed-Daifeh nr 5606 dhe ka përmendur në Sahihu el Kelimi et-Tajib fq 91 se edhe Ibn Haxheri e ka dobësuar.

që nuk e zgjonte atë që po flinte dhe që dëgjohej nga ai që ishte zgjuar”.

Kërkohej nga muslimanët që të edukohen në bazë të këtij edukimi profetik dhe të pajisen me të dhe t’i kushtojnë rëndësi dhënies selam familjes së tyre kur hyjnë në shtëpi, ashtuqë të afrohen zemrat edhe më shumë, të forcohen lidhjet e dashurisë familjare dhe të zbresin bekimet mbi të dhe familjen e tij¹³³.

T’i japësh selam kafirit i pari.

Në kohën e sotme jemi sprovuar me numrin e shumtë të delegacioneve të kafirave që vijnë në vendin tonë, gjë e cila e ka dobësuar në zemrat e shumë muslimanëve obligueshmërinë e armiqësisë dhe urrejtjes së kafirave, duke arritur deri aty saqë disa muslimanë i kanë barazuar kafirat me muslimanët në të përshëndetur me përshëndetjen islame. E sheh muslimanin duke i dhënë vetë i pari selam kafirit, ashtu siç i jep vëllait të tij musliman dhe ai nuk sheh asnjë të keqe në këtë veprim, përkundrazi ndoshta mendon se po tregohet i sjellshëm dhe po bën diçka të lavdërueshme. Është transmetuar ndalim i qartë dhe i prerë nga ky veprim i shëmtuar.

Transmetohet në Sahihun e Muslimit, etj, nga Ebu Hurejra radijallahu anhu se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Mos u jepni ju të parët selam çifutëve dhe të krishterëve. Nëse takoni në rrugë ndonjë nga ata detyrojini të ecin në pjesën më të ngushtë të rrugës (në qoshe të saj)”.

Në dhënien selam kafirave fillimisht, ka disa të këqija (pasoja të dëmshme):

¹³³ Kjo shprehje është transmetuar si hadith, nga Enesi radijallahu anhu nga Profeti salallahu alejhi ue selem : “O biri im, kur të hysh tek familja jote jep selam ashtuqë të jetë bereqet për ty dhe familjen tënde”, e ka transmetuar Tirmidhiu (5/59) . Hadithi është i dobët.

1. Rënia në ndalimin e lartpërmendur.
2. Kjo tregon përkushtim dhe nderim për kafirat.
3. Kjo e shuan zilinë që kanë ata ndaj muslimanëve për selamin, sepse ata më së shumti që na kanë zili na kanë çështjen e selamit, kështuqë nëse muslimani u jep selam, atyre do u bëhet qejfi dhe do gëzohen që janë ortakë të muslimanëve në këtë përshëndetje.
4. Ky veprim është në kundërshtim me fjalën e Allahut: “Ata (kafirat) le të gjejnë ashpërsi tek ju (ndaj tyre)” sepse dhënia selam fillimisht atyre është shenjë që tregon dashuri dhe afrimitet.

Në bazë të këtyre shkaqeve e të tjera, shumica e dijetarëve e kanë ndaluar t’i jepet selam kafirit fillimisht.

Neueuiu- në shpjegimin e tij të Sahihu Muslim- ka thënë: Medhhebi ynë në këtë çështje është konsiderimi haram i dhënies selam kafirave fillimisht. Argumenti ynë që vërteton mosdhënien selam atyre fillimisht është fjala e Profetit salallahu alejhi ue selem : “Mos u jepni ju të parët selam çifutëve dhe të krishterëve”. Këtë mendim që përmendëm nga medhhebi ynë, e kanë zgjedhur shumica e dijetarëve dhe selefët në përgjithësi.

Ata të cilët pretendojnë lejimin e dhënies selam fillimisht kafirave janë argumentuar me fjalën e Allahut: “Fali (O Muhamed) ata (kafirat) dhe thuaj: Selam (paqe). Më vonë do ta kuptojnë”, dhe me ajetin që përshkruan fjalën e Ibrahimit duke iu drejtuar babait të tij: “Selamun alejke do i kërkoj falje Zotit tim për ty”.

Në këto dy ajete nuk ka argument për këtë çështje në mënyrë absolute. Ajeti i parë është i anuluar me ajetin e Shpatës ku Allahu thotë në suren Beraeh (Teube): “Vritini idhujtarët kudo që t’i gjeni”.

Le ta zëmë se ajeti nuk është i anuluar, përsëri nuk ka argument në të sepse me fjalën selam nuk ishte për qëllim përshëndetja e mirënjohur, por largimi, lënia mënjanë, shmangia dhe mospërgjigjia ndaj tyre me fjalë të ulëta ashtu siç ata na drejtohen neve. Ndërsa ajeti i dytë: Shumica e dijetarëve janë të mendimit se selami i Ibrahimit kishte për qëllim lënien dhe shmangien (si në ajetin e mësipërm) e nuk kishte për qëllim përshëndetjen.

Taberiu ka thënë: domethënë: Ti je i sigurtë nga unë (që nuk të gjen gjë e keqe prej meje).(mbaroi)

Jemi urdhëruar ta marrim Ibrahimin salallahu alejhi ue selem si shembull në ato gjëra të cilat nuk bien ndesh me sheriatin e Muhamedit salallahu alejhi ue selem, prandaj edhe nëse e pranojmë se thënia e Ibrahimit ishte për përshëndetje (për babain e tij kafir) përsëri nuk ka argument për çështjen në fjalë sepse është vërtetuar në sheriatin e Profetit salallahu alejhi ue selem e kundërta e saj, siç tregohet qartë në fjalën e tij: “Mos u jepni ju të parët selam çifutëve dhe të krishterëve”.

Përsa i përket asaj që transmetohet nga disa selefë që e lejojnë dhënien selam fillimisht, siç transmetohet p.sh.: nga Ebu Umameh dhe Ibn Ujejneh apo mendimi i disa dijetarëve të tjerë që e kushtëzojnë këtë gjë në rast se kemi nevojë për ta, siç transmetohet p.sh.: nga Ibn Mesudi dhe Ibrahim en-Nehai¹³⁴.

Përgjigjia është të themi: Transmetimet nga shumë prej atyre që e lejojnë nuk janë të sakta, ndërsa ato që janë të sakta nuk merren parasysh përballë hadithit të Profetit salallahu alejhi ue selem : “Mos u jepni ju të parët selam çifutëve dhe të krishterëve”. Uallahu ealem.

¹³⁴ Transmetimi nga të lartpërmendurit është i saktë dhe i vërtetë siç e ka cekur këtë Ibn Haxheri në el Fet-h.

Dikush është argumentuar për lejimin e dhënies selam kafirave me hadithin e Usames radijallahu anhu se Profeti salallahu alejhi ue selem kaloi pranë një mexhlisi në të cilin kishte muslimanë dhe idhujtarë, të përzier, të cilëve ai u dha selam”.

Në këtë hadith nuk ka argument për çështjen në fjalë sepse është detyrë të përkufizohet argumentimi me këtë hadith në lejimin e dhënies selam në rast se mexhlisi është i përzier me muslimanë dhe idhujtarë, në mënyrë që të mos ketë kontradiktë me hadithin e Ebu Hurejres.

Dikush e pyeti imam Ahmedin: Kemi të bëjmë me çifutët dhe të krishterët dhe kur shkojmë në shtëpitë e tyre ose vendqëndrimet e tyre gjejmë aty muslimanë, a tu japim selam? Tha: Po, duke pasur për qëllim tu japësh selam muslimanëve.

Neueuiu ka thënë: Lejohet t’i jepet selam fillimisht një grupi njerëzish në të cilin ka muslimanë dhe kafira ose një musliman dhe një kafir, duke pasur për qëllim muslimanët, duke u bazuar në hadithin e mësipërm.

Fakti që Profeti salallahu alejhi ue selem përmendi në ndalimin e dhënies selam, çifutët dhe të krishterët, nuk do të thotë se lejohet tu jepet selam idhujtarëve dhe kafirave të llojeve të tjera, bile përkundrazi idhujtarët e tjerë janë më parësorë për të mos u respektuar (se sa çifutët dhe të krishterët) sepse nuk kanë pasur libër me të cilin u ngrihet pozita e tyre.

çështje tjetër: Nëse muslimani ka një marrëdhënie të nevojshme me ithtarët e librave –apo llojeve të tjera idhujtarësh- i lejohet që t’i përshëndesë i pari ata duke thënë: es-Selamu ala menit-tebeal huda (Selami qoftë mbi atë që pason udhëzimin) apo të ngjashme siç e kemi sqaruar më herët, apo me përshëndetje të tjera si p.sh: Si u gdhive, si u

ngryse, e lloje të tjera përshëndetjeje përveç përshëndetjes islame.

Si ua kthen muslimani selamin ithtarëve të librave?

Transmetohet nga Ibn Umeri radijallahu anhuma se ai tha: Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Nëse çifutët u japin selam, në të vërtetë ata thonë: es-samu alejke, ndaj përgjigjuni duke thënë: ue alejke”. Mutefekun alejhi. Es-samu do të thotë: vdekja.

Transmetohet nga Enesi radijallahu anhu se ai tha: Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: “Nëse ithtarët e librave u japin selam, ju u thuani: ue alejkum”. Mutefekun alejhi.

Transmetohet nga Aisheja radijallahu anha se ajo ka thënë: Një grup çifutësh i kërkuan leje Profetit salallahu alejhi ue selem për të hyrë dhe thanë: es-samu alejke (vdekja qoftë mbi ty). Aisheja (e zemëruar nga kjo fjalë) tha: Përkundrazi, mbi ju qoftë vdekja dhe mallkimi. Profeti salallahu alejhi ue selem tha: “Oj Aishe, vërtet Allahu e do butësinë në çdo çështje”. Ajo tha: A nuk e dëgjove se çfarë thanë? Tha: “Unë iu përgjigja atyre duke thënë: Ue alejkum (edhe mbi ju qoftë e njëjtë). Mutefekun alejhi, në disa transmetime të Muslimit fjala ue alejkum transmetohet pa :ue (edhe).

Neueuiu ka thënë: Të gjithë dijetarët kanë rënë dakort që tu kthehet selami ithtarëve të librave nëse ata japin selam të parët por nuk u thuhet: Ue alejkumus-selam por thuhet vetëm: ue alejkum ose alejkum. Në transmetimet e Muslimit është përmendur përgjigja me: alejkum dhe ue alejkum.

Secila shprehje kthyesë merr kuptim të ndryshëm nga tjetra në varësi të lidhëzës: ue (edhe).

Në rastin e parë nëse thuhet: ue alejkum, kuptimi është: Ashtu siç vdekja do bjerë dikur mbi ne, pa asnjë dyshim po

ashtu do bjerë dhe mbi ju. Në këtë rast “ue” (edhe) përfton kuptimin e pjesëmarrjes së përbashkët në atë gjë.

Mund t’i jepet një kuptim i dytë, nëse e konsiderojmë “ue” si mjet gjuhësor për fillimin e një fjalie me kuptim të ri që në rastin tonë kuptimi do ishte: Mbi ju qoftë nënçmimi dhe përçmimi që meritoni, pra “ue” në këtë rast nuk do jetë lidhëse dhe nuk tregon pjesëmarrjen e përbashkët në atë cilësi.

Në rastin e dytë: Nëse thuhet vetëm: alejkum, kuptimi do të ishte: vdekja qoftë mbi ju.

El kadij Ijad ka thënë: Disa dijetarë –prej tyre Ibn Habib el Malikij- kanë zgjedhur heqjen e “ue” ashtuqë të mos nënkuptohet pjesëmarrja në atë cilësi. Ndërsa të tjerë veç tyre kanë zgjedhur shqiptimin e “ue” duke u bazuar në shumicën e transmetimeve¹³⁵.

El kHatabij ka thënë: Pothuajse të gjithë muhadithinët e transmetojnë me: ue alejkum ndërsa Sufjan bin Ujejneh e transmeton pa “ue” duke thënë vetëm: “alejkum” dhe kjo është e sakta. Kjo sepse nëse e heqim “ue” e gjithë fjala e tyre që thanë u kthehet mbrapsht, ndërsa nëse e themi me “ue” kjo nënkupton pjesëmarrjen me ta në çfarë ata thonë sepse “ue” (dhe) është lidhëz që tregon bashkimin dhe pjesëmarrjen mes dy gjërave.

Neueuiu ka thënë: Ky ishte mendimi i el Hatabit por e sakta është se të dyja janë të lejuara dhe me vend, sepse të dyja janë të vërtetuara në transmetime, por thënia me “ue” është më e mirë sepse është transmetuar në shumicën e transmetimeve dhe nuk përmban në vetvete ndonjë kuptim të pasaktë, sepse es-samu është vdekja e cila do na zërë si ne ashtu edhe ata.

El alametü Ibnul Kajimi e ka refuzuar mendimin e mëparshëm të Hatabiut duke thënë: Shqiptimi i “ue” në

¹³⁵ Marrë nëpërmjet Neueuiut.

kthimin e selamit të përmendur në hadith nuk do të thotë pjesëmarrje me ta në kuptimin e asaj duaje për keq, por ajo që përfitohet prej saj është pjesëmarrja në luftën ndaj palës tjetër (kundërpërgjigje me të njëjtën dua pa përfshirë veten në të). Kjo sepse duaja fillimisht doli nga ata, ndaj kur u përgjigjet me të njëjtën ndodh pjesëmarrje me ta në formën e lutjes por jo në kuptimin dhe përmbajtjen e duasë sepse thjesht po ju kundërpërgjigjemi me atë që na thonë neve. Nëse fjala es-samu ka kuptimin: vdekja –siç është kuptimi i mirënjohur i kësaj fjale- atëherë pjesëmarrja në të është e qartë dhe kuptimi do jetë: Nuk jemi ne të vetmit që do vdesim, përkundrazi do vdesim ne dhe ju gjithashtu. Sidoqoftë që t'i jepet kuptimi, nuk ka asnjë të keqe në shqiptimin e lidhëzës: “ue” (dhe) siç e thamë më lart shumica e dijetarëve e kanë transmetuar me këtë¹³⁶.

¹³⁶ Marrë nga Hashijetu es-sunen 8/77.

PASQYRA E LËNDËS

Fjala e përkthyesit.....	fq 3
Biografia.....	fq 6
Parathënia e autorit.....	fq 13
Kush jep selam i pari	fq 14
Ai që është hypur (mbi kafshë ose mjet) i jep selam këmbësorit ..	fq 14
Këmbësori i jep selam atij që është ulur	fq 15
Ata që janë më të paktë në numër u japin selam atyre që janë më shumë	fq 16
I vogëli i jep selam më të madhit në moshë	fq 16
Situata të patheksuara se kush duhet të japë selam i pari	fq 16
Gjykimi i moszbatimit të Sunetit në përparësinë e dhënies selam	fq 18
Obligueshmëria e kthimit të selamit	fq 18
Nëse nuk e kthen selamin ngarkohet me gjynah	fq 19
Mënyra e kthyerjes së selamit nëse i jepet selam një grupi	fq 20
Dërgimi i selamit dhe komunikimi i tij	fq 22
Komunikuesi e ka detyrë ta komunikojë selamin nëse e merr përsipër diçka të tillë	fq 22
Kur dikujt i ngarkohet komunikimi i selamit ka dy situatë	fq 24
Si e kthen Selamin ai që i komunikohet	fq 24
A ia kthen selamin edhe komunikuesit	fq 25
Shoqërimi i Selamit me përqafim	fq 26
Përqafimi në ngushëllime	fq 27
Ngritja në këmbë për atë që hyn kur i jep selam	fq 27
Qëndrimi në këmbë mbi personin	fq 28
Ngritja në këmbë për ta përgëzuar apo ngushëlluar	fq 29
Ngritja në këmbë për të ndihmuar të pafuqishmin	fq 30
Ngritja e fëmijës për prindin apo ngritja e gruas për burrin dhe e kundërta	fq 31
Ngritja për atë që vjen nga udhëtimi	fq 33
Ngritja për të pritur atë që vjen	fq 33
Ngritja në këmbë kur e sheh personin	fq 34
Mosdhënia selam bidatçinjve dhe gjynahqarëve	fq 46
Dhënia e dorës pas kryerjes së çdo namazi farz	fq 54

Dhënia salam imamit pas çdo namazi farz	fq 56
Rregulli që përcakton paligjshmërinë e këtij selami	fq 56
Shtimi në Selam pas fjalës:ue berakatuhu, qoftë në dhënien fillestare apo në kthim	fq 57
Dhënia salam muslimanit me shprehjen: es-selamu ala menit-tebeal huda	fq 63
Dhënia salam me shprehjen:Alejkes-selam	fq 65
Bërja me shenjë me dorë në dhënien salam	fq 69
Mospërhapja e selamit	fq 70
Neglizhimi i dhënies salam fëmijëve	fq 75
Mosdhënia salam kur largohet nga mexhlisi	fq 76
Mosdhënia salam kur ndarja është e shkurtër	fq 77
Dhënia salam atij që po falet dhe si duhet ta kthejë	fq 78
Dhënia salam kur kërkon leje për të hyrë	fq 82
Mospëlqyeshmëria e dhënies salam atij që po kryen nevojat fiziologjike	fq 86
Preferohet të jepet selami duke qenë me abdes	fq 87
Dhënia salam familjes kur hyn në shtëpi	fq 89
Dhënia salam kafirit fillimisht	fq 91
Si duhet tua kthejë muslimani selamin ithtarëve të librit	fq 95
Pasqyra e lëndës	fq 98